

# Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 13

## *Matja me vlerën e drejtë*

### Objektivi

---

- 1 **Ky SNRF:**
  - (a) **përkufizon vlerën e drejtë;**
  - (b) **paraqet në një SNRF të vetëm një kuadër referues për matjen e vlerës së drejtë; dhe**
  - (c) **kërkon që të jepen informacione shpjeguese rreth matjeve me vlerën e drejtë.**
- 2 Vlera e drejtë është një matje e bazuar në treg dhe nuk është një matje specifike e njësisë ekonomike. Për disa aktive dhe pasive, mund që transaksione tregu të dukshme ose informata tregu të jenë të disponueshme. Për aktive dhe pasive të tjera, nuk mund të jenë të disponueshme transaksione të dukshme tregu ose informata tregu. Megjithatë, objektivi i matjes me vlerën e drejtë në të dy rastet është i njëjtë-të vlerësojë çmimin me të cilin një *transaksion i zakonshëm* për të shitur aktivin ose për të transferuar pasivin, do të kryhet në mes të *pjesëmarrësve të tregut* në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut (dmth një *çmim daljeje* në datën e matjes nga këndvështrimi i një pjesëmarrësi tregu që zotëron aktivin ose ka pasivin).
- 3 Kur një çmim për një aktiv ose pasiv të njëjtë nuk është i evidentuar, njësia ekonomike mat vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi që maksimizon përdorimin e *inputeve përkatëse të verifikueshme* dhe minimizon përdorimin e *inputeve të paverifikueshme*. Meqë vlera e drejtë është një matje e bazuar në treg, ajo matet duke përdorur supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin për të caktuar çmimin e aktivit ose të pasivit, duke përfshirë edhe supozimet mbi rrezikun. Si rezultat i kësaj, qëllimi i një njësie ekonomike për të mbajtur një aktiv ose për të shlyer apo, ndryshe, për të përmbushur një detyrim, nuk është i rëndësishëm në matjen e vlerës së drejtë.
- 4 Përkufizimi i vlerës së drejtë përqendrohet në aktivet dhe pasivet, sepse ato janë një subjekt kryesor i matjes kontabël. Përveç kësaj, ky SNRF do të zbatohet për instrumentet e kapitalit neto të njësisë ekonomike, të matura me vlerën e drejtë.

## Objekti

---

- 5 Ky SNRF zbatohet kur një SNRF tjetër kërkon ose lejon matjet me vlerën e drejtë apo dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me matjet me vlerën e drejtë (dhe matje, të tilla si me vlerën e drejtë minus kostot për shitje, bazuar në vlerën e drejtë ose dhënia e informacioneve shpjeguese rreth këtyre matjeve), përveç sa është përcaktuar në paragrafët 6 dhe 7.
- 6 Kërkesat për matjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të këtij SNRF-je nuk zbatohen për rastet në vijim:
- (a) transaksionet e pagesave të bazuara në aksione që janë objekt i SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione*;
  - (b) transaksionet e qirasë që janë objekt i SNK 17 *Qiratë*; dhe
  - (c) matjet që kanë disa ngjashmëri me vlerën e drejtë, por nuk janë të tilla, si vlera neto e realizueshme në SNK 2 *Inventarët* ose vlera në përdorim në SNK 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve*.
- 7 Informacionet shpjeguese, që kërkojnë të jepen nga ky SNRF, nuk jkërkojnë të jepen në rastet në vijim:
- (a) aktivet e skemës të matura me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*;
  - (b) investimet në skemat e përfitimeve për pensione që maten me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 26 *Kontabiliteti dhe raportimi në lidhje me skemat e përfitimeve për pensione*; dhe
  - (c) aktivet për të cilat shuma e rikuperueshme është vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit në përputhje me SNK 36.
- 8 Kuadri i matjes së vlerës së drejtë, që përkrahë në këtë SNRF, zbatohet edhe për matjen fillestare, edhe për atë të mëpasshme, në qoftë se vlera e drejtë kërkohej ose lejohet nga SNRF-të e tjera.

## Matja

---

### Përkufizimi i vlerës së drejtë

- 9 Ky SNRF e përkufizon vlerën e drejtë si çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose që do paguhej për të transferuar një pasiv, në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes.

- 10 Paragrafi B2 përshkruan metodën e përgjithshme të matjes së vlerës së drejtë.

## Aktiv ose pasiv

- 11 Një matje me vlerën e drejtë bëhet për një aktiv të veçantë ose pasiv. Prandaj, kur mat vlerën e drejtë, një njësi ekonomike do të marrë parasysh karakteristikat e aktivit ose pasivit, që do të kishin patur parasysh pjesëmarrësit e tregut kur të caktonin çmimin e aktivit ose pasivit në datën e matjes. Këto karakteristikat përfshijnë, për shembull, si vijon:
- (a) kushtet dhe vendndodhjen e aktivit; dhe
  - (b) kufizimet, nëse ka, për shitjen ose përdorimin e aktivit.
- 12 Efekti në matje, që rrjedh nga një karakteristikë e veçantë, do të ndryshojë në varësi të faktit se si do të merrej parasysh karakteristika nga pjesëmarrësit e tregut.
- 13 Aktivit ose pasivi që matet me vlerën e drejtë mund të jetë, si më poshtë, ose:
- (a) një aktiv apo pasiv i veçuar (p.sh. një instrument financiar ose një aktiv jo-financiar); ose
  - (b) një grup aktivesh, një grup pasivesh ose një grup aktivesh dhe pasivesh (p.sh. një njësi gjeneruese e mjeteve monetare ose një biznes).
- 14 Nëse aktivit ose pasivi është vetëm një aktiv ose pasiv i veçuar, një grup aktivesh, një grup pasivesh ose një grup aktivesh dhe pasivesh për qëllime të njohjes apo të dhënies së informacioneve shpjeguese varet nga *njësia e tij e llogarisë*. Njësia e llogarisë për aktivin ose pasivin do të përcaktohet në përputhje me SNRF-në që kërkon ose lejon matjen e vlerës së drejtë, përveç sa parashikohet në këtë SNRF.

## Transaksioni

- 15 Një matje me vlerën e drejtë supozon se aktivit ose pasivi është shkëmbyer në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut, për shitjen e aktivit ose transferimin e pasivit në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut.
- 16 Një matje me vlerën e drejtë supozon se transaksioni për të shitur aktivin ose transferuar pasivin bëhet, ose:
- (a) në *tregun kryesor* për aktivin ose pasivin; ose
  - (b) në mungesë të një tregu kryesor, në *tregun më të favorshëm* për aktivin ose pasivin.

- 17 Një njësi ekonomike nuk është e nevojshme të ndërmarrë një kërkim shterrues të të gjitha tregjeve të mundshme për të identifikuar tregun kryesor ose, në mungesë të një tregu kryesor, tregun më të favorshëm, por ajo do të marrë parasysh të gjithë informacionin që është i disponueshëm në mënyrë të arsyeshme. Në mungesë të evidencës për të kundërtën, tregu në të cilin njësi ekonomike, normalisht, do të hyjë në një transaksion për të shitur aktivin ose për të transferuar pasivin supozohet të jetë tregu kryesor ose, në mungesë të një tregu kryesor, tregu më i favorshëm.
- 18 Nëse ka një treg kryesor për aktivin ose pasivin, matja me vlerën e drejtë do të paraqesë çmimin në këtë treg (qoftë ky çmim i evidentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose i vlerësuar duke përdorur një teknikë vlerësimi), madje edhe nëse çmimi në një treg tjetër është potencialisht më i favorshëm në datën e matjes.
- 19 Njësia ekonomike duhet të ketë mundësi hyrjeje në tregun kryesor (apo më të favorshëm) në datën e matjes. Meqë njësitë ekonomike të ndryshme (dhe bizneset e këtyre njësive ekonomike) me aktivitete të ndryshme mund të kenë mundësi hyrjeje në tregje të ndryshme, tregu kryesor (ose më i favorshëm) për të njëjtin aktiv ose pasiv mund të jetë i ndryshëm për njësi ekonomike të ndryshme (dhe bizneset e këtyre njësive ekonomike). Prandaj, tregu kryesor (ose më i favorshëm) do të konsiderohet (po kështu dhe pjesëmarrësit e tregut) nga këndvështrimi i njësisë ekonomike, duke lejuar kështu dallimet që ekzistojnë midis dy ose më shumë njësive ekonomike me aktivitete të ndryshme.
- 20 Edhe pse njësi ekonomike duhet të jetë në gjendje të hyjë në treg, nuk është e nevojshme që ajo të jetë në gjendje të shesë aktivin e veçantë ose të transferojë pasivin e veçantë në datën e matjes në mënyrë që të jetë në gjendje të masë vlerën e drejtë mbi bazën e çmimit në këtë treg.
- 21 Edhe kur nuk ka treg të mbikëqyruar për të siguruar informacion rreth shitjes së një aktivi ose transferimit të një pasivi në datën e matjes, një matje me vlerën e drejtë do të supozojë se një transaksion, që ndodh në këtë datë, konsiderohet nga perspektiva e pjesëmarrësit të tregut që zotëron aktivin ose ka marrë përsipër detyrimin. Ky transaksion i supozuar krijon një bazë për vlerësimin e çmimit për të shitur aktivin ose për të transferuar pasivin.

## **Pjesëmarrësit e tregut**

- 22 **Një njësi ekonomike do të matë vlerën e drejtë të një aktivi ose një pasivi duke u nisur nga supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin për të caktuar çmimin e aktivit ose të pasivit, duke supozuar se pjesëmarrësit e tregut veprojnë në interesin ekonomik më të mirë të tyre.**
- 23 Në zhvillimin e këtyre supozimeve, një njësi ekonomike nuk është e nevojshme të identifikojë pjesëmarrësit specifikë të tregut. Përkundrazi, njësi

ekonomike do të identifikojë karakteristikat që i dallojnë pjesëmarrësit e tregut në përgjithësi, duke pasur parasysh faktorë të veçanta për të gjitha sa më poshtë:

- (a) aktivin ose pasivin;
- (b) tregun kryesor (ose më të favorshëm) për aktivin ose pasivin; dhe
- (c) pjesëmarrësit në treg me të cilët njësitë ekonomike do të hyjnë në një transaksion në këtë treg.

## Çmimi

- 24 **Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose çmimi që do të paguhej për të transferuar një pasiv, në një transaksion të zakonshëm, në tregun kryesor (ose më të favorshëm), në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut (dmth një çmim daljeje), pavarësisht nëse ky çmim është i evidentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose i vlerësuar duke përdorur një teknikë vlerësimi.**
- 25 Çmimi në tregun kryesor (apo më të favorshëm), që përdoret për të matur vlerën e drejtë të aktivit ose të pasivit, nuk duhet të rregullohet për *kostot e transaksionit*. Kostot e transaksionit do të kontabilizohen në përputhje me SNRF-të e tjera. Kostot e transaksionit nuk janë një karakteristikë e një aktivi ose e një pasivi, më saktë, ato janë specifike për një transaksion dhe do të ndryshojnë varësi të faktit se si një njësi ekonomike hyn në një transaksion për aktivin ose pasivin.
- 26 Kostot e transaksionit nuk përfshijnë *kostot e transportit*. Në qoftë se vendndodhja është një karakteristikë e aktivit (siç mund të jetë rasti, për shembull, për një mall), çmimi në tregun kryesor (apo më të favorshëm) do të rregullohet për kostot, nëse ka, që do të kryhen për të transportuar aktivin nga vendndodhja e tij aktuale tek ky treg.

## Zbatimi në aktivet jo-financiare

**Shkalla më e lartë dhe më e mirë e përdorimit për aktivet jo-financiare.**

- 27 **Një matje e vlerës së drejtë, e një aktivi jo-financiar, merr parasysh aftësinë e një pjesëmarrësi tregu për të gjeneruar përfitime ekonomike duke përdorur aktivin në shkallën më të lartë dhe më të mirë të përdorimit të tij, ose duke ia shitur atë një pjesëmarrësi tjetër tregu, që do ta përdorte aktivin në shkallën më të lartë dhe më të mirë të përdorimit të tij.**

- 28 Shkalla më e lartë dhe më e mirë e përdorimit të një aktivi jo-financiar, merr parasysh përdorimin e aktivit që është fizikisht i mundur, ligjërisht i lejueshëm dhe financiarisht i realizueshëm, si më poshtë:
- (a) Një përdorim, që është fizikisht i mundur, merr parasysh karakteristikat fizike të aktivit, që pjesëmarrësit e tregut do të kishin parasysh kur të vendosnin çmimin e aktivit (p.sh. vendndodhjen apo madhësinë e pasurisë).
  - (b) Një përdorim, që është juridikisht i lejueshëm, merr parasysh kufizimet ligjore për përdorimin e aktivit që pjesëmarrësit e tregut do të kishin parasysh kur të vendosnin çmimin e aktivit (p.sh. rregulloret rajonale të zbatueshme për një pasuri).
  - (c) Një përdorim, që është financiarisht i realizueshëm, merr parasysh nëse përdorimi i aktivit, që është fizikisht i mundshëm dhe juridikisht i lejueshëm, gjeneron të ardhura të mjaftueshme apo flukse të mjeteve monetare (duke marrë parasysh koston e konvertimit të aktivit gjatë këtij përdorimi) për të siguruar një kthim të investimeve, që pjesëmarrësit e tregut do të kërkonin prej një investimi në këtë aktiv për këtë përdorim.
- 29 Përdorimi në shkallën më të lartë dhe më të mirë përcaktohet nga këndvështrimi i pjesëmarrësve në treg, edhe në qoftë se njëسيا ekonomike synon një përdorim të ndryshëm. Megjithatë, përdorimi aktual i një aktivi jo-financiar nga ana e një njësie ekonomike mendohet të jetë përdorimi në shkallën më të lartë dhe më të mirë, vetëm nëse tregu apo faktorë të tjerë sugjerojnë se një përdorim i ndryshëm nga pjesëmarrësit e tregut do të maksimizonte vlerën e aktivit.
- 30 Për të mbrojtur pozicionin e saj konkurrues, ose për arsye të tjera, një njësi ekonomike mund të synojë të mos e përdorë në mënyrë aktive një aktiv jo-financiar të blerë ose ajo mund të synojë të mos e përdorë aktivin në shkallën më të lartë dhe më të mirë të përdorimit të tij. Për shembull, ky mund të jetë rasti për një aktiv jo-material të blerë, që njëسيا ekonomike e ka në plan ta përdorë për mbrojtje duke mos lejuar që ta përdorin të tjerët. Megjithatë, njëسيا ekonomike do ta matë vlerën e drejtë të një aktivi jo-financiar duke supozuar përdorimin e tij në shkallën më të lartë dhe më të mirë nga pjesëmarrësit e tregut.

### **Kushti i vlerësimit për aktivet jo-financiare**

- 31 Përdorimi në shkallën më të lartë dhe më të mirë i një aktivi jo-financiar kërkon kushtin e vlerësimit, që përdoret për të matur vlerën e drejtë të aktivit, si më poshtë:
- (a) Përdorimi në shkallën më të lartë dhe më të mirë i një aktivi jofinanciar duhet të sigurojë vlerën maksimale për pjesëmarrësit e tregut, nëpërmjet përdorimit të tij në kombinim me aktive të tjera si një grup (i instaluar apo konfiguruar ndryshe për përdorim) ose në kombinim me aktive dhe pasive të tjera (p.sh. një biznes).

- (i) Nëse përdorimi në shkallën më të lartë dhe më të mirë i aktivitetit është që ai të përdoret në kombinim me aktive të tjera ose me aktive dhe pasive të tjera, vlera e drejtë e aktivitetit është çmimi që do të pranohej në një transaksion aktual për shitjen e aktivitetit, duke supozuar se aktivi do të përdorej me aktive të tjera ose me aktive dhe pasive të tjera dhe se këto aktive dhe pasive (dmth. aktivitetet e tij plotësuese dhe pasivitetet e lidhura) do të ishin në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut.
  - (ii) Pasivitetet, e lidhura me aktivitetin dhe me aktivitetet plotësuese, përfshijnë pasivitetet që financojnë kapitalin punues, por nuk përfshijnë detyrimet që përdoren për të financuar aktivitetet, përveç atyre brenda grupit të aktiveve.
  - (iii) Supozimet për përdorimin në shkallën më të lartë dhe më të mirë të një aktivi jo-financiar do të duhet të jenë të qëndrueshme për të gjitha aktivitetet (për të cilat është i rëndësishëm përdorimi më i lartë dhe më i mirë) e grupit të aktiveve ose grupin e aktiveve dhe pasiveve brenda të cilit do të përdorej aktivi.
- (b) Përdorimi në shkallën më të lartë dhe më të mirë të një aktivi jo-financiar mund të sigurojë vlerën maksimale mbi një bazë të veçuar për pjesëmarrësit e tregut. Në qoftë se përdorimi më i lartë dhe më i mirë i aktivitetit është që ai të përdoret mbi një bazë të veçuar, vlera e drejtë e aktivitetit është çmimi që do të pranohej në një transaksion aktual për ta shitur aktivitetin tek pjesëmarrësit e tregut, që do ta përdornin aktivitetin mbi një bazë të veçuar.
- 32 Matja e vlerës së drejtë të një aktivi jo-financiar supozon se aktivi shitet në pajtueshmëri me njësinë e llogarisë të specifikuar në SNRF-të e tjera (që mund të jetë një aktiv individual). Ky është rasti edhe kur kjo matje me vlerën e drejtë supozon se përdorimi në shkallën më të lartë dhe më të mirë të aktivitetit është që ai të përdoret në kombinim me aktive të tjera ose me aktive dhe pasive të tjera, megjë një matje me vlerën e drejtë supozon se pjesëmarrësi i tregut tashmë zotëron aktive suplementare dhe pasive të lidhura.
- 33 Paragrafi B3 përshkruan zbatimin e konceptit të kushtit paraprak të vlerësimit për aktivitetet jo-financiare.

## **Zbatimi për pasivitet dhe instrumentet e kapitalit neto të njësisë ekonomike**

### **Parimet e përgjithshme**

- 34 Një matje me vlerën e drejtë supozon se një detyrim financiar ose detyrim jo-financiar ose instrument i kapitalit neto i një njësie

**ekonomike (p.sh. interesat e kapitalit të emetuar si pagesë në një kombinim biznesi) transferohet në një pjesëmarrës tregu në datën e matjes. Transferimi i një detyrimi ose instrumenti të kapitalit neto të njësisë ekonomike supozon sa më poshtë:**

- (a) **Një detyrim do të vazhdonte të ishte i pakthyer dhe pjesëmarrësi i tregut i transferuari do të ishte i detyruar ta paguante detyrimin. Detyrimi nuk do të paguhej nga një palë tjetër ose nuk do të shlyhej në datën e matjes.**
- (b) **Instrumenti i kapitalit neto të një njësie ekonomike do të vazhdonte të ishte në qarkullim dhe pjesëmarrësi i tregut, i transferuari, do të merrte përsipër të drejtat dhe përgjegjësitë që lidhen me instrumentin. Instrumenti nuk do të anulohet ose shlyhet në datën e matjes.**

35 Edhe kur nuk ka treg të mbikëqyruar për të siguruar informacion për çmimin, në lidhje me transferimin e një detyrimi ose instrumenti kapitali neto të një njësie ekonomike (p.sh. për shkak se kufizimet kontraktuale apo kufizimet e tjera ligjore nuk lejojnë transferimin e këtyre elementëve), mund të ketë një treg të mbikëqyruar për të tillë elementë, nëse ata zotërohen nga të tretët si aktive (p.sh. një obligacion i shoqërisë tregtare ose një opsjon blerje për aksionet e një njësie ekonomike).

36 Në të gjitha rastet, një njësi ekonomike do të maksimizojë përdorimin e inputeve përkatëse të verifikueshme dhe do të minimizojë përdorimin e inputeve të paverifikueshme për të realizuar objektivin e matjes me vlerën e drejtë, që është vlerësimi i çmimit me të cilin transferohet pasivi ose instrumenti i kapitalit neto, gjatë një transaksioni të zakonshëm që zhvillohet në mes të pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut.

*Pasivet dhe instrumentet e kapitalit neto të zotëruara nga palët e tjera si aktive*

37 **Kur një çmim i kuotuar për transferimin e një pasivi ose instrumenti kapitali neto të njësisë ekonomike të njëjtë ose të ngjashëm, nuk është i disponueshëm dhe një element i njëjtë zotërohet nga një palë tjetër si një aktiv, njësia ekonomike do të matë vlerën e drejtë të pasivit ose të instrumentit të kapitalit nga këndvështrimi i një pjesëmarrësi në treg që zotëron të njëjtin element si një aktiv në datën e matjes.**

38 Në raste të tilla, një njësi ekonomike do të matë vlerën e drejtë të pasivit ose të instrumentit të kapitalit neto si më poshtë:

- (a) duke përdorur çmimin e kuotuar në një *treg aktiv* të të njëjtit element, të zotëruar nga një palë tjetër si një aktiv, në qoftë se çmimi është i disponueshëm.



- (b) në qoftë se çmimi nuk është i disponueshëm, do të përdorë inpute të tjera të verifikueshme, të tilla si çmimin e kuotuar në një treg që nuk është aktiv për të njëjtin element të zotëruar nga një palë tjetër si një aktiv.
- (c) në qoftë se çmimet e evidentuara në (a) dhe (b) nuk janë të disponueshme, do të përdorë një teknikë tjetër vlerësimi, si:
  - (i) *metodën e të ardhurave* (p.sh. një teknikë e vlerës aktuale që merr parasysh flukset monetare të ardhshme që një pjesëmarrës tregu pret të marrë nga zotërimi i pasivit ose i instrumentit të kapitalit neto si një aktiv; shih paragrafët B10 dhe B11).
  - (ii) *metodën e tregut* (p.sh. duke përdorur çmimet e kuotuar për pasive të ngjashme ose instrumente kapitali neto që zotërohen nga palë të tjera si aktive; shih paragrafët B5–B7).

39 Një njësi ekonomike do të rregullojë çmimin e kuotuar të një pasivi ose instrumenti kapitali neto të njësisë ekonomike, që zotërohet nga një palë tjetër si një aktiv, vetëm nëse ka faktorë specifike për aktivin, që nuk janë të zbatueshëm për matjen e vlerës së drejtë të pasivit ose instrumentit të kapitalit neto. Një njësi ekonomike do të sigurojë që çmimi i aktivit nuk pasqyron efektin e një kufizimi që nuk lejon shitjen e këtij aktivit. Në vijim jepen disa faktorë që mund të tregojnë se çmimi i kuotuar i aktivit duhet të rregullohet:

- (a) Çmimi i kuotuar për aktivin ka të bëjë me një pasiv të ngjashëm (por jo të njëjtë) ose instrument kapitali neto të zotëruar nga një palë tjetër si një aktiv. Për shembull, pasivi ose instrumenti i kapitalit neto mund të ketë një karakteristikë të veçantë (p.sh. cilësinë e kredisë të emetuesit) që është e ndryshme nga ajo që pasqyrohet në vlerën e drejtë të pasivit ose instrumentit të kapitalit neto të ngjashëm që zotërohet si një aktiv.
- (b) Njësia e llogarisë për aktivin nuk është e njëjtë si për pasivin ose instrumentin e kapitalit neto. Për shembull, për pasivet, në disa raste çmimi për një aktiv pasqyron një çmim të kombinuar për një paketë që përmban të dyja shumat si atë të emetuesit dhe të palës së tretë që mban aktivin si garanci. Nëse njësia e llogarisë për pasivin nuk është dhe për paketën e kombinuar, objektivi është të matet vlera e drejtë e pasivit të emetuesit dhe jo vlera e drejtë e paketës së kombinuar. Kështu, në të tilla raste, njësia ekonomike do të rregullojë çmimin e evidentuar për aktivin për të përjashtuar efektin e palës së tretë që mban aktivin si garanci kredie.

*Pasivet dhe instrumentet e kapitalit neto që nuk zotërohen nga palët e tjera si aktive*

- 40 Kur një çmim i kuotuar për transferimin e një pasivi të njëjtë ose të ngjashëm ose instrumenti kapitali neto të njësisë ekonomike, nuk është i disponueshëm dhe zëri i njëjtë nuk zotërohet nga një palë tjetër si një aktiv, një njësi ekonomike do të matë vlerën e drejtë të pasivit ose të instrumentit të kapitalit neto duke përdorur një teknikë vlerësimi, nga këndvështrimi i një pjesëmarrës tregu që ka pasivin apo ka emetuar kërkesat në kapitalin neto.
- 41 Për shembull, kur zbaton një teknikë të vlerës aktuale, një njësi ekonomike mund të marrë parasysh secilën nga këto në vijim:
- (a) flukset dalëse monetare të ardhshme që një pjesëmarrës tregu pret që të realizohen në përmbushjen e detyrimit, duke përfshirë kompensimin që një pjesëmarrës tregu do të kërkonte për të marrë përsipër detyrimin (shih paragrafët B31–B33).
  - (b) shuma që një pjesëmarrës tregu do të pranonte për të filluar ose emetuar një pasiv ose instrument kapitali neto të njëjtë, duke u nisur nga supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin gjatë caktimit të çmimit të të njëjtit element (psh. duke marrë parasysh të njëjtat karakteristika të kredisë), në tregun kryesor (ose më të favorshëm) për emetimin e një pasivi ose një instrumenti kapitali me të njëjtat kushte kontraktuale.

### **Rreziku në lidhje me mosrealizimin e performancës**

- 42 **Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron efektin e rrezikut në lidhje me mosrealizimin e performancës. Ky rrezik përfshin, por pa qenë i kufizuar, rrezikun e kredisë të vetë njësisë ekonomike (siç përkufizohet në SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese). Rreziku në lidhje me mosrealizimin e performancës, supozohet të jetë i njëjtë para dhe pas transferimit të pasivit.**
- 43 Gjatë matjes së vlerës së drejtë të një pasivi, njësi ekonomike do të marrë parasysh efektin e rrezikut të kredisë (besueshmëria e huamarrësit) dhe faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në faktin që detyrimi do të realizohet ose jo. Ky efekt mund të ndryshojë në varësi të pasivit, për shembull:
- (a) nëse pasivi është një detyrim për të dhënë mjete monetare (një pasiv financiar) ose një detyrim për të dhënë mallra ose shërbime (një pasiv jo-financiar).
  - (b) kushtet e sigurimit të kredisë në lidhje me pasivin, nëse ka.
- 44 Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron efektin e rrezikut të mosrealizimit të performancës në bazë të njësisë së tij të llogarisë. Emetuesi i një pasivi, i

emetuar në mënyrë të pandashme me një aktiv që mbahet si garanci nga të tretët, që llogaritet veçmas nga pasivi, nuk do të përfshijë efektin e kolateralit të kredisë (p.sh. një garanci e borxhit nga të tretët) në matjen e vlerës së drejtë të pasivit. Nëse kolaterali është kontabilizuar veçmas nga pasivi, emetuesi do të kishte parasysh besueshmërinë e vetë ndaj kredisë dhe jo të palës së tretë si garantues, kur mat vlerën e drejtë të pasivit.

### **Kufizimi i moslejimit të transferimit të një pasivi ose instrumenti të kapitalit neto të njësisë ekonomike**

- 45 Gjatë matjes së vlerës së drejtë të një pasivi ose të një instrumenti kapitali neto të vetë njësisë ekonomike, njësia ekonomike nuk do të përfshijë një input të veçantë ose një rregullim për *inputet* e tjera në lidhje me ekzistencën e një kufizimi që nuk lejon transferimin e zërit. Efekti i kufizimit, që nuk lejon transferimin e një pasivi ose një instrumenti kapitali neto të vetë njësisë ekonomike, përfshihet në mënyrë të tërthortë ose të qartë në inputet e tjera për matjen e vlerës së drejtë.
- 46 Për shembull, në datën e transaksionit, si kreditori dhe i detyruari kanë pranuar çmimin e transaksionit për pasivin, me njohuri të plotë se detyrimi përfshin një kufizim që nuk lejon transferimin e tij. Si rezultat i kufizimit të përfshirë në çmimin e transaksionit, për të pasqyruar efektin e kufizimit në transferim, nuk është i nevojshëm një input i veçantë ose një rregullim për një input ekzistues në datën e transaksionit. Në mënyrë të ngjashme, për të pasqyruar efektin e kufizimit në transferim, nuk është i nevojshëm një input i veçantë ose një rregullim i një inputi ekzistues në datat e matjes së mëvonshme.

### **Pasivi financiar me një tipar kërkueshmërie pa afat**

- 47 Vlera e drejtë e një pasivi financiar, me një tipar kërkueshmërie pa afat (p.sh. një depozitë pa afat) nuk është më e vogël se shumta e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar që nga data e parë që shumta mund të kërkohej për t'u paguar.

### **Zbatimi për aktivet financiare dhe pasivet financiare me pozicione kompensimi në lidhje me rreziqet e tregut apo rrezikun e kredisë së palës tjetër**

- 48 Një njësi ekonomike që zotëron një grup aktivesh financiare dhe pasivesh financiare është e ekspozuar ndaj rreziqeve të tregut (siç përkufizohet në SNRF 7) dhe ndaj rrezikut të kredisë (siç përkufizohet në SNRF 7) të secilës prej të dyja palëve. Nëse njësia ekonomike menaxhon këtë grup aktivesh financiare dhe pasivesh financiare në bazë të ekspozimit të saj neto si ndaj rreziqeve të tregut ose ndaj rrezikut të kredisë, njësia ekonomike lejohet të zbatojë një përjashtim të këtij SNRF-je për matjen e vlerës së drejtë. Ky

përrjashtim lejon një njësi ekonomike të masë vlerën e drejtë të një grupi aktivesh financiare dhe pasivesh financiare në bazë të çmimit, që do të pranohej për të shitur një pozicion neto afatgjatë (p.sh. një aktiv), për një ekspozim ndaj rrezikut të veçantë ose për të transferuar një pozicion neto afatshkurtër (dmth. një pasiv), për një ekspozim ndaj rrezikut të veçantë, në një transaksion të rregullt, në mes të pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes, sipas kushteve aktuale të tregut. Kështu, një njësi ekonomike do të matë vlerën e drejtë të grupit të aktiveve financiare dhe pasiveve financiare në përputhje me atë se si pjesëmarrësit e tregut do të vlerësonin ekspozimin neto ndaj rrezikut në datën e matjes.

- 49 Një njësi ekonomike lejohet të përdorë përrjashtimin në paragrafin 48, vetëm nëse njëzia ekonomike kryen të gjitha sa më poshtë:
- (a) menaxhon grupin e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare mbi bazën e ekspozimit neto të njësisë ekonomike ndaj një rreziku tregu të veçantë (ose rreziqeve), ose ndaj rrezikut të kredisë të një pale të veçantë, në përputhje me menaxhimin e dokumentuar të rrezikut të njësisë ekonomike apo strategjinë e investimit;
  - (b) jep informacion mbi këtë bazë rreth grupit të aktiveve financiare dhe pasiveve financiare tek personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike, siç përcaktohet në SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura*; dhe
  - (c) ka pranuar ose ka zgjedhur për të matur këto aktive financiare dhe pasive financiare me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportimi.
- 50 Përrjashtimi në paragrafin 48 nuk ka të bëjë me paraqitjen e pasqyrave financiare. Në disa raste, baza për paraqitjen e instrumenteve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar ndryshon nga baza për matjen e instrumenteve financiare, për shembull, nëse një SNRF nuk kërkon apo lejon që instrumentet financiare të paraqiten në një bazë neto. Në të tilla raste, një njësi ekonomike mund të ketë nevojë të bëjë rregullime në nivel portofoli (shih paragrafët 53-56), për aktivet ose pasivet individuale që përbëjnë grupin e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare, që menaxhohen në bazë të ekspozimit neto të njësisë ekonomike ndaj rrezikut. Një njësi ekonomike do ta bëjë një gjë të tillë mbi një bazë të arsyeshme dhe të qëndrueshme, duke përdorur një metodologji të përshtatshme sipas rrethanave.
- 51 Një njësi ekonomike do të marrë një vendim në lidhje me politikën kontabël, në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*, për të përdorur përrjashtimin në paragrafin 48. Një njësi ekonomike që përdor përrjashtimin, do ta zbatojë këtë politikë kontabël, duke përfshirë edhe politikën e saj për caktimin e rregullimeve të çmimit të kërkuar dhe të ofruar (shih paragrafët 53-55) dhe rregullimeve të kredisë (shih paragrafin 56), nëse është e nevojshme, në mënyrë të qëndrueshme nga periudha në periudhë, për një portofol të veçantë.

- 52 Përjashtimi në paragrafin 48 zbatohet vetëm për aktivet financiare dhe pasivet financiare brenda objektit të SNK 39 *Instrumentet financiare: njohja dhe matja* ose SNRF 9 *Instrumentet financiare*.

### **Ekspozimi ndaj rreziqeve të tregut**

- 53 Kur përdoret përjashtimi në paragrafin 48 për të matur vlerën e drejtë të një grupi aktivesh financiare dhe pasivesh financiare, të drejtuara në bazë të ekspozimit neto të njësisë ekonomike ndaj një rreziku tregu të veçantë (ose rreziqeve), njësia ekonomike do të zbatojë çmimin sipas marzhit të çmimit të kërkuar dhe të ofruar, që është më përfaqësuesi i vlerës së drejtë, në rrethana të ekspozimit neto të saj ndaj këtyre rreziqeve të tregut (shih paragrafët 70 dhe 71).
- 54 Kur përdoret përjashtimi në paragrafin 48, një njësi ekonomike do të sigurojë që rreziku i tregut (ose rreziqet), ndaj të cilit ajo është e ekspozuar, në thelb është i njëjtë brenda këtij grupi aktivesh financiare dhe pasivesh financiare. Për shembull, një njësi ekonomike nuk do të kombinonte rrezikun e normës së interesit, që lidhet me një aktiv financiar, me rrezikun e çmimeve të mallrave, që lidhet me një pasiv financiar, sepse duke vepruar kështu nuk do të zbuste ekspozimin e saj ndaj rrezikut të normës së interesit ose rrezikut të çmimit të mallrave. Kur përdoret përjashtimi në paragrafin 48, çdo rrezik bazë, që rezulton nga parametrat e rrezikut të tregut që nuk janë identike, do të merret parasysh në matjen e vlerës së drejtë të aktiveve financiare dhe pasiveve financiare brenda grupit.
- 55 Në mënyrë të ngjashme, kohëzgjatja e ekspozimit të njësisë ekonomike ndaj një rreziku të veçantë të tregut (ose rreziqeve), që lindin nga aktivet financiare dhe pasivet financiare, do të jetë në thelb e njëjtë. Për shembull, një njësi ekonomike, që përdor një kontratë 12-mujore të së ardhmes kundrejt flukseve të mjeteve monetare, të lidhura me vlerën e 12 muajve të ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit të një instrumenti financiar pesë-vjeçar, brenda një grupi të përbërë nga vetëm këto aktive financiare dhe pasive financiare, mat vlerën e drejtë të ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit 12-mujor mbi bazë neto dhe ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit të mbetur (dmth 2-5 vite) mbi bazë bruto.

### **Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë të një palë tjetër të veçantë**

- 56 Kur përdoret përjashtimi në paragrafin 48 në matjen e vlerës së drejtë të një grupi aktivesh financiare dhe pasivesh financiare, të lidhur me një palë tjetër të veçantë, njësia ekonomike do të përfshijë efektin e ekspozimit neto të saj ndaj rrezikut të kredisë të kësaj pale tjetër, ose efektin e ekspozimit neto të palës tjetër ndaj rrezikut të kredisë të njësisë ekonomike, në matjen e vlerës së drejtë. Ndërkohë, pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh çdo marrëveshje ekzistuese që zbut ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë në rast mospagimi (p.sh. një marrëveshje për mbrojtjen nga rreziku të derivativëve

me palën tjetër apo një marrëveshje që kërkon shkëmbimin e kolateralit mbi bazën e ekspozimit neto të secilës palë ndaj rrezikut të kredisë të palës tjetër). Matja me vlerën e drejtë do të pasqyrojë pritshmëritë e pjesëmarrësve të tregut në lidhje me mundësinë që një rregullim i tillë do të ishte ligjorisht i zbatueshëm në rast mospagimi.

## Vlera e drejtë në njohjen fillestare

- 57 Kur blihet një aktiv ose merret përsipër një pasiv, në një transaksion këmbimi për këtë aktiv ose pasiv, çmimi i transaksionit është çmimi i paguar për të siguruar aktivin ose i pranuar për të marrë përsipër detyrimin (një *çmim hyrje*). Në të kundërt, vlera e drejtë e aktivit ose e pasivit është çmimi që do të pranohej për të shitur aktivin ose paguhej për transferimin e detyrimit (një *çmim dalje*). Njësitë ekonomike nuk janë të detyruara t'i shesin aktivet me çmimet e paguara për t'i siguruar ato. Në mënyrë të ngjashme, njësitë ekonomike nuk janë të detyruara të transferojnë pasivet me çmimet që kanë pranuar për t'i marrë përsipër ato.
- 58 Në shumë raste çmimi i transaksionit është i barabartë me vlerën e drejtë (p.sh. ky mund të jetë rasti kur në datën e transaksionit, transaksioni për të blerë një aktiv ndodh në tregun në të cilin aktivi do të shitej).
- 59 Gjatë përcaktimit nëse vlera e drejtë në njohjen fillestare është e barabartë me çmimin e transaksionit, një njësi ekonomike do të marrë parasysh faktorë të veçantë të transaksionit dhe të aktivit ose pasivit. Paragrafi B4 përshkruan situatat në të cilat çmimi i transaksionit nuk mund të përfaqësojë vlerën e drejtë të një aktivi ose pasivi në njohjen fillestare.
- 60 Nëse një SNRF kërkon ose lejon një njësi ekonomike të masë një aktiv ose një pasiv fillimisht me vlerën e drejtë dhe çmimi i transaksionit ndryshon nga vlera e drejtë, njësia ekonomike do të njohë fitimin ose humbjen neto që rrjedh në rezultatin e periudhës, përveçse kur ky SNRF e specifikon ndryshe.

## Teknikat e vlerësimit

- 61 **Një njësi ekonomike do të përdorë teknika vlerësimi që janë të përshatshme për rrethanat dhe për të cilat janë të disponueshme të dhëna të mjaftueshme për të matur vlerën e drejtë, duke maksimizuar përdorimin e inputeve përkatëse të verifikueshme dhe duke minimizuar përdorimin e inputeve të paverifikueshme.**
- 62 Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është që të vlerësojë çmimin me të cilin një transaksion i zakonshëm për të shitur aktivin ose për të transferuar pasivin do të ndodhte në mes të pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes, sipas kushteve aktuale të tregut. Tre teknikat e vlerësimit, të përdorura gjerësisht, janë metoda e tregut, *metoda e kostos* dhe metoda e të ardhurave. Aspektet kryesore të këtyre metodave janë përmbledhur në paragrafët B5-

B11. Një njësi ekonomike do të përdorë teknikat e vlerësimit në përputhje me një ose më shumë prej këtyre metodave për të matur vlerën e drejtë.

- 63 Në disa raste është e përshtatshme një teknikë vlerësimi e vetme (p.sh. gjatë vlerësimit të një aktivi ose një pasivi duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për aktive ose pasive të njëjta). Në raste të tjera, janë të përshtatshme teknikat e shumëfishta të vlerësimit (p.sh. ky mund të jetë rasti kur bëhet vlerësimi i një njësie gjeneruese të mjeteve monetare). Në qoftë se përdoren teknikat e shumëfishta të vlerësimit për të matur vlerën e drejtë, rezultatet (dmth. të dhënat përkatëse të vlerës së drejtë) do të vlerësohen duke pasur parasysh arsyeshmërinë e intervalit të vlerave të sugjeruara nga këto rezultate. Një matje e vlerës së drejtë është pika në këtë interval që është më përfaqësuesja e vlerës së drejtë sipas rrethanave.
- 64 Nëse në njohjen fillestare çmimi i transaksionit është vlera e drejtë dhe në periudhat e mëvonshme do të përdoret një teknikë vlerësimi, që përdor inpute të paverifikueshme për të matur vlerën e drejtë, teknika e vlerësimit do të kalibrohet në mënyrë që në njohjen fillestare rezultati i teknikës së vlerësimit të jetë i barabartë me çmimin e transaksionit. Kalibrimi siguron që teknika e vlerësimit pasqyron kushtet aktuale të tregut, dhe kjo ndihmon që njësia ekonomike të përcaktojë nëse është i nevojshëm një rregullim në teknikën e vlerësimit (p.sh. mund të jetë një karakteristikë e aktivitetit ose pasivit që nuk është kapur nga teknika e vlerësimit). Pas njohjes fillestare, gjatë matjes së vlerës së drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi apo teknika që përdorin inpute të paverifikueshme, një njësi ekonomike do të sigurojë që këto teknika vlerësimi të pasqyrojnë të dhënat e verifikueshme të tregut (p.sh. çmimi për një aktiv ose pasiv të ngjashëm) në datën e matjes.
- 65 Teknikat e vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë do të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme. Megjithatë, një ndryshim në një teknikë vlerësimi ose në zbatimin e saj (p.sh. një ndryshim në ponderim, kur përdoren teknikat e shumëfishta të vlerësimit ose një ndryshim në një rregullim të zbatuar për një teknikë vlerësimi) është i përshtatshëm, nëse ndryshimi çon në një matje që është njëlloj ose më përfaqësuese e vlerës së drejtë sipas rrethanave. Ky mund të jetë rasti, për shembull, nëse ndodh ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme:
- (a) zhvillimi i tregjeve të reja;
  - (b) informacioni i ri vihet në dispozicion;
  - (c) informacioni i përdorur më parë nuk është më në dispozicion;
  - (d) teknikat e vlerësimit përmirësohen; ose
  - (e) kushtet e tregut ndryshojnë.
- 66 Rishikimet që janë si rrjedhojë e një ndryshimi në teknikën e vlerësimit apo në zbatimin e saj do të trajtohen në kontabilitet si ndryshim në vlerësimin kontabël në përputhje me SNK 8. Megjithatë, dhënia e informacioneve shpjeguese në SNK 8 për një ndryshim në vlerësimin kontabël nuk është e

nevojshme për rishikimet që janë rrjedhojë e një ndryshimi në një teknikë vlerësimi ose në zbatimin e saj.

## Inputet për teknikat e vlerësimit

### Parime të përgjithshme

- 67 **Teknikat e vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë do të duhet të maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të verifikueshme dhe do të duhet të minimizojnë përdorimin e inputeve të paverifikueshme.**
- 68 Shembuj të tregjeve në të cilat inputet mund të jenë të verifikueshme për disa aktive dhe pasive (p.sh. instrumente financiare) përfshijnë tregjet e këmbimit, tregjet e drejtpërdrejtë, tregjet me ndërmjetësim dhe tregjet kryesore të letrave me vlerë (shih paragrafin B34).
- 69 Një njësi ekonomike do të zgjedhë inputet që janë në përputhje me karakteristikat e aktivitetit ose pasivitetit, që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në një transaksion për aktivin ose pasivin (shih paragrafët 11 dhe 12). Në disa raste, këto karakteristika çojnë në kryerjen e një rregullimi, i tillë si një prim ose skonto (p.sh. një prim kontrolli apo skonto interesi jo-kontrollues). Megjithatë, një matje e vlerës së drejtë nuk do të përfshijë një prim ose skonto që është në kundërshtim me njësinë e llogarisë në SNRF, që kërkon ose lejon matjen e vlerës së drejtë (shih paragrafët 13 dhe 14). Primet ose skontot që e pasqyrojnë madhësinë si një karakteristikë e zotërimit prej njësisë ekonomike mbajtëse (në veçanti, një faktor bllokues që rregullon çmimin e kuotuar të një aktiviteti ose pasivi, meqë vëllimi normal ditore tregtar i tregut nuk është i mjaftueshëm për të absorbuar sasinë e zotëruar nga njësia ekonomike, siç përshkruhet në paragrafin 80) dhe jo si një karakteristikë e aktivitetit ose pasivitetit (p.sh. një prim kontrolli gjatë matjes së vlerës së drejtë të një interesi kontrollues), nuk janë të lejuara në matjen e vlerës së drejtë. Në të gjitha rastet, nëse ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv (p.sh. një input i *Nivelit 1*) për një aktiv ose një pasiv, njësia ekonomike do ta përdorë këtë çmim pa i bërë rregullim gjatë matjes së vlerës së drejtë, përveç siç është specifikuar në paragrafin 79.

### Inputet e bazuara në çmimet e kërkuara dhe të ofruara

- 70 Në qoftë se një aktiv ose pasiv, i matur me vlerën e drejtë, ka një çmim të kërkuar dhe të ofruar (p.sh. një input nga një treg ku tregtarët marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë), çmimi brenda marzhitit midis çmimit të kërkuar dhe të ofruar, që është më përfaqësuesi i vlerës së drejtë sipas rrethanave, do të përdoret për të matur vlerën e drejtë, pavarësisht se ku është kategorizuar inputi sipas hierarkisë të vlerës së drejtë (dmth Niveli 1, 2 ose 3; shih paragrafët 72-90). Përdorimi i çmimeve të ofertës për pozicionet e aktiveve



dhe çmimeve të kërkesës për pozicionet e pasiveve është i lejueshëm, por nuk është i detyrueshëm.

- 71 Ky SNRF nuk përjashton përdorimin e çmimit mesatar të tregut ose konvencione të tjera për caktimin e çmimit që janë përdorur nga pjesëmarrësit e tregut si një mjet praktik për matjet e vlerës së drejtë brenda marzhit midis çmimit të kërkuar dhe të ofruar.

## Hierarkia e vlerës së drejtë

- 72 Për të rritur qëndrueshmërinë dhe krahasueshmërinë në matjet e vlerës së drejtë dhe informacionet përkatëse shpjeguese, ky SNRF përcakton një hierarki të vlerës së drejtë që kategorizon në tri nivele (shih paragrafët 76-90) inputet e teknikave të vlerësimit, të përdorura për të matur vlerën e drejtë. Hierarkia e vlerës së drejtë i jep më tepër prioritet çmimeve të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për aktivet ose pasivet e njëjta (Niveli 1 i inputeve) dhe më pak prioritet inputeve të paverifikueshme (Niveli 3 i inputeve).
- 73 Në disa raste, inputet e përdorura për të matur vlerën e drejtë të një aktivi ose të një pasivi mund të kategorizohen në nivele të ndryshme të hierarkisë së vlerës së drejtë. Në këto raste, matja me vlerën e drejtë kategorizohet, në tërësinë e saj, në të njëjtin nivel të hierarkisë së vlerës së drejtë, si niveli më i ulët i inputit, që është i rëndësishëm për tërë matjen. Për të bërë vlerësimin e rëndësishëm së një inputi të veçantë për tërë matjen kërkohet gjykim, duke marrë parasysh faktorë të veçantë për aktivin ose pasivin. Rregullimet për të arritur në matjet e bazuara në vlerën e drejtë, të tilla si kostot e shitjes, kur bëhet matja me vlerën e drejtë minus kostot për shitje, nuk do të merren parasysh gjatë përcaktimit të nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilin është kategorizuar një matje me vlerën e drejtë.
- 74 Disponueshmëria e inputeve përkatëse dhe subjektiviteti relativ i tyre mund të ndikojë në zgjedhjen e teknikave të përshtatshme të vlerësimit (shih paragrafin 61). Megjithatë, hierarkia e vlerës së drejtë i jep prioritet inputeve për teknikat e vlerësimit, dhe jo teknikave të vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë. Për shembull, një matje e vlerës së drejtë që kryhet duke përdorur një teknikë të vlerës aktuale mund të kategorizohet në Nivelin 2 ose Nivelin 3, në varësi të inputeve që janë të rëndësishme për tërë matjen dhe nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë, sipas të cilit janë të kategorizuar këto inpute.
- 75 Nëse një input i verifikueshëm kërkon të bëhet një rregullim duke përdorur një input të paverifikueshëm dhe se ky rregullim çon në mënyrë të konsiderueshme në një matje më të lartë ose më të ulët të vlerës së drejtë, rezultati i matjes do të kategorizohet në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë. Për shembull, nëse një pjesëmarrës tregu do të marrë parasysh efektin e një kufizimi në shitjen e një aktivi gjatë vlerësimit të çmimit për aktivin, njëسيا ekonomike do ta përshtatë çmimin e kuotuar për të pasqyruar efektin e këtij kufizimi. Në qoftë se çmimi i kuotuar është një *input* i Nivelit 2 dhe

rregullimi është një input i paverifikueshëm, që është i rëndësishëm për tërë matjen, matja do të kategorizohet në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë.

## **Inputet e Nivelit 1**

- 76 Inputet e nivelit 1 janë çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive, për aktive ose pasive të njëjtë, që njësia ekonomike ka mundësi t'i përdorë në datën e matjes.
- 77 Një çmim i kuotuar në një treg aktiv siguron evidencën më të besueshme të vlerës së drejtë dhe do të përdoret, pa u rregulluar, për të matur vlerën e drejtë, sa herë që është i disponueshëm, përveç siç është përcaktuar në paragrafin 79.
- 78 Një input i Nivelit 1 do të jetë i përdorshëm për shumë aktive financiare dhe pasive financiare, disa prej të cilave mund të shkëmbehen në tregjet aktive të shumëfishta (p.sh. në shkëmbime të ndryshme). Prandaj, në Nivelin 1 i vihet theksi njëjloj si përcaktimit të:
- (a) tregut kryesor për aktivin ose pasivin, ose, në mungesë të një tregu kryesor, tregut më të favorshëm për aktivin ose pasivin; dhe
  - (b) nëse njësia ekonomike mund të hyjë në një transaksion për aktivin ose pasivin, me çmimin në këtë treg, në datën e matjes.
- 79 Një njësi ekonomike nuk do të bëjë një rregullim në një input të Nivelit 1, përveç se në rrethanat e mëposhtme:
- (a) kur një njësi ekonomike zotëron një numër të madh aktivesh dhe pasivesh të ngjashme (por jo identike) (p.sh. letra me vlerë të borxhit), që maten me vlerën e drejtë dhe është i disponueshëm një çmim i kuotuar në një treg aktiv, por që nuk është lehtësisht i përdorshëm për secilin prej këtyre aktiveve ose pasiveve në mënyrë individuale (pra duke pasur parasysh numrin e madh të aktiveve ose pasiveve të ngjashme, të zotëruara nga njësia ekonomike, do të ishte e vështirë të merrej informacion për caktimin e çmimit për secilin aktiv ose pasiv individual në datën e matjes). Në këtë rast, një praktikë e dobishme do të ishte që një njësi ekonomike të masë vlerën e drejtë duke përdorur një metodë alternative çmimi që nuk mbështetet ekskluzivisht mbi çmimet e kuotuar (p.sh. çmimi matricë). Megjithatë, përdorimi i një metode alternative çmimi çon në matjen e vlerës së drejtë që kategorizohet në një nivel më të ulët të hierarkisë së vlerës së drejtë.
  - (b) kur një çmim i kuotuar në një treg aktiv nuk përfaqëson vlerën e drejtë në datën e matjes. Ky mund të jetë rasti, për shembull, kur ngjarje të rëndësishme (të tilla si transaksionet në një treg kryesor, tregtimet në një treg të ndërmjetësuar ose njoftimet) ndodhin pas mbylljes së një tregu, por para datës së matjes. Një njësi ekonomike do të vendosë dhe do ta zbatojë me qëndrueshmëri një politikë për identifikimin e këtyre

ngjarjeve që mund të ndikojnë në matjet e vlerës së drejtë. Megjithatë, nëse çmimi i kuotuar është rregulluar në lidhje me informacionin e ri, rregullimi çon në një matje të vlerës së drejtë që kategorizohet në një nivel më të ulët të hierarkisë së vlerës së drejtë.

- (c) kur matja e vlerës së drejtë të një pasivi ose të një instrumenti kapitali neto të njësisë ekonomike, duke përdorur çmimin e kuotuar të zërit identik që tregtohet si një aktiv në një treg aktiv dhe ky çmim duhet të rregullohet për faktorë të veçantë të zërit ose aktivitetit (shih paragrafin 39). Nëse nuk është e nevojshme të bëhet rregullim në çmimin e kuotuar të aktivitetit, rezultati është një matje e vlerës së drejtë që kategorizohet në Nivelin 1 të hierarkisë së vlerës së drejtë. Megjithatë, çdo rregullim në çmimin e kuotuar të aktivitetit çon në matjen e vlerës së drejtë që kategorizohet në një nivel më të ulët të hierarkisë së vlerës së drejtë.

- 80 Nëse një njësi ekonomike ka gjendje në një aktiv ose pasiv të vetëm (duke përfshirë një gjendje të përbërë nga një numër i madh aktiveve ose pasiveve identike, të tilla si zotërimi i instrumenteve financiare) dhe aktiviteti ose pasivi tregtohet në një treg aktiv, vlera e drejtë e aktivitetit ose pasivit do të matet sipas Nivelit 1, si prodhim i çmimit të kuotuar për aktivin ose pasivin individual me sasinë e zotëruar nga njësi ekonomike. Ky është rasti edhe kur vëllimi normal ditor i tregtimit në një treg nuk është i mjaftueshëm për të absorbuar sasinë e zotëruar dhe porosinë e bëra për shitjen e gjendjes në një transaksion të vetëm mund të ndikojnë në çmimin e kuotuar.

## **Inpute të Nivelit 2**

- 81 Inpute të Nivelit 2 janë inpute të tjera përveç se çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1, që janë të evidentueshëm për aktivin ose pasivin, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi.
- 82 Nëse aktiviteti ose pasivi ka një afat të caktuar (kontraktual), një input i Nivelit 2 duhet të jetë i verifikueshëm kryesisht gjatë afatit të plotë të aktivitetit ose pasivit. Inputet e Nivelit 2 përfshijnë në vijim:
- (a) çmimet e kuotuar për aktive ose pasive të ngjashme në tregje aktive.
- (b) çmimet e kuotuar për aktive ose pasive të njëjtë ose të ngjashëm në tregjet që nuk janë aktive.
- (c) inputet përveç çmimeve të kuotuar që janë të evidentueshëm për aktivin ose pasivin, për shembull:
- (i) normat e interesit dhe kurbat e rendimentit, të evidentuara zakonisht në intervale të kuotuar;
- (ii) luhatjet e nënkuptuara; dhe
- (iii) marzhet e kredisë.

(d) *Inputet e vërtetuara të tregut.*

- 83 Rregullimet në inputet e Nivelit 2 do të ndryshojnë në varësi të faktorëve të veçantë të aktivitetit ose pasivitetit. Këta faktorë përfshijnë në vijim:
- (a) gjendjen apo vendndodhjen e aktivitetit;
  - (b) shkallën e lidhjes së inputeve me zërat që janë të krahasueshme me aktivitetin ose pasivitetin (duke përfshirë ata faktorë të përshkruar në paragrafin 39); dhe
  - (c) volumi apo niveli i aktivitetit në tregjet ku janë mbikëqyrur inputet.
- 84 Një rregullim në një input të Nivelit 2, që është i rëndësishëm për tërë matjen, mund të çojë në një matje të vlerës së drejtë, kategorizuar në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, në qoftë se rregullimi përdor inpute të rëndësishme të paverifikueshme.
- 85 Paragrafi B35 përshkruan përdorimin e inputeve të Nivelit 2 për aktive dhe pasive të veçantë.

### **Inpute të Nivelit 3**

- 86 Inputet e Nivelit 3 janë inpute të paverifikueshme për aktivitetin ose pasivitetin.
- 87 Inputet e paverifikueshme do të përdoren për të matur vlerën e drejtë në atë masë që inputet e verifikueshme nuk janë të disponueshme, pra merren parasysh situatat në të cilat ka pak, nëse ka, aktivitet tregu për aktivitetin ose pasivitetin në datën e matjes. Megjithatë, objektivi i matjes së vlerës së drejtë mbetet i njëjtë, pra një çmim daljeje në datën e matjes nga perspektiva e një pjesëmarrësi tregu, që zotëron aktivitetin ose ka marrë përsipër detyrimin. Prandaj, inputet e paverifikueshme do të pasqyrojnë supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin gjatë caktimit të çmimit të aktivitetit ose pasivitetit, duke përfshirë edhe supozimet rreth rrezikut.
- 88 Supozimet për rrezikun përfshijnë rrezikun e vetvetishëm në një teknikë vlerësimi të veçantë, e përdorur për të matur vlerën e drejtë (e tillë si një model për caktimin e çmimit), dhe rrezikun e vetvetishëm në inputet për teknikën e vlerësimit. Një matje që nuk përfshin një rregullim për rrezikun nuk do të përfaqësojë një matje të vlerës së drejtë, në qoftë se pjesëmarrësit e tregut do të përfshinin një të tillë për caktimin e çmimit të aktivitetit ose pasivitetit. Për shembull, mund të jetë e nevojshme që të bëhet një rregullim i rrezikut kur ka pasiguri të rëndësishme në matje (p.sh. kur ka pasur një rënie të konsiderueshme në vëllimin ose nivelin e aktivitetit në krahasim me aktivitetin normal të tregut të aktivitetit ose pasivitetit, ose të aktiveve ose pasiveve të ngjashme, dhe njësi ekonomike ka vendosur që çmimi i transaksionit ose çmimi i kuotuar nuk përfaqëson vlerën e drejtë, siç përshkruhet në paragrafët B37–B47).
- 89 Një njësi ekonomike do të zhvillojë inpute të verifikueshme duke përdorur informacionin më të mirë që është në dispozicion sipas rrethanave, të cilat

mund të përfshijnë të dhënat e vetë në jesisë ekonomike. Në zhvillimin e inputeve të paverifikueshme, një njësi ekonomike mund të fillojë me të dhënat e veta, por ajo duhet t'i rregullojë këto të dhëna, nëse informacioni i disponueshëm në mënyrë të arsyeshme tregon se pjesëmarrësit e tjerë të tregut do të përdornin të dhëna të ndryshme apo ka diçka të veçantë për njësinë ekonomike që nuk është e disponueshme për pjesëmarrësit e tjerë të tregut (p.sh. një sinergji specifike e njësisë ekonomike). Një njësi ekonomike nuk është e nevojshme të bëjë përpjekje të lodhshme për të marrë informacion në lidhje me supozimet e pjesëmarrësve të tregut. Megjithatë, një njësi ekonomike do të marrë parasysh të gjithë informacionin, që disponohet në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me supozimet e pjesëmarrësve të tregut. Inputet e verifikueshme, të zhvilluara sipas mënyrës së përshkruar më sipër, konsiderohen supozime të pjesëmarrësve të tregut dhe realizojnë objektivin e matjes së vlerës së drejtë.

- 90 Paragrafi B36 përshkruan përdorimin e inputeve të Nivelit 3 për aktive dhe pasive të veçantë.

## **Dhënia e informacioneve shpjeguese**

---

- 91 **Një njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues që i ndihmon përdoruesit e pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë njëkohësisht sa vijon:**
- (a) **teknikat e vlerësimit dhe inputet e përdorura për të zhvilluar matjet, në rastin kur aktivet dhe pasivet që janë matur me vlerën e drejtë mbi një bazë periodike ose joperoidike në pasqyrën e pozicionit financiar, pas njohjes fillestare.**
  - (b) **efektin e matjeve në fitim ose humbje apo tek të ardhurat e tjera të përgjithshme për periudhën, në rastin e matjeve periodike të vlerës së drejtë, ku përdoren inpute të rëndësishme të paverifikueshme (Niveli 3).**
- 92 Për të realizuar objektivat në paragrafin 91, njësi ekonomike do të marrë parasysh të gjithë sa më poshtë:
- (a) nivelin e hollësisirave të nevojshme për të plotësuar kërkesat për dhënie e informacioneve shpjeguese;
  - (b) sa rëndësi i është kushtuar secilës prej kërkesave të ndryshme;
  - (c) në çfarë mase është bërë totalizimi ose shkëputja; dhe
  - (d) nëse përdoruesit e pasqyrave financiare kanë nevojë për informacion shtesë për të vlerësuar informacionin sasior shpjegues.

Nëse dhënia e informacioneve shpjeguese, e bërë në përputhje me këtë SNRF dhe SNRF-të e tjera, është e pamjaftueshme për të realizuar objektivat

në paragrafin 91, njësisia ekonomike jep informacione shpjeguese shtesë të nevojshme për të realizuar këto objektiva.

- 93 Për të realizuar objektivat në paragrafin 91, një njësi ekonomike jep informacion shpjegues, minimalisht, informacionin e mëposhtëm për secilën klasë të aktiveve dhe pasiveve (shih paragrafin 94 për informacionin mbi përcaktimin e klasave të përshtatshme të aktiveve dhe pasiveve), të matura me vlerën e drejtë (përfshirë matjet e bazuara në vlerën e drejtë sipas objektit të këtij SNRF), në pasqyrën e pozicionit financiar, pas njohjes fillestare:
- (a) arsyet e matjes, për matjet periodike dhe jo-periodike të vlerës së drejtë, matjen me vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese, dhe për matjet jo-periodike të vlerës së drejtë. Matje periodike të vlerës së drejtë të aktiveve ose pasiveve janë ato që SNRF- të e tjera kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese. Matjet jo-periodike të vlerës së drejtë të aktiveve ose pasiveve janë ato që SNRF-të e tjera kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në rrethana të veçanta (p.sh. kur një njësi ekonomike mat një aktiv të mbajtur për shitje me vlerën e drejtë minus kostot për shitje në përputhje me SNRF 5 *Aktivitet afatgjatë të mbajtura për shitje dhe veprimtaritë e ndërprera*, meqë vlera e drejtë e aktivit minus kostot për shitje është më e ulët se vlera kontabël neto e tij).
  - (b) nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilin janë kategorizuar matjet e vlerës së drejtë në tërësinë e tyre (Niveli 1, 2 ose 3), për matjet e vlerës së drejtë periodike dhe joperiodike.
  - (c) shumat e çdo transferimi midis Nivelit 1 dhe Nivelit 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë, arsyet për këto transferime dhe politikën e njësisë ekonomike për të përcaktuar kur kërkohet të bëhen transferimet midis niveleve (shih paragrafin 95), për aktivet dhe pasivet të mbajtura në fund të periudhës raportuese, që janë të matura me vlerën e drejtë mbi një bazë periodike. Për transferimet në çdo nivel do të jepet informacion shpjegues dhe do të trajtohen veças nga transferimet nga çdo nivel.
  - (d) një përshkrim i teknikës (teknikave) së vlerësimit dhe i inputeve të përdorura në matjen e vlerës së drejtë, për matjet periodike dhe joperiodike të vlerës së drejtë, të kategorizuara në Nivelin 2 dhe Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë. Nëse ka pasur një ndryshim në teknikën e vlerësimit (p.sh. ndryshimi nga një metodë e tregut tek një metodë e të ardhurave ose përdorimi i një teknikë vlerësimi shtesë), njësisia ekonomike jep informacione shpjeguese për këtë ndryshim dhe arsyen (arsyet) pse e ka bërë atë. Për matjet e vlerës së drejtë, të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, një njësi ekonomike duhet të japë informacion sasior rreth të inputeve të rëndësishme, të paverifikueshme, të përdorura në matjen e vlerës së drejtë. Një njësi ekonomike nuk është e nevojshme të përgatisë informacion sasior në përputhje me këtë kërkesë për dhënie informacioni shpjegues, nëse inputet sasiore të paverifikueshme nuk janë të zhvilluara nga njësisia ekonomike kur matet vlera e drejtë (p.sh.

kur një njësi ekonomike përdor çmimet nga transaksionet e mëparshme ose informacionin nga të tretët për caktimin e çmimit pa i bërë rregullim). Megjithatë, kur jep informacion shpjegues, një njësi ekonomike nuk mund të injorojë inputet sasiore të paverifikueshme, që janë të rëndësishme për matjen e vlerës së drejtë dhe janë të disponueshme në mënyrë të arsyeshme nga njësia ekonomike.

- (e) një rakordim mes tepricave të çeljes dhe tepricave të mbylljes, për matjet periodike të vlerës së drejtë, të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, duke dhënë informacion shpjegues në mënyrë të veçantë për ndryshimet gjatë periudhës, në lidhje me:
  - (i) fitimet ose humbjet neto gjithsej, të njohura në fitim ose humbje, dhe nënzërin (nënzërat) në pasqyrën e të ardhurave në të cilin këto fitime neto ose humbje neto janë të njohura.
  - (ii) fitimet ose humbjet neto gjithsej për periudhën, të njohura në të ardhura të tjera të përgjithshme, dhe nënzërin (nënzërat) në të ardhura të tjera të përgjithshme, në të cilin janë të njohura këto fitime ose humbje neto.
  - (iii) blerjet, shitjet, emetimet dhe shlyerjet (për secilin prej këtyre llojeve të ndryshimeve jepet informacion shpjegues më vete).
  - (iv) shuma e çdo transferimi në ose nga Nivelin 3 i hierarkisë së vlerës së drejtë, arsyet e këtyre transferimeve dhe politikën e njësisë ekonomike për të përcaktuar se kur mund të bëhen transferimet midis niveleve (shih paragrafin 95). Për transferimet në Nivelin 3 do të jepen informacione shpjeguese dhe të përshkruhen veçmas prej transferimeve nga Nivelin 3.
- (f) shumën e fitimeve ose humbjeve neto gjithsej për periudhën, sipas pikës (e)(i), përfshirë në fitimin ose humbjen, që i takon ndryshimit në fitimet ose humbjet neto të përcaktuara, që lidhen me aktivet dhe pasivet e mbajtura në fund të periudhës raportuese, dhe nënzërin (nënzërat) në fitim ose humbje, në të cilën njihen këto fitime ose humbje neto të përcaktuara, për matjet periodike të vlerës së drejtë, të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë.
- (g) një përshkrim të proceseve të vlerësimit, të përdorura nga njësia ekonomike (duke përfshirë, për shembull, si i vendos një njësi ekonomike politikën dhe procedurat e saj të vlerësimit dhe si i analizon ndryshimet në matjet e vlerës së drejtë nga periudha në periudhë), për matjet periodike dhe jo-periodike të vlerës së drejtë, të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë.
- (h) për matjet periodike të vlerës së drejtë, të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë:
  - (i) për të gjitha këto matje, një përshkrim të ndjeshmërisë së matjes së vlerës së drejtë ndaj ndryshimeve në inputet e

paverifikueshme, nëse një ndryshim në këto inputenë një madhësi tjetër mund të çojë në mënyrë të konsiderueshme në një matje më të lartë ose më të ulët të vlerës së drejtë. Nëse ka ndërlidhje midis këtyre inputeve dhe inputeve të tjera të paverifikueshme, të përdorura në matjen e vlerës së drejtë, një njësi ekonomike do të bëjë gjithashtu një përshkrim të këtyre ndërlidhjeve dhe të mënyrës se si ato mund të zmadhojnë apo zbutin efektin e ndryshimeve në të inpteve të paverifikueshme në matjen e vlerës së drejtë. Në përputhje me këtë kërkesë të dhënies së informacioneve shpjeguese, përshkrimi i ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve në inputet e paverifikueshme, do të përfshijë, minimumi, inpute të paverifikueshme për të cilat jepet informacion shpjegues në përputhje me pikën (d).

- (ii) për aktivet financiare dhe pasivet financiare, nëse në sajë të një ndryshimi të një ose më shumë prej inputeve të paverifikueshme, për të pasqyruar supozimet alternative të mundshme, të arsyeshme, do të ndryshonte në mënyrë të ndjeshme vlera e drejtë, një njësi ekonomike do ta paraqesë këtë fakt dhe do të japë informacion shpjegues për efektin e këtyre ndryshimeve. Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese si është llogaritur efekti i një ndryshimi për pasqyrimin e një supozimi alternativ të arsyeshëm, të mundshëm. Për këtë qëllim, shkalla e ndjeshmërisë do të gjykohet në lidhje me fitimin ose humbjen dhe aktivet gjithsej ose pasivet gjithsej, ose, në lidhje me kapitalin neto gjithsej kur ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhurat e tjera të përgjithshme.
- (i) për matjet periodike dhe jo-periodike të vlerës së drejtë, nëse shkalla e përdorimit më të lartë dhe më të mirë e një aktivi jofinanciar ndryshon nga përdorimi i tij aktual, njësia ekonomike jep informacione shpjeguese për këtë fakt dhe pse aktivi jofinanciar po përdoret sipas një mënyre që ndryshon nga shkalla e përdorimit të tij më të lartë dhe më të mirë.

94 Një njësi ekonomike do të përcaktojë klasat e duhura të aktiveve dhe pasiveve bazuar në sa vijon:

- (a) natyrën, karakteristikat dhe rreziqet e aktivit ose pasivit; dhe
- (b) nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë sipas së cilës është kategorizuar matja e vlerës së drejtë.

Numri i klasave mund të kërkohej të jetë më i madh për matjet e vlerës së drejtë, të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, sepse këto matje kanë një shkallë më të madhe pasigurie dhe subjektiviteti. Përcaktimi i klasave të përshtatshme të aktiveve dhe pasiveve, për të cilat jepen informacione shpjeguese rreth matjeve të vlerës së drejtë, kërkon të përdoret gjykimi. Një klasë e aktiveve dhe pasiveve shpesh do të kërkojë nënndarje më të madhe se ç'janë nënzërat e paraqitur në pasqyrën e



pozicionit financiar. Megjithatë, njësia ekonomike do të japë informacion të mjaftueshëm për të lejuar rakordimin me nënzërat përkatës të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. Nëse një SNRF specifikon klasën për një aktiv ose një pasiv, një njësi ekonomike mund ta përdorë këtë klasë në dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara në këtë SNRF, në qoftë se kjo klasë plotëson kërkesat e këtij paragrafi.

- 95 Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese dhe në vazhdimësi do të ndjekë politikën e saj për përcaktimin se kur mendohet të kenë ndodhur transferimet mes niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë, në përputhje me paragrafin 93 (c) dhe (e) (iv). Politika në lidhje me kohën e njohjes së transferimeve do të jetë e njëjtë si për transferimet tek nivelet, ashtu dhe për transferimet nga nivelet. Shembuj të politikave për përcaktimin e kohës të transferimeve përfshijnë në vijim:
- (a) datën e ngjarjes ose ndryshimin në rrethanat që e ka shkaktuar transferimin.
  - (b) fillimin e periudhës raportuese.
  - (c) fundin e periudhës raportuese.
- 96 Nëse një njësi ekonomike merr një vendim të politikës kontabël për të përdorur përjashtimin në paragrafin 48, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 97 Për secilën klasë të aktiveve dhe pasiveve, që nuk janë të matura me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar, por për të cilat është dhënë informacion shpjegues për vlerën e drejtë, një njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues siç kërkohet nga paragrafi 93 (b), (d) dhe (i). Megjithatë, njësia ekonomike nuk është e nevojshme të japë informacione shpjeguese sasiore mbi inputet e rëndësishme të paverifikueshme, të përdorura në matjet e vlerës së drejtë, të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, të kërkuara nga paragrafi 93 (d). Për këto aktive dhe pasive, njësia ekonomike nuk është e nevojshme të japë informacione shpjeguese të tjera të kërkuara nga ky SNRF.
- 98 Për një pasiv të matur me vlerën e drejtë dhe të emetuar në mënyrë të pandashme nga garancia e kredisë nga një palë e tretë, një emetues do të japë informacion shpjegues për ekzistencën e kësaj garancie kredie dhe nëse ajo është pasqyruar në matjen e vlerës së drejtë të pasivit.
- 99 Një njësi ekonomike do të paraqesë informacione shpjeguese sasiore, të kërkuara nga ky SNRF, në një format tabelor, përveç rastit kur një tjetër format është më i përshtatshëm.

## Shtojca A

### Përkufizimet e termave

*Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së.*

<b>treg aktiv</b>	Një treg në të cilin transaksionet për aktivin ose pasivin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm, për të siguruar informacionin për caktimin e çmimit mbi një bazë të vazhdueshme.
<b>metoda e kostos</b>	Një teknikë vlerësimi që pasqyron shumën që do të kërkohej aktualisht për të zëvendësuar kapacitetet e shërbimit të një aktivi (shpesh e referuar si kostoja e zëvendësimit aktual).
<b>çmimi i hyrjes</b>	Çmimi i paguar për të blerë një aktiv ose i pranuar për të marrë përsipër një detyrim në një transaksion këmbimi.
<b>çmimi i daljes</b>	Çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose që do paguhej për të transferuar një pasiv.
<b>fluksi i pritsëm i mjeteve monetare</b>	Mesatarja e ponderuar me probabilitetin (dmth. mesatarja e shpërndarjes) e flukseve monetare të ardhshme të mundshme.
<b>vlera e drejtë</b>	Çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm në mes të pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.
<b>përdorimi më i lartë dhe më i mirë</b>	Përdorimi i një aktivi jo-financiar nga pjesëmarrësit e tregut, që do të maksimizonte vlerën e aktivit ose të grupit të aktiveve dhe pasiveve (p.sh. një biznes), në të cilin aktivi do të përdorej.
<b>metoda e të ardhurave</b>	Teknikat e vlerësimit që konvertojnë shumat e ardhshme (p.sh. flukset e mjeteve monetare ose të ardhurat dhe shpenzimet) në një shumë të vetme aktuale (dmth të skontuar). Matja me vlerën e drejtë përcaktohet mbi bazën e vlerës së sugjeruar nga pritshmëritë e tregut aktual në lidhje me këto shuma të ardhshme.

<b>Inpute</b>	<p>Supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin kur të caktonin çmimin e aktivitetit ose të pasivitetit, duke përfshirë edhe supozimet rreth rrezikut, të tilla si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>(a) rrezikun e vetvetishëm në një teknikë vlerësimi të veçantë, të përdorur për të matur vlerën e drejtë (të tilla si një model për caktimin e çmimit); dhe</li><li>(b) rrezikun e vetvetishëm në inputet për teknikën e vlerësimit.</li></ul> <p>Inputet mund të jenë të verifikueshme ose të paverifikueshme.</p>
<b>inpute Nivel 1</b>	<p>Çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive ose pasive të njëjtë, që njësia ekonomike ka mundësi t'i përdorë në datën e matjes.</p>
<b>inpute Nivel 2</b>	<p>Inpute të tjera, përveç çmimeve të kuotuar, të përfshira në Nivelin 1, që janë të verifikueshme për aktivin ose pasivin, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi.</p>
<b>inpute Nivel 3</b>	<p>Inpute të paverifikueshme për aktivin ose pasivin.</p>
<b>metoda e tregut</b>	<p>Një teknikë vlerësimi që përdor çmimet dhe informacione të tjera përkatëse, të gjeneruara nga transaksionet e tregut, duke përfshirë aktivitet identike ose të krahasueshme (pra të ngjashme), pasivitet ose një grup aktivitet dhe pasivitet, si në rastin e një biznesi.</p>
<b>inpute të vërtetuara në treg</b>	<p>Inpute që rrjedhin ose janë të verifikuara kryesisht nga të dhënat e vrojtueshme të tregut me anën e korrelacionit ose mjeteve të tjera.</p>

<b>pjesëmarrësit e tregut</b>	<p>Blerësit dhe shitësit në tregun kryesor (apo më të favorshëm) të aktivitet ose pasivitet, që kanë të gjitha karakteristikat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Ata janë të pavarur nga njëri-tjetri, pra, ata nuk janë palë të lidhura, siç përcaktohet në SNK 24, edhe pse çmimi në një transaksion me palët e lidhura mund të përdoret si një input në një matje të vlerës së drejtë, në qoftë se njëسيا ekonomike ka evidencë se transaksioni është kryer në kushtet e tregut.</li> <li>(b) Ata janë të mirëinformuar, duke patur një njohje të arsyeshme në lidhje me aktivin ose pasivin dhe transaksionin me të gjithë informacionin e disponueshëm, përfshirë informacionin që mund të merret nëpërmjet përpjekjeve të kujdesshme që janë të zakonshme.</li> <li>(c) Ata janë në gjendje të hyjnë në një transaksion për aktivin ose pasivin.</li> <li>(d) Ata janë të gatshëm të hyjnë në një transaksion për aktivin ose pasivin, pra ata janë të motivuar, por jo të detyruar ose ndryshe të imponuar për ta bërë këtë.</li> </ul>
<b>tregu më i favorshëm</b>	<p>Tregu që maksimizon shumën që do të pranohej për të shitur aktivin ose minimizon shumën që do të paguhej për të transferuar pasivin, duke marrë parasysh kostot e transaksionit dhe shpenzimet e transportit.</p>
<b>rreziku në lidhje me mosrealizimin e performancës</b>	<p>Rreziku që një njësi ekonomike nuk do të përbushë një detyrim. Rreziku në lidhje me mosrealizimin e performancës përfshin, por pa qenë i kufizuar, rrezikun e kredisë të vetë njësisë ekonomike.</p>
<b>inpute të verifikueshme</b>	<p>Inpute që janë zhvilluar duke përdorur të dhëna të tregut, të tilla si informacioni në dispozicion të publikut në lidhje me ngjarjet aktuale ose transaksionet, dhe që pasqyrojnë supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin gjatë caktimit të çmimit të aktivitet ose pasivitet.</p>
<b>transaksion i zakonshëm</b>	<p>Një transaksion, që supozon ekspozimin në treg për një periudhë përpara datës së matjes, për të lejuar aktivitetet e marketingut që janë të zakonshme për transaksionet që përfshijnë të tilla aktive ose pasive, por nuk është një transaksion i detyruar (p.sh. një likuidim i detyruar ose shitje në rast fatkeqësie).</p>

<b>treg kryesor</b>	Tregu me vëllimin dhe nivelin më të madh të aktivitetit për aktivin ose pasivin.
<b>primi i rrezikut</b>	Kompensimi i kërkuar nga pjesëmarrësit e tregut, jo të prirur ndaj rrezikut (kundërshtues), për të përballuar pasigurinë e vetvetishme në flukset monetare të një aktivi ose një pasivi. Gjithashtu, referuar edhe si një 'rregullim i rrezikut'.
<b>kostot e transaksionit</b>	<p>Kostot për shitjen e aktivit ose transferimin e një pasivi në tregun kryesor (ose më të favorshëm) për aktivin ose pasivin, që janë të ngarkueshme drejtpërdrejt gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit të aktivit ose gjatë transferimit të pasivit dhe që plotësojnë njëkohësisht dy kriteret në vijim:</p> <p>(a) Ato rrjedhin drejtpërdrejt nga transaksioni dhe janë thelbësore për të.</p> <p>(b) Ato nuk do të ishin kryer nga njësia ekonomike pa marrë vendimin për shitjen e aktivit ose transferimin e pasivit (të ngjashme me kostot për shitje, sipas përkufizimit në SNRF 5).</p>
<b>kostot e transportit</b>	Kostot që do të kryheshin për të transportuar një aktiv nga vendndodhja e tij aktuale në tregun kryesor (ose më të favorshëm).
<b>njësia e llogarisë</b>	Niveli në të cilin një aktiv ose një pasiv është totalizuar apo ndarë në një SNRF për qëllime të njohjes.
<b>inpute të paverfikueshme</b>	Inpute për të cilat të dhënat e tregut nuk janë të disponueshme dhe që zhvillohen duke përdorur informacionin më të mirë të disponueshëm në lidhje me supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin gjatë caktimit të çmimit të aktivit ose pasivit.

## Shtojca B

### Udhëzim për zbatim

*Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së. Ajo përshkruan zbatimin e paragrafëve 1-99 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të SNRF-së.*

- B1 Gjykimet e përdorura në situata vlerësimi të ndryshme mund të jenë të ndryshme. Kjo shtojcë përshkruan gjykime që mund të përdoren kur një njësi ekonomike mat vlerën e drejtë në situata vlerësimi të ndryshme.

### **Metoda e matjes me vlerën e drejtë**

---

- B2 Objektivi i matjes me vlerën e drejtë është që të vlerësojë çmimin me të cilin një transaksion i zakonshëm për shitjen e aktivit ose për transferimin e pasivit, do të zhvillohej në mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes, sipas kushteve aktuale të tregut. Një matje me vlerën e drejtë kërkon që një njësi ekonomike të përcaktojë të gjitha në vijim:
- (a) aktivin ose pasivin e veçantë, që është objekt i matjes (në përputhje me njësinë e tij të llogarisë).
  - (b) për një aktiv jo-financiar, kushtin paraprak të vlerësimit që është i përshtatshëm për matjen (në përputhje me përdorimin e tij më të lartë dhe më të mirë).
  - (c) tregun kryesor (ose më i favorshëm) për aktivin ose pasivin.
  - (d) teknikën (teknikat) e vlerësimit, të përshtatshme për matjen, duke marrë parasysh disponueshmërinë e të dhënave, me anën e të cilave zhvillohen inputet që përfaqësojnë supozimet, që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin gjatë caktimit të çmimit të aktivit ose pasivit dhe nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë sipas të cilës janë kategorizuar inputet.

### **Kushti paraprak i vlerësimit për aktivet jo-financiare (paragrafët 31-33)**

---

- B3 Gjatë matjes me vlerën e drejtë të një aktivi jo-financiar, që përdoret në kombinim me aktive të tjera si një grup (si i instaluar apo ndryshe i konfiguruar për përdorim) ose në kombinim me aktive të tjera dhe pasive (p.sh. një biznes), efekti i kushtit paraprak të vlerësimit varet nga rrethanat. Për shembull:
- (a) vlera e drejtë e aktivit mund të jetë e njëjtë nëse aktivi është përdorur mbi një bazë të veçuar ose në kombinim me aktive të tjera ose me aktive dhe pasive të tjera. Ky mund të jetë rasti kur aktivi është një

biznes që pjesëmarrësit e tregut do të vazhdonin ta kryenin. Në këtë rast, transaksioni do të përfshijë vlerësimin e biznesit në tërësi. Përdorimi i aktiveve si një grup në një biznes në vijimësi do të gjeneronte sinergji, të cilat do të ishin të vlefshme për pjesëmarrësit e tregut (dmth sinergjitë e pjesëmarrësve të tregut që do të ndikonin, pra, në vlerën e drejtë të aktivitetit qoftë mbi bazë të veçuar, qoftë në kombinim me aktive të tjera ose me aktive dhe pasive të tjera).

- (b) përdorimi i një aktivi, në kombinim me aktive të tjera ose me aktive dhe pasive të tjera, mund të përfshihet në matjen me vlerën e drejtë nëpërmjet rregullimeve në vlerën e aktivitetit të përdorur në një bazë të veçuar. Ky mund të jetë rasti, kur aktivi është një makineri dhe matja me vlerën e drejtë përcaktohet duke përdorur një çmim të evidentueshëm për një makineri të ngjashme (jo e instaluar apo ndryshe jo e konfiguruar për përdorim), i rregulluar për kostot e transportit dhe instalimit, në mënyrë që matja me vlerën e drejtë të pasqyrojë gjendjen aktuale dhe vendndodhjen e makinerisë (e instaluar dhe e konfiguruar për përdorim).
- (c) përdorimi i një aktivi, në kombinim me aktive të tjera ose me aktive dhe pasive të tjera mund të përfshihet në matjen me vlerën e drejtë nëpërmjet supozimeve të pjesëmarrësve të tregut, të përdorura për të matur vlerën e drejtë të aktivitetit. Për shembull, nëse aktivi është një inventar prodhimi në proces, që është unik, dhe pjesëmarrësit e tregut do ta konvertonin inventarin në produkte të gatshme, vlera e drejtë e inventarit do të supozonte se pjesëmarrësit e tregut kanë marrë ose do të blinin ndonjë makineri të specializuar të nevojshme për të shndërruar inventarin në produkte të gatshme.
- (d) përdorimi i një aktivi, në kombinim me aktive të tjera ose me aktive dhe pasive të tjera mund të përfshihet në teknikën e vlerësimit, e përdorur për të matur vlerën e drejtë të aktivitetit. Ky mund të jetë rasti kur përdoret metoda e të ardhurave të tepërta për disa periudha, për të matur vlerën e drejtë të një aktivi afatgjatë jomaterial, sepse kjo teknikë vlerësimi në mënyrë të veçantë merr parasysh kontributin e çdo aktivi plotësues dhe pasiveve përkatëse në grupin në të cilin do të përdorej një aktiv i tillë afatgjatë jomaterial.
- (e) në situata më të kufizuara, kur një njësi ekonomike përdor një aktiv brenda një grupi aktivesh, njësi ekonomike mund të masë aktivin me një shumë që përafrohet me vlerën e tij të drejtë kur shpërndahet vlera e drejtë e grupit të aktiveve në aktivet individuale të grupit. Ky mund të jetë rasti, kur vlerësimi përfshin pasuri të paluajtshme dhe vlera e drejtë e pasurisë së përmirësuar (dmth një grup aktivi) shpërndahet në aktivet të saj përbërëse (të tilla si toka dhe bonifikimet).

## **Vlera e drejtë në njohjen fillestare (paragrafët 57–60)**

- B4 Gjatë përcaktimit nëse vlera e drejtë në njohjen fillestare është e barabartë me çmimin e transaksionit, një njësi ekonomike do të marrë në konsideratë faktorët e veçantë të transaksionit dhe të aktivit ose të pasivit. Për shembull, çmimi i transaksionit nuk mund të përfaqësojë vlerën e drejtë të një aktivi ose të një pasivi në njohjen fillestare, në qoftë se ekzistojnë ndonjë nga kushtet e mëposhtme:
- (a) Transaksioni është mes palëve të lidhura, edhe pse çmimi në një transaksion me palët e lidhura mund të përdoret si një input në një matje me vlerën e drejtë, në qoftë se njësi ekonomike ka evidencë se transaksioni është kryer në kushtet e tregut.
  - (b) Transaksioni zhvillohet nën presion ose shitësi është i detyruar të pranojë çmimin në transaksion. Për shembull, ky mund të jetë rasti kur shitësi është duke përjetuar vështirësi financiare.
  - (c) Njësia e llogarisë, e përfaqësuar nga çmimi i transaksionit, është e ndryshme nga njësia e llogarisë për aktivin ose pasivin, të matur me vlerën e drejtë. Për shembull, ky mund të jetë rasti, kur aktivi ose pasivi i matur me vlerën e drejtë është vetëm një nga elementet në transaksion (p.sh. në një kombinim biznesi), ndërsa transaksioni përfshin të drejtat e papërcaktuara dhe privilegjet që maten veçmas, në përputhje me një tjetër SNRF, apo çmimi i transaksionit përfshin kostot e transaksionit.
  - (d) Tregu në të cilin ndodh transaksioni është i ndryshëm nga tregu kryesor (apo tregu më i favorshëm). Për shembull, këto tregje mund të jenë të ndryshme, nëse njësia ekonomike është një tregtar që hyn në transaksione me klientët në tregun me pakicë, por tregu kryesor (ose më i favorshëm) për transaksionin e daljes është me shitësit e tjerë në tregjet e drejtpërdrejtë.

## **Teknikat e vlerësimit (paragrafët 61–66)**

### **Metoda e tregut**

- B5 Metoda e tregut përdor çmimet dhe informacionet e tjera përkatëse, të gjeneruara nga transaksionet e tregut, përfshirë aktivet e njëjta ose të krahasueshme (pra të ngjashme), detyrimet ose një grup të aktiveve dhe pasiveve, të tilla si një biznes.
- B6 Për shembull, teknikat e vlerësimit në përputhje me metodën e tregut shpesh përdorin shumëfishat e tregut që rrjedhin nga një tërësi të dhënash të krahasueshme. Shumëfishat mund të jenë në intervale me një shumëfish të ndryshëm për çdo të dhënë të krahasueshme. Zgjedhja e shumëfishave të



duhur brenda intervalit, kërkon gjykim, duke pasur parasysh faktorët cilësorë dhe sasiorë specifikë për matjen.

- B7 Teknikat e vlerësimit në përputhje me metodën e tregut përfshijnë caktimin e çmimit matricë. Çmimi matricë është një teknikë matematikore që përdoret kryesisht për vlerën e disa llojeve të instrumenteve financiare, të tilla si letrat me vlerë të borxhit, pa u mbështetur ekskluzivisht në çmimet e kuotuar për letra me vlerë specifike, po duke u mbështetur në marrëdhëniet e letrave me vlerë me letra bazë të tjera me vlerë të kuotuar.

## Metoda e kostos

- B8 Metoda e koston pasqyron shumën që do të kërkohej aktualisht për të zëvendësuar kapacitetet e shërbimit të një aktivi (shpesh e referuar si kostoja e zëvendësimit aktual).
- B9 Nga perspektiva e një shitësi pjesëmarrës në treg, çmimi që do të pranohej për aktivin, është i bazuar në koston për një blerës pjesëmarrës në treg për të blerë ose ndërtuar një aktiv zëvendësues i shërbimeve të krahasueshme, të rregulluara për vjetërimin. Kjo ndodh sepse një blerës pjesëmarrës në treg nuk do të paguante më shumë për një aktiv se sa shuma me të cilën ai do të mund të zëvendësonte kapacitetet e shërbimit të këtij aktivi. Vjetërimi përfshin përkeqësimin fizik, vjetërimin funksional (teknologjik) dhe vjetërimin ekonomik (të jashtëm) dhe është më i gjerë se amortizimi për qëllime të raportimit financiar (një shpërndarje e koston historike) apo qëllime tatimore (duke përdorur jetët e specifikuar të shërbimit). Në shumë raste, metoda e zëvendësimit të koston aktual përdoret për të matur vlerën e drejtë të aktiveve afatgjata materiale, që përdoren në kombinim me aktive të tjera ose me aktive dhe pasive të tjera.

## Metoda e të ardhurave

- B10 Metoda e të ardhurave konverton shumat e ardhshme (p.sh. flukset e mjeteve monetare ose të ardhurat dhe shpenzimet) në një shumë të vetme aktuale (dmth të skontuar). Kur përdoret metoda e të ardhurave, matja me vlerën e drejtë pasqyron pritshmëritë aktuale të tregut në lidhje me këto shumat të ardhshme.
- B11 Këto teknika të vlerësimit përfshijnë, për shembull, sa më poshtë:
- (a) teknikat e vlerës aktuale (shih paragrafët B12–B30);
  - (b) modelet e vlerësimit të opsioneve, të tilla si formula Black-Scholes-Merton ose një model binomi (dmth një model rrjeti), që ndërthurin teknikat e vlerës aktuale dhe pasqyrojnë edhe vlerën në kohë dhe vlerën e perceptuar të një opsioni; dhe
  - (c) metoda e të ardhurave të tepërta në disa periudha, e cila përdoret për të matur vlerën e drejtë të disa aktiveve jomateriale.

## Teknikat e vlerës aktuale

- B12 Paragrafët B13-B30 përshkruajnë përdorimin e teknikave të vlerës aktuale për të matur me vlerën e drejtë. Këto paragrafë përqëndrohen në një teknikë të rregullimit të normës së skontimit dhe në një teknikë të *fluksit të pritshëm të mjeteve monetare* (vlera aktuale e pritshme). Këto paragrafë as përshkruajnë përdorimin e një teknike të vetme të veçantë të vlerës aktuale, as kufizojnë përdorimin e teknikave të vlerës aktuale për të matur vlerën e drejtë në teknikat e diskutuara. Teknika e vlerës aktuale, e përdorur për të matur vlerën e drejtë, do të varet nga faktet dhe rrethanat e veçanta në lidhje me aktivin ose pasivin e matur (p.sh. nëse çmimet për aktivet ose pasivet e krahasueshme mund të evidnetohen në treg) dhe disponueshmëria e të dhënave të mjaftueshme.

## Përbërësit e një matjeje të vlerës aktuale

- B13 Vlera aktuale (p.sh. një zbatim i metodës së të ardhurave) është një mjet i përdorur për të lidhur shumat e ardhshme (p.sh. flukset apo vlerat monetare) me një shumë aktuale duke përdorur një normë skontimi. Një matje me vlerën e drejtë të një aktivi ose një pasivi, duke përdorur një teknikë të vlerës aktuale, përmbledh të gjitha elementet e mëposhtëm, nga perspektiva e pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes:
- (a) një vlerësim të flukseve monetare të ardhshme për aktivin ose pasivin që matet.
  - (b) pritshmëritë rreth ndryshimeve të mundshme në shumën dhe afatin e flukseve monetare që përfaqësojnë pasigurinë e vetvetishme në flukset monetare.
  - (c) vlerën në kohë të parasë, e përfaqësuar nga norma pa rrezik në aktivet monetare, që kanë datat e maturimit apo kohëzgjatjet që përputhen me periudhën e mbuluar nga flukset e mjeteve monetare dhe nuk paraqesin as pasigurinë në afat, as rrezikun për mospagim të mbajtësit (dmth një normë interesi pa rrezik).
  - (d) çmimin për përballimin e pasigurisë së vetvetishme në flukset e mjeteve monetare (dmth. një prim rreziku).
  - (e) faktorë të tjerë që pjesëmarrësit e tregut do të kishin parasysh sipas rrethanave.
  - (f) për një pasiv, rrezikun për mosrealizimin e performancës në lidhje me këtë pasiv, duke përfshirë rrezikun e kredisë të vetë njësisë ekonomike (dmth i të detyruarit).

*Parime të përgjithshme*

B14 Teknikat e vlerës aktuale ndryshojnë nga mënyra se si ato i përmbledhin elementët në paragrafin B13. Megjithatë, të gjitha parimet e përgjithshme të mëposhtme udhëheqin zbatimin e çdo teknike të vlerës aktuale, e përdorur për të matur vlerën e drejtë:

- (a) Flukset e mjeteve monetare dhe normat e skontimit do të pasqyrojnë supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin gjatë caktimit të çmimit të aktivitetit ose pasivit.
- (b) Flukset e mjeteve monetare dhe normat e skontimit do të marrin parasysh vetëm faktorët që i takojnë aktivitetit ose pasivit që matet.
- (c) Për të shmangur numërimin e dyfishtë ose mosdhënien e efekteve të faktorëve të rrezikut, normat e skontimit do të pasqyrojnë supozimet që janë në përputhje me ato të qenësishme në flukset monetare. Për shembull, një normë skontimi që pasqyron pasiguri në pritshmëritë për mospagesat në të ardhmen është e përshtatshme, kur përdoren flukset monetare kontraktuale të një kredie (dmth një teknikë e rregullimit të normës së skontimit). E njëjta normë nuk do të përdoret nëse përdoren flukset monetare (p.sh. një teknikë e vlerës aktuale të pritshme) të pritshme (dmth. probabiliteti i ponderuar), sepse flukset monetare të pritshme tashmë pasqyrojnë supozimet rreth pasigurisë në mospagesat e ardhshme; në vend të kësaj, do të përdorej një normë skontimi që është proporcionale me rrezikun e vetvetishëm në flukset monetare të pritshme.
- (d) Supozimet rreth flukseve të mjeteve monetare dhe normave të skontimit do të kenë një qëndrueshmëri të brendshme. Për shembull, flukset e mjeteve monetare nominale, të cilat përfshijnë efektin e inflacionit, do të skontohen me një normë që përfshin efektin e inflacionit. Norma e interesit nominal pa rrezik përfshin efektin e inflacionit. Flukset monetare reale, të cilat përjashtojnë efektin e inflacionit, do të skontoheshin me një normë që përjashton efektin e inflacionit. Në mënyrë të ngjashme, flukset monetare pas tatimit do të skontoheshin duke përdorur një normë skontimi pas tatimit. Flukset monetare para tatimit do të skontoheshin me një normë në përputhje me këto flukse monetare.
- (e) Normat e skontimit do të jenë në përputhje me faktorët ekonomikë bazë të monedhës në të cilën janë shprehur flukset e mjeteve monetare.

*Rreziku dhe pasiguria*

B15 Një matje me vlerën e drejtë, duke përdorur teknika të vlerës aktuale, bëhet në kushte të pasigurisë, sepse flukset e mjeteve monetare të përdorura janë vlerësime sesa shuma të njohura. Në shumë raste edhe shuma, edhe afati i flukseve të mjeteve monetare janë të pasigurta. Madje edhe shumat fikse të

kontraktuara, siç janë pagesat për një kredi, janë të pasigurta nëse ekziston rreziku i mospagimit.

- B16** Pjesëmarrësit e tregut në përgjithësi të kërkojnë kompensim (p.sh. një prim rreziku) për përballimin e pasigurisë së vetvetishme në flukset monetare të një aktivi ose një pasivi. Një matje e vlerës së drejtë duhet të përfshijë një prim rreziku, që pasqyron shumën që pjesëmarrësit e tregut do të kërkonin si kompensim për pasigurinë e vetvetishme në flukset e mjeteve monetare. Përndryshe, matja nuk do të përfaqësonte me besnikëri vlerën e drejtë. Në disa raste, përcaktimi i primit të përshtatshëm të rrezikut mund të jetë e vështirë. Megjithatë, vetëm shkalla e vështirësisë nuk është një arsye e mjaftueshme për të përjashtuar një prim rreziku.
- B17** Teknikat e vlerës aktuale ndryshojnë në mënyrën se si ato rregullojnë në lidhje me rrezikun dhe në llojin e flukseve monetare që ato përdorin. Për shembull:
- (a) Teknika e rregullimit të normës së skontimit (shih paragrafët B18-B22) përdor një normë skontimi të rregulluar në lidhje me rrezikun dhe flukset monetare kontraktuale, të premtuara ose me shumë gjasa në para.
  - (b) Metoda 1 e teknikës së vlerës aktuale të pritshme (shih paragrafin B25) përdor flukset monetare të pritshme të rregulluara në lidhje me rrezikun dhe një normë pa rrezik.
  - (c) Metoda 2 e teknikës së vlerës aktuale të pritshme (shih paragrafin B26) përdor flukset monetare të pritshme që nuk janë të rregulluara në lidhje me rrezikun dhe një normë skontimi të rregulluar për të përfshirë primin e rrezikut, që pjesëmarrësit e tregut kërkojnë. Kjo normë është e ndryshme nga norma e përdorur në teknikën e rregullimit të normës së skontimit.

#### *Teknika e rregullimit të normës së skontimit*

- B18** Teknika e rregullimit të normës së skontimit përdor një tërësi të vetme të flukseve të mjeteve monetare nga intervali i shumave të mundshme të vlerësuara, qoftë flukset kontraktuale apo të premtuara (siç është rasti për një obligacion) ose më shumë gjasa në para. Në të gjitha rastet, këto flukse monetare janë të kushtëzuara nga ndodhja e ngjarjeve të specifikuara (p.sh. flukset monetare kontraktuale ose të premtuara për një obligacion janë të kushtëzuara në rast të ndonjë vonese nga debitori). Norma e skontimit, e përdorur në teknikën e rregullimit të normës së skontimit, rrjedh nga normat e vrojtuar të kthimit për aktivet ose pasivet e krahasueshme që tregtohen në treg. Prandaj, flukset kontraktuale, të premtuara ose më shumë gjasa në para skontoohen me një normë tregu të vrojtuar apo të vlerësuar për të tilla flukse monetare të kushtëzuara (p.sh. një normë tregu e kthimit).
- B19** Teknika e rregullimit të normës së skontimit kërkon një analizë të dhënave të tregut për aktivet ose pasivet e krahasueshme. Krahasueshmëria realizohet duke marrë parasysh natyrën e flukseve monetare (p.sh. nëse

flukset e mjeteve monetare janë kontraktuale apo jo-kontraktuale dhe kanë mundësi për t'iu përgjigjur në mënyrë të ngjashme ndryshimeve në kushtet ekonomike), si dhe faktorë të tjerë (p.sh. rëndësia e kredisë, kolaterali, kohëzgjatja, marrëveshjet kufizuese dhe likuiditeti). Në të kundërt, në qoftë se një aktiv ose detyrim i vetëm, i krahasueshëm, nuk pasqyron në mënyrë të drejtë rrezikun e vetvetishëm në flukset monetare të aktivit ose pasivit që matet, mund të jetë e mundur që të nxirret një normë skontimi duke përdorur të dhëna për disa aktive ose pasive të krahasueshme në lidhje me kurbën e rendimentit pa rrezikun (dmth duke përdorur një metodë “akumuluese”).

**B20** Për të ilustruar një metodë akumuluese, supozojmë se aktivi A është një e drejtë kontraktuale për të marrë 800 NJM<sup>\*</sup> në një vit (dmth. nuk ka pasiguri në lidhje me afatin). Ka një treg të krijuar për aktivet e krahasueshme, dhe janë të disponueshme informacione rreth këtyre aktiveve, duke përfshirë informacionin e çmimeve. Nga këto aktive të krahasueshme:

- (a) Aktivi B është një e drejtë kontraktuale për të marrë 1, 200 NJM në një vit dhe ka një çmim tregu 1,083 NJM. Kështu, norma vjetore e nënkuptuar e kthimit (p.sh. një normë tregu një-vjeçare e kthimit) është 10.8 për qind  $[(1,200 \text{ NJM} / 1,083 \text{ NJM}) - 1]$ .
- (b) Aktivi C është një e drejtë kontraktuale për të marrë 700 NJM në një vit dhe ka një çmim tregu 566 NJM. Kështu, norma vjetore e nënkuptuar e kthimit (p.sh. një normë tregu një-vjeçare e kthimit) është 11.2 për qind  $[(700 \text{ NJM} / 566 \text{ NJM})^{0.5} - 1]$ .
- (c) Të tre aktivet janë të krahasueshme në lidhje me rrezikun (p.sh. shpërndarja e mundshme e shlyerjeve dhe kredisë).

**B21** Në bazë të afatit të pagesave kontraktuale që bëhen për aktivin A në lidhje me afatin për aktivin B dhe aktivin C ( dmth një vit për aktivin B kundrejt dy vjet për aktivin C), aktivi B mendohet të jetë më shumë i krahasueshëm me aktivin A. Duke përdorur pagesën kontraktuale që bëhet për të marrë aktivin A (800 NJM) dhe një normë tregu që trashëgohet nga aktivi B (10.8 për qind), vlera e drejtë e aktivit A është 722 NJM (800 NJM /1.108). Në të kundërt, në mungesë të informacionit të disponueshëm të tregut për aktivin B, norma e tregut për një vit mund të nxirret nga aktivi C duke përdorur metodën akumuluese. Në këtë rast, norma dy-vjeçare e tregut për aktivin C (11.2 për qind) do të rregullohet në një normë tregu për një vit duke përdorur strukturën e afatit të kurbës pa rrezik të rendimentit. Mund të jetë e nevojshme për informacione dhe analizë shtesë për të përcaktuar nëse primet e rrezikut për aktivet janë të njëjta për një vit dhe dy vjet. Nëse është përcaktuar se primet e rrezikut për aktivet për një vit dhe dy vjet nuk janë të njëjta, norma e tregut dy-vjeçare e kthimit do të rregullohet më pas për këtë efekt.

---

\* Në këtë SNRF shumat monetare janë të shprehura në “njësi monetare (NJM)”

**B22** Kur teknika e rregullimit të normës së skontimit zbatohet për arkëtimet ose pagesat fikse, rregullimi për rrezikun e vetvetishëm në flukset monetare të aktivit ose pasivit që matet përfshihet në normën e skontimit. Në disa aplikime të teknikës së rregullimit të normës së skontimit të flukseve të mjeteve monetare, që nuk janë arkëtime ose pagesa fikse, mund të jetë e nevojshme të bëhet një rregullim në flukset e mjeteve monetare për të arritur krahasueshmërinë me aktivin ose pasivin e mbikëqyruar nga i cili përftohet norma e skontimit.

### *Teknika e vlerës aktuale të pritshme*

**B23** Teknika e vlerës aktuale të pritshme përdor si pikënisje një grup flukseve të mjeteve monetare, që përfaqëson mesataren e ponderuar me probabilitetin e të gjitha flukseve monetare të ardhshme të mundshme (dmth flukset monetare të pritshme). Vlerësimi që përftohet është identik me vlerën e pritshme, e cila, në terma statistikorë, është mesatarja e ponderuar e vlerave të mundshme të një variabli diskret të rastit me probabilitetet përkatëse në përqindje. Meqë të gjitha flukset monetare të mundshme janë të ponderuara me probabilitetin, fluksi monetar i pritshëm që përftohet nuk është i kushtëzuar me ndodhjen e ndonjë ngjarje të specifikuar (ndryshe nga flukset monetare të përdorura në teknikën e rregullimit të normës së skontimit).

**B24** Në marrjen e një vendimi për investim, pjesëmarrësit e tregut që janë kundërshtues të rrezikut do të merrnin parasysh rrezikun që flukset monetare aktuale mund të ndryshojnë nga flukset monetare të pritshme. Teoria e portofolit bën dallimin midis dy llojeve të rrezikut:

- (a) rreziku josistematik (diversifikativ), që është rrezik specifik për një aktiv apo pasiv të veçantë.
- (b) rreziku sistematik (jo-diversifikativ), që është rrezik i përbashkët, i ndarë prej një aktivi ose një detyrimi me zëra të tjerë në një portofol të diversifikuar.

Sipas teorisë së portofolit, në një treg në ekuilibër, pjesëmarrësit e tregut do të kompensohen vetëm për përballimin e rrezikut sistematik të vetvetishëm në flukset monetare. (Në tregjet që janë joefikase ose jo në ekuilibër, mund të disponohen forma të tjera kthimi apo kompensimi.)

**B25** Metoda 1 e teknikës së vlerës aktuale të pritshme rregullon flukset monetare të pritshme të aktivit për rrezikun sistematik (dmth të tregut) duke zbritur një prim rreziku në para (dmth flukse monetare të pritshme të rregulluara në lidhje me rrezikun). Këto flukse monetare të pritshme, të rregulluara në lidhje me rrezikun, përfaqësojnë një fluks monetar me siguri ekuivalente, e cila është skontuar me një normë interesi pa-rrezik. Një fluks monetar me siguri ekuivalente i referohet një fluksi monetar të pritshëm (siç është përkufizuar), i rregulluar për rrezikun në mënyrë që një pjesëmarrës tregu është indiferent në tregtimin e një fluksi monetar të caktuar për një fluks monetar të pritshëm. Për shembull, nëse një pjesëmarrës tregu ishte i gatshëm për të tregtuar një

fluks monetar të pritshëm prej 1, 200 NJM për një fluks monetar të caktuar prej 1, 000 NJM, 1, 000 NJM është ekuivalente me sigurinë e 1, 200NJM (dmth 200 NJM do të përfaqësojë primin e rrezikut në para). Në këtë rast pjesëmarrësi i tregut do të ishte indiferent për sa i përket aktivit që zotëron.

- B26 Në të kundërt, Metoda 2 e teknikave të vlerës aktuale të pritshme rregullon për rrezikun sistematik (dmth të tregut) duke zbatuar një prim rreziku me normë interesi pa-rrezik. Prandaj, flukset monetare të pritshme skontohehen me një normë që korrespondon me një normë të pritshme që lidhet me flukset monetare të ponderuara me probabilitetin (dmth një normë e pritjes së pritshme). Modelet e përdorura për çmimet e aktiveveqë mbartin rrezik, të tilla si modeli i vendosjes së çmimit të aktiveve kapitale, mund të përdoren për të vlerësuar normën e pritjes së pritshme. Meqë norma e skontimit e përdorur në teknikën e rregullimit të normës së skontimit është norma e kthimit në lidhje me flukset monetare të kushtëzuara, ka të ngjarë të jetë më e lartë se norma e skontimit e përdorur në Metodën 2 të teknikës së vlerës aktuale të pritshme, e cila është një normë e pritjes së pritshme në lidhje me flukset monetare të pritshme ose të ponderuara me probabilitetin.
- B27 Për të ilustruar Metodën 1 dhe 2, supozojmë se një aktiv ka flukse monetare të pritshme prej 780NJM në një vit, të përcaktuara në bazë të flukseve të mjeteve monetare të mundshme dhe probabiliteteve të treguara më poshtë. Norma e interesit pa rrezik e zbatueshme për flukset e mjeteve monetare me një periudhë një-vjeçare është 5 për qind, dhe primi i rrezikut sistematik për një aktiv me profil të njëjtë rreziku është 3 për qind.

<b>Flukset monetare të mundshme</b>	<b>Probabiliteti</b>	<b>Flukset monetare të ponderuara me probabilitetin</b>
500 NJM	15%	75 NJM
800 NJM	60%	480 NJM
900 NJM	25%	225 NJM
Flukse monetare të pritshme		780 NJM

- B28 Në këtë ilustrim të thjeshtë, flukset monetare të pritshme(780NJM) përfaqësojnë mesataren e ponderuar me probabilitetin e tre rezultateve të mundshme. Në situata më realiste, mund të ketë shumë rezultate të mundshme. Megjithatë, për të zbatuar teknikën e vlerës aktuale të pritshme, nuk është gjithmonë e nevojshme të merren në konsideratë të gjitha shpërndarjet e mundshme të flukseve monetare duke përdorur modelet dhe teknikat komplekse. Përkundrazi, mund të jetë e mundur të zhvillohet një numër i kufizuar skenarësh diskretë dhe probabilitetesh që përmbledhin matricën e flukseve monetare të mundshme. Për shembull, një njësi ekonomike mund të përdorë flukset monetare, të realizuara për disa periudha përkatëse të kaluara, të rregulluara për ndryshimet në rrethanat që ndodhin

më pas (p.sh. ndryshimet në faktorët e jashtëm, duke përfshirë edhe kushtet ekonomike, ose të tregut, prirjet e industrisë dhe konkurrencën, si dhe ndryshimet në faktorët e brendshëm që ndikojnë në njësinë ekonomike në mënyrë më specifike), duke marrë parasysh supozimet e pjesëmarrësve të tregut.

- B29 Në teori, vlera aktuale (dmth. vlera e drejtë) e flukseve të mjeteve monetare të aktivitetit është e njëjtë nëse përcaktohet duke përdorur Metodën 1 ose Metodën 2, si më poshtë:
- (a) Duke përdorur Metodën 1, flukset monetare të pritshme përshtaten për rrezikun sistematik (dmth të tregut). Në mungesë të të dhënave të drejtpërdrejta të tregut që tregojnë shumën e rregullimit të rrezikut, ky rregullim mund të përftohet nga një model i vendosjes së çmimit për aktivitet, duke përdorur konceptin e sigurisë ekuivalente. Për shembull, rregullimi i rrezikut (dmth prim i rrezikut në para për 22NJM) mund të përcaktohet duke përdorur primin e rrezikut sistematik prej 3 për qind ( $780NJM - [780NJM \times (1.05/1.08)]$ ), që rezulton në flukse monetare të pritshme të rregulluara me rrezikun e 758NJM ( $780NJM - 22NJM$ ). 758NJM është ekuivalente me sigurinë e 780NJM dhe është skontuar me normën e interesit pa rrezik (5 për qind). Vlera aktuale (dmth. vlera e drejtë) e aktivitetit është 722NJM ( $758NJM/1.05$ ).
- (b) Duke përdorur Metodën 2, flukset monetare të pritshme nuk rregullohen për rrezikun sistematik (dmth të tregut). Përkundrazi, rregullimi për këtë rrezik është i përfshirë në normën e skontimit. Kështu, flukset monetare të pritshme skontohen me një normë kthimi të pritshme për 8 për qind (dmth me normë interesi pa rrezik për 5 për qind plus primin e rrezikut sistematik për 3 për qind). Vlera aktuale (dmth. vlera e drejtë) e aktivitetit është 722NJM ( $780NJM/1.08$ ).
- B30 Kur përdoret një teknikë e vlerës aktuale të pritshme për të matur vlerën e drejtë, mund të përdoret ose Metoda 1, ose Metoda 2. Zgjedhja e Metodës 1 ose Metodës 2 do të varet nga faktet dhe rrethanat konkrete të aktivitetit ose të pasivitetit që matet, shkalla në të cilën të dhënat e mjaftueshme janë të disponueshme dhe janë përdorur gjykimet.

## **Zbatimi i teknikave të vlerës aktuale për pasivitet dhe instrumentet e kapitalit neto të një njësie ekonomike, që nuk zotërohen nga palët e tjera si aktive (paragrafët 40 dhe 41)**

- B31 Kur përdoret një teknikë e vlerës aktuale për të matur vlerën e drejtë të një pasivi, që nuk mbahet nga një palë tjetër si një aktiv (p.sh. një pasiv që rrjedh nga nxjerrja jashtë përdorimit), një njësi ekonomike, ndër të tjera, do të vlerësojë flukset monetare dalëse të ardhshme që pjesëmarrësit e tregut do të prisnin për të realizuar plotësimin e detyrimit. Këto flukse monetare dalëse



të ardhshme do të përfshijnë pritshmëritë e pjesëmarrësve të tregut në lidhje me kostot e realizimit të detyrimit dhe kompensimin që një pjesëmarrës tregu do të kërkonte për të marrë përsipër detyrimin. Ky kompensim përfshin kthimin që një pjesëmarrës tregu do të kërkonte për:

- (a) ndërmarrjen e aktivitetit (dmth. vlera e realizimit të detyrimit; p.sh. duke përdorur burimet që mund të përdoren për aktivitete të tjera); dhe
- (b) marrjen përsipër të rrezikut që lidhet me detyrimin (p.sh. një prim rreziku që pasqyron rrezikun që flukset monetare dalëse aktuale mund të ndryshojnë nga flukset monetare dalëse të pritshme; shih paragrafin B33).

**B32** Për shembull, një pasiv jo-financiar nuk përmban një normë kthimi kontraktuale dhe nuk ka asnjë rendiment tregu të mbikëqyrrur për këtë pasiv. Në disa raste përbërësit e kthimit, që pjesëmarrësit e tregut do të kërkonin, do të ishin të pandashëm nga njëri-tjetri (p.sh. kur përdoret çmimi i një palë të tretë kontraktore, do të ngarkohej mbi një bazë tarife fikse). Në raste të tjera, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë këta përbërës në mënyrë të veçantë (p.sh. kur përdoret çmimi i një një pale të tretë kontraktore, do të ngarkohej mbi një bazë kosto plus, sepse kontraktuesi në këtë rast nuk do të mbajë rrezikun e ndryshimeve të ardhshme në kostot).

**B33** Një njësi ekonomike mund të përfshijë një prim rreziku në matjen me vlerën e drejtë të një pasivi ose të një instrumenti të kapitalit neto të njësisë ekonomike, që nuk zotërohet nga një palë tjetër si një aktiv, në një nga mënyrat e mëposhtme:

- (a) duke rregulluar flukset monetare (dmth. si një rritje në madhësinë e flukseve monetare dalëse); ose
- (b) duke rregulluar normën e përdorur për skontimin e flukseve monetare të ardhshme në vlerat e tyre aktuale (dmth. si një ulje në normën e skontimit).

Një njësi ekonomike do të sigurojë që një gjë e tillë nuk lejon të bëhen rregullime të dyfishta apo të ketë mungesë rregullimesh për rrezikun. Për shembull, nëse flukset monetare të vlerësuara janë rritur për të përfshirë kompensimin e marrjes përsipër të rrezikut të lidhur me detyrimin, norma e skontimit nuk do të rregullohej për të pasqyruar këtë rrezik.

## **Inputet për teknikat e vlerësimit (paragrafët 67–71)**

**B34** Shembuj të tregjeve në të cilat inputet mund të jenë të verifikueshme për disa aktive dhe pasive (p.sh. instrumente financiare) përfshijnë sa më poshtë:

- (a) *Tregjet e këmbimit.* Në një treg këmbimi, çmimet e mbylljes janë njëkohësisht të disponueshme dhe në përgjithësi përfaqësuese të vlerës së drejtë. Një shembull i një tregu të tillë është Bursa në Londër.

- (b) *Tregjet e drejtpërdrejta.* Në një treg të drejtpërdrejtë, tregtarët janë të gatshëm për të tregtuar (qoftë për të blerë ose shitur për llogari të tyre), duke siguruar likuiditet nëpërmjet përdorimit të kapitalit të tyre për të zotëruar një inventar zërash për të cilat ata bëjnë tregti. Në mënyrë tipike çmimet e ofertës dhe të kërkesës (që përfaqësojnë përkatësisht, çmimin me të cilin tregtari është i gatshëm për të blerë dhe çmimin me të cilin tregtari është i gatshëm për të shitur), janë më të disponueshëm se çmimet e mbylljes së tregut. Në tregjet jashtë bursave (për të cilat çmimet raportohen publikisht) janë tregje të drejtpërdrejta. Tregjet e drejtpërdrejta ekzistojnë, gjithashtu, për disa aktive dhe pasive të tjera, duke përfshirë disa instrumente financiare, mallra dhe aktive fizike (p.sh. pajisje e përdorur).
- (c) *Tregjet me ndërmjetësim.* Në një treg të ndërmjetësuar, agjentët përpiqen të lidhin blerësit me shitësit, por nuk janë të gatshëm për të tregtuar për llogari të tyre. Me fjalë të tjera, agjentët nuk e përdorin kapitalin e tyre për të zotëruar një inventar elementesh për të cilat ata bëjnë tregti. Agjenti i shitjes di çmimet e ofruara dhe të kërkuara nga palët përkatëse, por secila palë zakonisht nuk është në dijeni të kërkesave të palës tjetër për çmimin. Ndonjëherë janë në dispozicion çmimet e transaksioneve të kryera. Tregjet e ndërmjetësuar përfshijnë rrjetet elektronike të komunikimit, në të cilat bëhet përputhja e urdhrave të blerjes dhe të shitjes, dhe tregjet komerciale dhe të banesave.
- (d) *Tregjet kryesore për letrat me vlerë.* Në një treg kryesor, transaksionet si të fillimit dhe të rishitjes negociohen në mënyrë të pavarur, pa ndërmjetës. Në lidhje me këto transaksione mund të disponohet pak informacion për publikun.

## Hierarkia e vlerës së drejtë (paragrafët 72–90)

---

### Inputet e Nivelit 2 (paragrafët 81–85)

- B35 Shembuj të inpleteve të Nivelit 2 për aktivet dhe pasivet e veçanta përfshijnë sa më poshtë:
- (a) *Kontrata shkëmbimi me norma interesi variabël për t'u paguar dhe me norma interesi fikse për t'u arkëtuar, bazuar në normën e ofruar ndërbankare të Londrës (LIBOR) të normës mesatare.* Një input i Nivelit 2 do të ishte norma LIBOR e kontratës së shkëmbimit, në qoftë se norma mbikëqyret në intervale zakonisht të kuotuar për pothuajse afatin e plotë të kontratës.
- (b) *Kontrata shkëmbimi me norma interesi variabël për t'u paguar dhe me norma interesi fikse për t'u arkëtuar, bazuar në një kurbë të rendimentit të shprehur në një monedhë të huaj.* Një input i Nivelit 2 do të ishte norma e kontratës së shkëmbimit, bazuar në një kurbë të rendimentit,

shprehur në një monedhë të huaj, që mbikëqyret në intervale zakonisht të kuotuarra, për pothuajse afatin e plotë të kontratës. Ky do të ishte rasti kur afati i kontratës është 10 vjet dhe kjo normë mbikëqyret në intervale të kuotuarra zakonisht për 9 vjet, me kusht që çdo ekstrapolim i arsyeshëm i kurbës së rendimentit për vitin 10 nuk do të ishte i rëndësishëm për matjen me vlerën e drejtë të kontratës në tërësinë e saj.

- (c) *Kontrata shkëmbimi me norma interesi variabël për t'u paguar dhe me norma interesi fikse për t'u arkëtuar*, bazuar në normën kryesore të një banke të veçantë. Një input i Nivelit 2 do të ishte norma kryesore e bankës, që është si rezultat i ekstrapolimit kur vlerat e ekstrapoluara janë vërtetuar nga të dhënat e verifikueshme të tregut, për shembull, nëpërmjet korrelacionit me një normë interesi që mbikëqyret për pothuajse afatin e plotë të kontratës.
- (d) *Opsione tre-vjeçare për aksionet e tregtueshme në bursë*. Një input i Nivelit 2 do të ishte luhatshmëria e nënkuptuar për aksionet që përftohet përmes ekstrapolimit të vitit 3, nëse ekzistojnë të dy kushtet e mëposhtme:
- (i) Çmimet për opsionet një-vjeçare dhe dy-vjeçare të aksioneve që janë të verifikueshme.
- (ii) Luhatshmëria e nënkuptuar, e ekstrapoluar e një opsioni tre-vjeçar, është vërtetuar nga të dhënat e verifikueshme të tregut për pothuajse afatin e plotë të opsionit.

Në këtë rast, luhatshmëria e nënkuptuar mund të ishte rezultat i ekstrapolimit të luhatshmërisë së nënkuptuar të opsioneve njëvjeçare dhe dyvjeçare për aksionet, e vërtetuar nëpërmjet luhatshmërisë së nënkuptuar për opsionet trevjeçare në aksione të njëjësive ekonomike të krahasueshme, me kusht që të jetë përcaktuar korrelacioni me luhatshmëritë e nënkuptuara njëvjeçare dhe dyvjeçare.

- (e) *Marrëveshja e licencimit*. Për një marrëveshje licencimi që është përfituar në një kombinim biznesi dhe është negociuar kohët e fundit me një palë të palidhur me njësinë ekonomike të blerë (pala në marrëveshjen e licencimit), një input i Nivelit 2 do të ishte tarifa e pagesës për përdorimin e pronës në kontratën me palën e palidhur, në fillimin e marrëveshjes.
- (f) *Inventari i produkteve të gatshme në një pikë të shitjes me pakicë*. Për inventarin e produkteve të gatshme që është blerë në një kombinim biznesi, input i Nivelit 2 do të ishte ose një çmim për klientët në një treg me pakicë, ose një çmim për shitësit me pakicë në tregun me shumicë, i rregulluar për diferencat midis gjendjes dhe vendndodhjes së elementit të inventarit dhe zërave të krahasueshëm (pra të ngjashëm) të inventarit, në mënyrë që matja me vlerën e drejtë të pasqyrojë çmimin, që do të pranohej në një transaksion për t'ia shitur inventarin një shitësi

tjetër me pakicë, që do të plotësonte përpjekjet e nevojshme për shitjen. Në përgjithësi, matja me vlerën e drejtë do të ishte e njëjtë, nëse rregullimet janë bërë për një çmim të shitjes me pakicë (poshtë), ose për një çmim të shitjes me shumicë (lart). Në përgjithësi, çmimi që kërkon madhësinë më të vogël të rregullimeve subjektive do të përdorej për matjen me vlerën e drejtë.

- (g) *Ndërtesat e zotëruara dhe të përdorura.* Një input i Nivelit 2 do të ishte çmimi për metër katror për ndërtesën (një shumëfish vlerësimi) që rrjedh nga të dhënat e verifikueshme të tregut, p.sh. shumëfishat që rrjedhin nga çmimet në transaksionet e verifikueshme që përfshijnë ndërtesat e krahasueshme (dmth të ngjashme) në vendndodhje të ngjashme.
- (h) *Njësia gjeneruese e mjeteve monetare.* Një input i Nivelit 2 do të ishte një shumëfish vlerësimi (p.sh. një shumëfish i fitimeve ose i të ardhurave apo një masë e ngjashme e performancës) që rrjedh nga të dhënat e verifikueshme të tregut, p.sh. shumëfishat që rrjedhin nga çmimet në transaksionet e verifikueshme që përfshijnë biznese të krahasueshme (dmth. të ngjashme), duke marrë parasysh faktorët operacionalë, të tregut, financiarë dhe jo-financiarë.

### **Inpute të Nivelit 3 (paragrafët 86–90)**

**B36** Shembuj të inputeve të Nivelit 3 për aktivet dhe pasivet e veçanta përfshijnë sa më poshtë:

- (a) *Kontrata këmbimi afatgjata të valutës.* Një input i Nivelit 3 do të ishte një normë interesi në një monedhë të specifikuar, që nuk është e mbikëqyruar dhe nuk mund të vërtetohet nga të dhënat e verifikueshme të tregut në intervale zakonisht të kuotuar ose ndryshe për pothuajse afatin e plotë të kontratës së shkëmbimit të valutës. Normat e interesit në një kontratë shkëmbimi të monedhës janë normat e kontratës, të llogaritura sipas kurbave të rendimentit të vendeve përkatëse.
- (b) *Opsione tre-vjeçare për aksionet e tregtueshme në bursë.* Një input i Nivelit 3 do të ishte luhatshmëria historike, pra luhatshmëria për aksionet, që rrjedh nga çmimet historike të tyre. Luhatshmëria historike zakonisht nuk paraqet pritshmëritë e pjesëmarrësve të tregut aktual rreth luhatshmërisë në të ardhmen, edhe nëse është informacioni i vetëm në dispozicion për vlerësimin e një opsioni.
- (c) *Kontrata e shkëmbimit për normën e interesit.* Një input i Nivelit 3 do të ishte një rregullim në një çmim tregu mesatar, sipas një marrëveshje të përgjithshme (jo të detyrueshme) për kontratën, e zhvilluar duke përdorur të dhëna që nuk janë drejtpërdrejt të verifikueshme dhe nuk mund të vërtetohen ndryshe nga të dhënat e verifikueshme të tregut.

- (d) *Pasivet që rrjedhin nga nxjerrja jashtë përdorimit, të marra përsipër në një kombinim biznesi.* Një input i Nivelit 3 do të ishte një vlerësim aktual duke përdorur të dhënat e veta të njësisë ekonomike në lidhje me flukset monetare të ardhshme për t'u paguar për të përmbushur detyrimin (duke përfshirë pritshmëritë e pjesëmarrësve të tregut në lidhje me kostot e përmbushjes së detyrimit dhe kompensimit që një pjesëmarrës tregu do të kërkonte për të marrë përsipër detyrimin për të çmontuar aktivin) në qoftë se nuk ka informacion të arsyeshëm në dispozicion, që tregon se pjesëmarrësit e tregut do të përdornin supozime të ndryshme. Ky input i Nivelit 3 do të përdorej në një teknikë të vlerës aktuale së bashku me inpute të tjera, p.sh. një normë interesi aktuale pa rrezik ose një normë kredie pa rrezik, e rregulluar, nëse efekti i besueshmërisë së kredisë i njësisë ekonomike në vlerën e drejtë të pasivit është pasqyruar në normën e skontimit, se sa në vlerësimin e flukseve dalëse të mjeteve monetare të ardhshme.
- (e) *Njësia gjeneruese e mjeteve monetare.* Një input i Nivelit 3 do të ishte një parashikim financiar (p.sh. e flukseve të mjeteve monetare apo fitimi ose humbja) që zhvillohet duke përdorur të dhënat e veta të njësisë ekonomike, nëse nuk ka informacion të arsyeshëm në dispozicion, që tregon se pjesëmarrësit e tregut do të përdornin supozime të ndryshme.

## **Matja e vlerës së drejtë kur vëllimi apo niveli i aktivitetit për një aktiv ose një pasiv ka rënë dukshëm**

B37 Vlera e drejtë e një aktivi ose një pasivi mund të preket kur ka patur një rënie të ndjeshme në vëllimin ose në nivelin e aktivitetit për këtë aktiv ose detyrim në lidhje me aktivitetin normal të tregut për aktivin ose pasivin (apo aktivet ose pasivet e ngjashme). Për të përcaktuar nëse, në bazë të evidencës së marrë, ka pasur një rënie të ndjeshme në vëllimin ose në nivelin e aktivitetit për aktivin ose pasivin, njësia ekonomike do të vlerësojë rëndësinë dhe përkatësinë e faktorëve të tillë si më poshtë:

- (a) Ka pak transaksione kohëve të fundit.
- (b) Kuotimet e çmimeve nuk janë bërë duke përdorur informacione aktuale.
- (c) Kuotimet e çmimeve ndryshojnë në thelb ose me kalimin e kohës ose ndërmjet agjentëve të tregut (p.sh. disa tregje të ndërmjetësuar).
- (d) Treguesit, që më parë kishin korrelacion të lartë me vlerat e drejta të aktivit ose pasivit, në mënyrë të dukshme nuk kanë korrelacion me treguesit e fundit të vlerës së drejtë për këtë aktiv ose pasiv.
- (e) Ka një rritje të konsiderueshme në primet e nënkuptuara për rrezikun e likuiditetit, rendimentet apo treguesit e performancës (të tilla si normat e borxheve të prapambetura apo për shkallën e lartë të humbjes) për transaksionet e verifikueshme ose çmimet e kuotuar në krahasim me

vlërësimin e flukseve të pritshme të mjeteve monetare, duke marrë parasysh të gjitha të dhënat e disponueshme të tregut dhe rrezikun tjetër të mosrealizimit të performancës të aktivit ose të pasivit.

- (f) Ka një marzh të gjerë midis çmimit të kërkuar dhe të ofruar ose një rritje të ndjeshme të këtij marzhi.
- (g) Ka një rënie të konsiderueshme në aktivitetin ose ka një mungesë në treg të emetimeve të reja (dmth një treg kryesor) për aktivin ose pasivin ose aktivet apo pasivet e ngjashme.
- (h) Ka pak informacion në dispozicion të publikut (p.sh. për transaksione që ndodhin në një treg kryesor për letrat me vlerë kryesore).

**B38** Nëse një njësi ekonomike arrin në përfundimin se ka patur një rënie të konsiderueshme në vëllimin ose nivelin e veprimtarisë së aktivit ose pasivit, në lidhje me aktivitetin normal të tregut për aktivin ose pasivin (ose aktivet apo pasivet e ngjashme), është e nevojshme të bëhet analiza e mëtejshme e transaksioneve ose çmimeve të kuotuar. Një rënie në vëllimin ose në nivelin e aktivitetit në vetvete nuk mund të tregojë se një çmim transaksioni ose çmimi i kuotuar nuk paraqet vlerën e drejtë ose që një transaksion në këtë treg nuk është i rregullt. Megjithatë, nëse një njësi ekonomike përcakton se një transaksion ose çmim i kuotuar nuk paraqet vlerën e drejtë (p.sh. mund të ketë transaksione që nuk janë të rregullt), do të jetë i nevojshëm një rregullim në transaksionet ose çmimet e kuotuar, nëse njësia ekonomike i përdor këto çmime si një bazë për matjen e vlerës së drejtë dhe se rregullimi mund të jetë i rëndësishëm për matjen me vlerën e drejtë në tërësinë e saj. Gjithashtu, rregullimet mund të jenë e nevojshme në rrethana të tjera (p.sh. kur një çmim për një aktiv të ngjashëm kërkon rregullim të rëndësishëm për ta bërë atë të krahasueshëm me aktivin e matur ose kur çmimi është i vjetëruar).

**B39** Ky SNRF nuk përshkruan një metodologji për të bërë rregullime të konsiderueshme për transaksionet ose çmimet e kuotuar. Shih paragrafët 61-66 dhe B5 të B11 në lidhje me një analizë të përdorimit të teknikave të vlerësimit gjatë matjes me vlerën e drejtë. Pavarësisht nga teknika e vlerësimit e përdorur, një njësi ekonomike duhet të përfshijë rregullimet e duhura të rrezikut, duke përfshirë një prim rreziku që pasqyron shumën që pjesëmarrësit e tregut do të kërkonin si kompensim për pasigurinë e vetvetishme në flukset e mjeteve monetare të një aktivi ose një pasivi (shih paragrafin B17). Në të kundërt, matja nuk përfaqëson me besnikëri vlerën e drejtë. Në disa raste mund të jetë e vështirë të përcaktohet rregullimi i duhur i rrezikut. Megjithatë, vetëm shkalla e vështirësisë nuk është një bazë e mjaftueshme që të përjashtojë një rregullim të rrezikut. Rregullimi i rrezikut do të jetë pasqyrim i një transaksioni të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut.

**B40** Nëse ka pasur një rënie të ndjeshme në vëllimin ose në nivelin e aktivitetit të aktivit ose pasivit, mund të jetë i përshtatshëm një ndryshim në teknikën e vlerësimit ose përdorimi i teknikave të vlerësimit të shumëfishtë (p.sh. përdorimi i një metode të tregut dhe i një teknike të vlerës aktuale). Gjatë

ponderimit të treguesve të vlerës së drejtë, që rezultojnë nga përdorimi i teknikave të vlerësimit të shumëfishtë, një njësi ekonomike duhet të ketë parasysh arsyeshmërinë e intervalit të matjeve të vlerës së drejtë. Objektivi është të përcaktohet pika brenda intervalit që është më përfaqësuesja e vlerës së drejtë në kushtet aktuale të tregut. Një interval i gjerë i matjeve të vlerës së drejtë mund të jetë një tregues se është e nevojshme analiza e mëtejshme.

- B41 Edhe kur ka një rënie në vëllimin ose në nivelin e aktivitetit të aktivit ose pasivit, objektivi i matjes me vlerën e drejtë mbetet i njëjtë. Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm (p.sh. nuk është një likuidim i detyruar ose shitje e sforcuar) midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut.
- B42 Vlerësimi i çmimit me të cilin pjesëmarrësit e tregut do të ishin të gatshëm për të hyrë në një transaksion në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut, nëse ka pasur një rënie në vëllimin ose në nivelin e aktivitetit të aktivit ose pasivit, varet nga faktet dhe rrethanat në datën e matjes dhe kërkon gjykim. Synimi i një njësie ekonomike për të mbajtur aktivin ose për të shlyer ose ndryshe për të plotësuar detyrimin nuk është i rëndësishëm kur matet vlera e drejtë, sepse vlera e drejtë është një matje e bazuar në treg, dhe jo një matje specifike e njësisë ekonomike.

### **Identifikimi i transaksioneve që nuk janë të rregullt**

- B43 Përcaktimi nëse një transaksion është i zakonshëm (ose nuk është i zakonshëm) është më i vështirë të bëhet nëse ka pasur një rënie në vëllimin ose në nivelin e aktivitetit të aktivit ose pasivit në lidhje me aktivitetin normal të tregut për aktivin ose pasivin (apo aktivet ose pasivet e ngjashme). Në këto rrethana, nuk është e përshtatshme të arrihet në përfundimin se të gjitha transaksionet në këtë treg nuk janë të zakonshëm (dmth likuidimet e detyruara ose shitjet e sforcuara). Rrethanat që mund të tregojnë se një transaksion nuk është i zakonshëm përfshijnë në vijim:
- (a) Nuk ka ekspozim të përshtatshëm ndaj tregut për një periudhë përpara datës së matjes për të lejuar aktivitetet e marketingut që janë të zakonshme për transaksionet që përfshijnë aktive ose pasive të tilla në kushtet aktuale të tregut.
  - (b) Ka patur një periudhë të zakonshme marketingu, por shitësi ia ka shitur aktivin ose pasivin vetëm një pjesëmarrësi tregu.
  - (c) Shitësi është në ose pranë falimentimit ose likuidimit (dmth shitësi është i sforcuar).
  - (d) Shitësi e ka të nevojshme të shesë për të përmbushur kërkesat rregullatore ose ligjore (dmth. shitësi është i detyruar).

- (e) Çmimi i transaksionit përbën një përjashtim kur krahasohet me transaksionet e tjera të kohëve të fundit për një aktiv ose pasiv të njëjtë apo të ngjashëm.

Një njësi ekonomike do të vlerësojë rrethanat për të përcaktuar nëse transaksioni është i zakonshëm, mbi bazën e evidencës së disponueshme.

B44 Një njësi ekonomike merr parasysh të gjitha sa më poshtë gjatë matjes së vlerës së drejtë ose vlerësimit të primeve të rrezikut të tregut:

- (a) Nëse evidenca tregon se një transaksion nuk është i zakonshëm, një njësi ekonomike duhet t'i kushtojë pak rëndësi (krahasuar me treguesit e tjerë të vlerës së drejtë) këtij çmimi transaksioni.
- (b) Nëse evidenca tregon se një transaksion është i zakonshëm, një njësi ekonomike do ta marrë parasysh këtë çmim transaksioni. Rëndësia që i kushtohet këtij çmimi transaksioni kur krahasohet me tregues të tjerë të vlerës së drejtë varet nga faktet dhe rrethanat, të tilla si në vijim:
- (i) vëllimi i transaksionit.
- (ii) krahasueshmëria e transaksionit për aktivin ose pasivin që matet.
- (iii) afërsia e transaksionit me datën e matjes.
- (c) Nëse një njësi ekonomike nuk ka informacion të mjaftueshëm për të arritur në konkluzionin nëse një transaksion është i zakonshëm, ajo do të marrë parasysh çmimin e transaksionit. Megjithatë, ky çmim transaksioni nuk mund të përfaqësojë vlerën e drejtë (dmth. çmimi i transaksionit nuk është domosdoshmërisht baza e vetme ose kryesore për matjen e vlerës së drejtë apo vlerësimin e primeve të rrezikut të tregut). Kur një njësi ekonomike nuk ka informacion të mjaftueshëm për të arritur në konkluzionin nëse transaksione të veçanta janë të zakonshme, njësi ekonomike do t'u kushtojë pak rëndësi këtyre transaksioneve në krahasim me transaksionet e tjera të njohura si të zakonshme.

Një njësi ekonomike nuk është e nevojshme të bëjë përpjekje të lodhshme për të përcaktuar nëse një transaksion është i zakonshëm, por ajo nuk do të injorohë informacionin që është i disponueshëm në mënyrë të arsyeshme. Kur një njësi ekonomike është palë në një transaksion, ajo supozohet që të ketë informacion të mjaftueshëm për të arritur në konkluzionin nëse transaksioni është i zakonshëm.

### **Përdorimi i çmimeve të kuotuar të ofruara nga palët e treta**

B45 Ky SNRF nuk përjashton përdorimin e çmimeve të kuotuar të ofruara nga palët e treta, të tilla si çmimet për shërbimet ose agjentët, nëse njësi ekonomike ka përcaktuar se çmimet e kuotuar, të siguruar nga këto palë, janë zhvilluar në përputhje me këtë SNRF.



- B46 Nëse ka pasur një rënie të ndjeshme në vëllimin ose në nivelin e aktivitetit të aktivitet ose pasivit, njësia ekonomike do të vlerësojë nëse çmimet e kuotuar të ofruara nga palët e treta janë zhvilluar duke përdorur informacionin aktual që pasqyron transaksionet e zakonshme ose një teknikë vlerësimi që pasqyron supozimet e pjesëmarrësve të tregut (duke përfshirë edhe supozimet rreth rrezikut). Në lidhje me rëndësinë e një çmimi të kuotuar si një input për një matje me vlerën e drejtë, një njësi ekonomike i jep më pak rëndësi (kur krahasohet me tregues të tjerë të vlerës së drejtë që pasqyrojnë rezultatet e transaksioneve) kuotave që nuk pasqyrojnë rezultatin e transaksioneve.
- B47 Për më tepër, kur vlerësohet evidenca e disponueshme do të merret parasysh natyra e një kuote (p.sh. nëse kuota është një çmim tregues apo një ofertë e detyrueshme), duke i dhënë më tepër rëndësi kuotave të ofruara nga palët e treta që paraqesin oferta detyruese.

## **Shtojca C**

### **Data e hyrjes në fuqi dhe periudha tranzitore**

*Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-ve dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të SNRF-së.*

- C1 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- C2 Ky SNRF duhet të zbatohet në mënyrë prospektive që nga fillimi i periudhës vjetore në të cilën është zbatuar fillimisht.
- C3 Kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese të këtij SNRF-je nuk duhet të zbatohen në informacionin krahasues të parashikuar për periudha para zbatimit fillestar të këtij SNRF-je.

## Shtojca D

### Ndryshimet në SNRF-të e tjera

*Kjo shtojcë paraqet ndryshimet në SNRF-të e tjera që janë pasojë e nxjerrjes së SNRF 13 nga Bordi. Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimet për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike e zbaton SNRF 13 për një periudhë më të hershme, ajo do të zbatojë ndryshimet për këtë periudhë më të hershme. Paragrafët e ndryshuar janë treguar me tekst të ri të nënvizuar, ndërsa teksti i fshirë është me një vizë që i kalon mes përmes.*

### Ndryshim në përkufizim

---

D1 Në SNRF 1, 3-5 dhe 9 (publikuar në tetor 2010) përcaktimi i vlerës së drejtë është zëvendësuar me:

*Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një pasiv në një transaksion të rregullt, në mes të pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. (Shih SNRF 13.)*

Në SNK 2, 16, 18-21, 32 dhe 40 përkufizimi i vlerës së drejtë është zëvendësuar me:

*Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një pasiv në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. (Shih SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*.)*

### SNRF 1 *Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (i ndryshuar në shtator 2010)*

---

D2 Paragrafi 19 është fshirë.

D3 Paragrafi 39J është shtuar si vijon:

39J Si rezultat i SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, të nxjerrë në maj 2011, paragrafi 19 është fshirë, është ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në shtojcën A dhe janë ndryshuar paragrafët D15 dhe D20. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

D4 Paragrafët D15 dhe D20 janë ndryshuar si vijon:

D15 Në qoftë se një zbatues për herë të parë mat një investim të tillë me kosto në përputhje me SNK 27, ai do ta matë këtë investim me një nga

shumat e mëposhtme, në pasqyrën individuale të pozicionit financiar të çeljes sipas SNRF-së:

...

- (b) kostoja e supozuar. Kosto e supozuar e një investimi të tillë do të jetë:
- (i) vlera e drejtë e tij (e përcaktuar në përputhje me SNK 39) në pasqyrat financiare individuale të njësisë ekonomike në datën e kalimit të saj në SNRF; ose

...

- D20 Pavarësisht nga kërkesat e paragrafëve 7 dhe 9, një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat në fjalinë e fundit paragrafin AG76 (a) të SNK 39 ~~paragrafin AG76 dhe në paragrafi nAG76A~~, në një nga mënyrat e mëposhtme:

...

## **SNRF 2 Paguesa të bazuara në aksione**

---

D5 Paragrafi 6A është shtuar si vijon:

- 6A Ky SNRF përdor termin "vlera e drejtë" në një mënyrë që ndryshon në disa aspekte nga përkufizimi i vlerës së drejtë në SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*. Prandaj, gjatë zbatimit të SNRF 2, njësi ekonomike mat vlerën e drejtë në përputhje me këtë SNRF, dhe jo sipas SNRF 13.

## **SNRF 3 Kombinimet e biznesit**

---

D6 Paragrafët 20, 29, 33 dhe 47 janë ndryshuar si vijon:

- 20 ~~Paragrafët B41-B45 japin udhëzime për matjen me vlerën e drejtë të aktiveve të identifikueshme të veçanta dhe një interes jo-kontrollues në një njësi ekonomike të blerë. Paragrafët 24-31 specifikojnë llojet e aktiveve dhe pasiveve të identifikueshme, që përfshijnë elementë për të cilat ky SNRF parashikon përjashtime të kufizuara në parimin e matjes.~~
- 29 Blerësi do të matë vlerën e një të drejte të rifituar, të njohur si një aktiv jomaterial, në bazë të afatit kontraktual të mbetur të kontratës së lidhur, pavarësisht nëse pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh rinovime të mundshme kontraktuale ~~në përcaktimin~~ gjatë matjes së vlerës së saj të drejtë. Paragrafët B35 dhe B36 japin udhëzime përkatëse në lidhje me zbatimin.
- 33 ... Për të përcaktuar shumën e emrit të mirë në një kombinim biznesi, në të cilin nuk është transferuar asnjë shumë, blerësi duhet të përdorë vlerën e drejtë në datën e blerjes të interesit të blerësit tek i bleri të

## SNRF13 MATJA ME VLEREN E DREJTE

~~përcaktuar duke përdorur një teknikë vlerësimi në vend të vlerës së drejtë në datën e blerjes të shumës së transferuar (paragrafi 32(a)(i)).~~

...

- 47 ... Për shembull, shitja e një aktivi tek një palë e tretë, menjëherë pas datës së blerjes, për një shumë që ndryshon ndjeshëm nga vlera e drejtë e përkohshme e saj ~~e përcaktuar e matur~~ në këtë datë, ka të ngjarë të tregojë një gabim në shumën e përkohshme, vetëm nëse mund të identifikohet se ka ndërhyrë një ngjarje që ndryshoi vlerën e saj të drejtë.

D7 Paragrafi 64F është shtuar si vijon:

64F Si rezultat i SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, nxjerrë në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 20, 29, 33, 47, ka ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në shtojcën A dhe kanë ndryshuar paragrafët B22, B40, B43-B46, B49 dhe B64. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

D8 Në Shtojcën B paragrafët B22 dhe B40, B43-B46, B49 dhe B64 janë ndryshuar si më poshtë:

B22 Meqë pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin vazhdimin e pasqyrave financiare të filialit ligjor, përveç strukturës së kapitalit tij, pasqyrat financiare të konsoliduara pasqyrojnë:

...

- (d) shumën e njohur si interesa të kapitalit neto të emtuar në pasqyrat financiare të konsoliduara, të përcaktuar duke mbledhur interesin e kapitalit neto të filialit ligjor (blerësi nga pikëpamja kontabël), të emtuar në qarkullim menjëherë përpara kombinimit të biznesit, me vlerën e drejtë të shoqërisë mëmë ligjore (i bleri nga pikëpamja kontabël) ~~i përcaktuar në përputhje me këtë SNRF~~. Megjithatë, ...

...

B40 Kriteri identifikueshmërisë përcakton nëse një aktiv jomaterial njihet veças nga emri i mirë. Gjithsesi, kriteri as jep udhëzim për matjen me vlerën e drejtë të një aktivi jomaterial, as kufizon supozimet e përdorura në vlerësimin matjen me vlerën e drejtë të një aktivi jo-material. Për shembull, blerësi do të merrte parasysh supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të konsideronin përdornin gjatë caktimit të çmimit të aktivit jo-material, të tilla si pritshmëritë e rinovimit të kontratës në të ardhmen, në matjen me vlerën e drejtë. ...

B43 Gjatë Për të mbrojtur pozicionin e tij konkurrues, ose për arsye të tjera, blerësi mund të synojë të mos përdorë në mënyrë aktive një aktiv jo-financiar të blerë, ~~për shembull, një aktiv jomaterial nga procesi i kërkim-zhvillimit~~, ose nuk synon ta përdorë aktivin në një mënyrë që është e ndryshme nga mënyra me të cilën pjesëmarrësit e tjerë të

tregut do të përdorin atë sipas përdorimit të tij në shkallën më të lartë dhe më të mirë. Për shembull, ky mund të jetë rasti për një aktiv jo-material kërkim-zhvillimi të blerë, që blerësi ka në plan ta përdorë në mënyrë mbrojtëse, duke mos lejuar të tjerët ta përdorin atë. Megjithatë, blerësi do ta matë vlerën e drejtë të aktivit jo-financiar me vlerën e drejtë të përcaktuar në përputhje me duke supozuar shkallën më të lartë dhe më të mirë të përdorimit të tij nga pjesëmarrësit e tjerë e tregut, në përputhje me kushtin paraprak të vlerësimit të duhur, si në fillim, ashtu dhe gjatë matjes me vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit, për testimin e zhvlerësimit të mëpasshëm.

- B44 Ky SNRF lejon blerësin, të matë një interes jo-kontrollues tek i bleri, me vlerën e drejtë në datën e blerjes. Ndonjëherë një blerës është në gjendje të matë vlerën e drejtë në datën e blerjes të një interesi jo-kontrollues mbi bazën e një çmimi të kuotuar në një treg aktiv për çmimet për aksionet e kapitalit neto (dmth ato që nuk mbahen nga blerësi). Megjithatë, në situata të tjera, një çmim i kuotuar në një çmim treg aktiv të aksioneve të kapitalit neto, mund të mos jetë i disponueshëm. Në këto situata, blerësi do ta matë vlerën e drejtë të interesit jo-kontrollues duke përdorur një teknikë tjetër vlerësimi.
- B45 Vlerat e drejta të interesit të blerësit në të blerin dhe të interesit jo-kontrollues, mbi bazë çdo aksioni, mund të ndryshojnë. Diferenca kryesore ka të ngjarë të jetë si pasojë e përfshirjes së një primi kontrolli në vlerën e drejtë për aksion të interesit të blerësit në të blerin ose, anasjelltas, përfshirja e një skontoje për shkak të mungesës së kontrollit (referuar edhe si një skonto për pakicën interesin jo-kontrollues ) në vlerën e drejtë për aksion të interesit jo-kontrollues, në qoftë se pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh një prim të tillë ose skonto gjatë vlerësimit të interesit jo-kontrollues.
- B46 Në një kombinim biznesi, të arritur pa bërë transferimin e shumës, blerësi duhet ta zëvendësojë vlerën e drejtë në datën e blerjes të interesit të tij në të blerin, me vlerën e drejtë, në datën e blerjes, të shumës së transferuar për të matur emrin e mirë apo një fitim nga një blerje e volitshme (shih paragrafët 32-34). Blerësi do të masë vlerën e drejtë në datën e blerjes të interesit të tij në të blerin duke përdorur një apo më shumë teknika vlerësimi, që janë të përshatshme për rrethanat dhe për të cilat ka të dhëna të mjaftueshme në dispozicion. Nëse është përdorur më shumë se një teknikë vlerësimi, blerësi duhet të vlerësojë rezultatet e teknikave, duke pasur parasysh rëndësinë dhe besueshmërinë e inputeve të përdorura dhe shtrirjen e të dhënave të disponueshme.
- B49 Një matje me vlerën e drejtë të një njësie ekonomike të përbashkët do të përfshinte supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të bënin në lidhje me përfitimet e anëtarëve në të ardhmen, sikurse edhe supozimet përkatëse të pjesëmarrësve të tjerë të tregut që do të bënin në lidhje me njësinë ekonomike të përbashkët. Për shembull, një model i

~~flukseve monetare të vlerësuara një teknikë e vlerës aktuale~~ mund të përdoret për të ~~përcaktuar matur~~ vlerën e drejtë të një njësie ekonomike të përbashkët. Flukset e mjeteve monetare, të përdorura si inpute në model, do të bazoheshin në flukset monetare të pritshme të njësisë ekonomike të përbashkët, të cilat duket se pasqyrojnë reduktimin e përfitimeve për anëtarët, të tilla si tarifat e reduktuara të praktikuara për mallra dhe shërbime.

B64 Për të realizuar objektivin në paragrafin 59, blerësi do të japë informacionet shpjeguese në vijim, për çdo kombinim biznesi që ndodh gjatë periudhës raportuese:

...

(f) vlera e drejtë në datën e blerjes të shumës gjithsej të transferuar dhe vlera e drejtë në datën e blerjes për çdo klasë kryesore të shumës, të tilla si:

...

(iv) interesat e kapitalit neto të blerësit, duke përfshirë numrin e instrumenteve ose interesave të emetuara ose për t'u emetuar dhe mënyra e ~~përcaktimit matjes~~ me vlerën e drejtë të këtyre instrumenteve ose interesave.

...

(o) për çdo kombinim biznesi, në të cilin blerësi zotëron më pak se 100 për qind të interesave të kapitalit neto në të blerin në datën e blerjes:

...

(ii) për çdo interes jo-kontrollues në një të blerë, matur me vlerën e drejtë, teknikën(at) e vlerësimit dhe inputet e ~~modelit kryesor rëndësishme~~ përdorura për ~~përcaktimin për të matur~~ këtë vlerë.

...

## **SNRF 4 Kontratat e Sigurimit**

D9 Paragrafi 41E është shtuar si vijon:

41E SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, nxjerrë në maj të vitit 2011, ka ndryshuar përkufizimin e vlerës së drejtë në shtojcën A. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## **SNRF 5 Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje dhe veprimtaritë e ndërprera**

---

**D10** Paragrafi 44H është shtuar si vijon:

44H SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, nxjerrë në maj të vitit 2011, ka ndryshuar përkufizimin e vlerës së drejtë në shtojcën A. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## **SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese (i ndryshuar në tetor të vitit 2009)**

---

D11 [Nuk zbatohet për kërkesat]

D12 Paragrafi 3 është ndryshuar si vijon:

3 Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, me përjashtim të:

(a) ... në këto raste, njësitë ekonomike do të zbatojnë kërkesat e këtij SNRF-je, dhe për ato interesa të matura me vlerën e drejtë, kërkesat e SNRF-së 13 *Matja me vlerën e drejtë*. ...

...

D13 Paragrafët 27–27B janë fshirë.

D14 Paragrafi 28 është shtuar si vijon:

28 Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, një njësi ekonomike përcakton vlerën e tij të drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët UZ74-UZ79 të SNK 39). Megjithatë, evidenca më e mirë e vlerës së drejtë në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit (dmth. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë), vetëm nëse kushtet e përshkruara në paragrafin UZ76 të SNK 39 janë plotësuar. Kjo do të thotë se nuk mund të ketë një diferencë midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe shumës që do të përcaktohej në këtë datë duke përdorur teknikën e vlerësimit. Në qoftë se ekziston një diferencë e tillë, njësi ekonomike jep informacione shpjeguese, sipas klasës së instrumentit financiar: Në disa raste, njësi ekonomike nuk njih një fitim ose humbje neto në njohjen fillestare të një aktivi financiar ose pasivi financiar, sepse vlera e drejtë nuk është evidentuar as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv të njëjtë (dmth. një input i Nivelit 1), as bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e mbikëqyrura (shih paragrafin UZ76 të SNK 39). Në këto raste, njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese sipas klasës së aktivit financiar ose pasivit financiar:



(a) politikën e saj kontabël për njohjen në fitim ose humbje këtë-të diferencës midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit në fitimin ose humbjen, për të pasqyruar një ndryshim në faktorët (përfshirë kohën) që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysht në vendosjen e një çmimi do të merrnin parasysht gjatë caktimit të çmimit të aktivit ose pasivit (shih paragrafin UZ76A UZ76A (b) të SNK 39), ~~dhe~~

...

**(c)** pse njësi ekonomike ka arritur në përfundimin se çmimi i transaksionit nuk ishte evidenca më e mirë e vlerës së drejtë, duke përfshirë një përshkrim të evidencës që është në mbështetje të vlerës së drejtë.

D15 Paragrafi 29 është shtuar si vijon:

29 Dhënia e informacioneve shpjeguese për vlerën e drejtë nuk kërkohet:

...

(b) për një investim në instrumente të kapitalit neto, që nuk kanë një çmim të kuotuar tregu në një treg aktiv për një instrument të njëjtë (dmth. një input të Nivelit 1), ose derivativët e lidhur me këto instrumente të kapitalit neto, që maten me kosto në përputhje me SNK 39, sepse në të kundërt vlera e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri; ose

...

D16 Paragrafi 44P është shtuar si vijon:

44P Si rezultat i SNRF 13, të nxjerrë në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 3, 28, 29, B4 dhe B26 dhe Shtojca A dhe janë fshirë paragrafët 27–27B. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këtë ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF13.

D17 Në Shtojcën A, përkufizimi i rreziqeve të tjera të lidhura me çmimet është ndryshuar si më poshtë:

**rreziqe të tjera të lidhura me çmimet** Rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut (përveç atyre që rrjedhin nga **rreziku i normës së interesit** ose **rreziku i valutës**), nëse këto ndryshime janë shkaktuar nga faktorë të veçantë për instrumentin individual financiar ose emetuesin e tij, ose nga faktorët që ndikojnë në të gjitha instrumentet financiare të ngjashme që tregtohen në treg.

**SNRF 9 Instrumentet financiare (publikuar në nëntor 2009)**

- D18 Paragrafi 5.1.1 është ndryshuar si vijon:
- 5.1.1 **Në njohjen fillestare, një njësi ekonomike do të matë një aktiv financiar me vlerën e drejtë të tij (shih ~~paragrafët 48A dhe 48, UZ69-UZ82 të SNK 39~~) plus, në rastin e një aktivi financiar të përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, *kostot e transaksionit* që janë të ngarkueshme drejtpërdrejt në blerjen e aktivit financiar.**
- D19 Paragrafi 5.1.1A është shtuar si vijon:
- 5.1.1A **Megjithatë, nëse vlera e drejtë e aktivit financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafin B5.1 dhe paragrafin UZ76 të SNK 39.**
- D20 Paragrafët 5.2.1, 5.3.2, 8.2.5 dhe 8.2.11 janë ndryshuar si vijon:
- 5.2.1 **Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike do të matë një aktiv financiar, në përputhje me paragrafët 4.1-4.5, me vlerën e drejtë (shih ~~paragrafët 48A dhe 48, UZ69 të UZ82 të SNK 39~~) ose koston e amortizuar.**
- 5.3.2 **Në qoftë se, në përputhje me paragrafin 4.9, një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar në mënyrë që të matet me vlerën e drejtë, vlera e drejtë e tij përcaktohet matet në datën e riklasifikimit. Çdo fitim ose humbje neto që rrjedh nga një diferencë midis vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës së drejtë njihet në fitim ose humbje.**
- 8.2.5 Nëse një njësi ekonomike mat një kontratë hibride me vlerën e drejtë, në përputhje me paragrafin 4.4 ose paragrafin 4.5, por vlera e drejtë e kontratës hibride nuk është përcaktuar matet në periudhat krahasuese të raportimit, vlera e drejtë e kontratës hibride në periudhat krahasuese të raportimit do të jetë shuma e vlerave të drejta të përbërëseve (dmth derivativët e përfshirë dhe instrumentet bazë jo-derivativë) në fund të çdo periudhe raportimi krahasuese.
- 8.2.11 Nëse një njësi ekonomike ka kontabilizuar më parë, me kosto në përputhje me SNK 39, një investim në një instrument kapitali neto të pakuotuar, që nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument të njëjtit (dmth. një input të Nivelit 1) (ose një derivativ që është i lidhur dhe duhet të shlyhet më këtë instrument kapitali neto të pakuotuar), ajo do ta matë këtë instrument me vlerën e drejtë në datën e zbatimit fillestar. ...
- D21 Paragrafi 8.1.3 është shtuar si vijon:
- 8.1.3 Si rezultat i SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, publikuar në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 5.1.1 5.2.1 5.3.2,8.2.5, 8.2.11,

të B5.1, B5.4, B5.5, B5. 7, C8, C20, C22, C27 dhe C28 dhe është shtuar paragrafi 5.1.1A. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

D22 Në Shtojcën A teksti hyrës është ndryshuar si më poshtë:

Përkufizimi i termave të mëposhtëm jepet në paragrafin 11 të SNK 32 *Instrumentet financiare: Paraqitja, ose* në paragrafin 9 të SNK 39 ose në Shtojcën A të SNRF 13 dhe janë përdorur në këtë SNRF sipas kuptimit të dhënë në SNK 32, ose SNK 39 ose SNRF 13: ...

D23 Në shtojcën B paragrafi B B5.1, titulli sipër paragrafit B5.5 dhe paragrafët B5.5 dhe B5.7 janë ndryshuar si më poshtë:

B5.1 Vlera e drejtë e një aktivi financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit (dmth. vlera e drejtë e shumës së dhënë, shih gjithashtu SNRF 13 dhe paragrafin UZ76 të SNK 39). Megjithatë, nëse një pjesë e shumës së dhënë është për diçka tjetër, përveç instrumentit financiar, një njësi ekonomike do të matë vlerën e drejtë të instrumentit financiar ~~është vlerësuar duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët UZ74-UZ79 të SNK 39)~~. Për shembull, vlera e drejtë e një huaje ose të llogarie të arkëtueshme afatgjatë, që nuk mbart interes mund të ~~vlerësohet~~ matet si vlera aktuale e të gjitha arkëtimitëve të flukseve monetare të ardhshme të skontuara duke përdorur normën(at) mbizotëruese të interesit të tregut (tregjeve), për një instrument të ngjashëm (i ngjashëm si për nga monedha, afati, lloji i normës së interesit dhe faktorët të tjerë) me një përcaktim të ngjashëm të kredisë. Çdo shumë shtesë e huazuar është një shpenzim ose një reduktim i të ardhurave, vetëm nëse nuk kualifikohet për njohje si një lloj tjetër aktivi.

**Investimet në instrumente të kapitalit neto të pakuotuar (dhe kontratat për këto investime që duhet të shlyhen me dhënien e instrumenteve të kapitalit neto të pakuotuar)**

B5.5 ... Ky mund të jetë rasti kur disponohet informacion i pamjaftueshëm i kohëve të fundit për të ~~përcaktuar~~ matur vlerën e drejtë, apo në qoftë se ka një interval të gjerë të matjeve të mundshme të vlerës së drejtë dhe kostoja përfaqëson vlerësimin më të mirë të vlerës së drejtë brenda këtij intervali.

B5.7 ... Në këto raste, njësia ekonomike duhet të ~~vlerësojë~~ masë vlerën e drejtë.

D24 Në Shtojcën C, në paragrafin C8 ndryshimet në paragrafin 29 të SNRF 7 *Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese* janë ndryshuar si më poshtë:

29 Dhënia e informacioneve shpjeguese e vlerës së drejtë nuk kërkohet:

...

- (b) për derivativët e lidhur me investimet në instrumente të kapitalit neto, që nuk kanë një çmim tregu të kuotuar në një treg aktiv për një instrument të njëjtë (dmth input i Nivelit 1), që maten me kosto në përputhje me SNK 39, sepse në të kundërt vlera e tyre e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri; ose

...

D25 Në paragrafin C20, ndryshimet në paragrafin 1 të SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje* janë ndryshuar si më poshtë:

- 1 **Ky Standard do të zbatohet në kontabilitetin për investimet në pjesëmarrje. Megjithatë, nuk do të zbatohet për investimet në pjesëmarrje të zotëruara nga:**

- (a) **organizatat e sipërmarrjes së kapitaleve, ose**  
 (b) **fondet e përbashkëta, njësitë e besuara dhe njësitë ekonomike të ngjashme, duke përfshirë edhe investimet e lidhura me fondet e sigurimeve**

**që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet financiare* dhe SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe matja*. Një njësi ekonomike do të matë këto investime me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9. Një njësi ekonomike që zotëron këtë investim do të japë informacione shpjeguese siç kërkohet nga paragrafi 37(f).**

D26 Në paragrafin C22, ndryshimet në paragrafin 1 të SNK 31 *Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta* janë ndryshuar si më poshtë:

- 1 **Ky Standard do të zbatohet në kontabilitetin për interesat në sipërmarrjet e përbashkëta dhe në raportimin e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve të sipërmarrjes së përbashkët në pasqyrat financiare të sipërmarrësit dhe investitorëve, pavarësisht nga strukturat ose format në të cilat ndodhin aktivitetet e sipërmarrjes së përbashkët. Megjithatë, ky standard nuk zbatohet për interesat e sipërmarrësit në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht, të zotëruara nga:**

- (a) **organizatat e sipërmarrjes së kapitaleve, ose**  
 (b) **fondet e përbashkëta, njësitë e besuara dhe njësitë ekonomike të ngjashme, duke përfshirë edhe investimet e lidhura me fondet e sigurimeve**

**që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet financiare* dhe SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe matja*. Një njësi ekonomike do të matë këto investime me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9. Një sipërmarrës që zotëron këtë**

**investim do të japë informacione shpjeguese siç kërkohet nga paragrafët 55 dhe 56.**

D27 Në paragrafin C27, ndryshimet në paragrafët 9, 13 dhe 88 të SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja* janë ndryshuar si më poshtë:

9 ...

**Duhet vënë në dukje se SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë paragrafët 48, 48A, 49 dhe paragrafët UZ69-UZ82 në shtojcën A, i cili parashton kërkesat për përcaktimin e një matje të besueshme matjen me vlerën e drejtë të një pasivi financiar, zbatohet njëlloj për të gjitha zërat që maten me vlerën e drejtë, ose nëpërmjet përcaktimit ose në mënyrë tjetër, ose jepet informacion shpjegues për vlerën e tij të drejtë.**

...

13 Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të përcaktojë matë në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë të një derivativi të përfshirë, në bazë të afateve dhe kushteve të tij, vlera e drejtë e tij është diferenca midis vlerës së drejtë të kontratës hibride (të kombinuar) dhe vlerës së drejtë të instrumentit bazë në qoftë se këto mund të përcaktohen në bazë të këtij Standardi. Nëse njësi ekonomike nuk është në gjendje të përcaktojë matë vlerën e drejtë të derivativit të përfshirë duke përdorur këtë metodë, zbatohet paragrafi 12 dhe kontrata hibride (e kombinuar) konceptohet si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

88 **Një marrëdhënie mbrojtëse kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës sipas paragrafëve 89-102, nëse dhe vetëm nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme.**

...

(d) **Efektiviteti i mbrojtjes mund të matet me besueshmëri, dmth vlera e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të elementit të mbrojtur, që lidhen drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, dhe vlera e drejtë e instrumentit mbrojtës mund të maten me besueshmëri (shih paragrafin 47 (a) dhe paragrafet UZ80 dhe UZ81 të Shtojcës A për udhëzime në përcaktimin e vlerës së drejtë).**

...

D28 Në paragrafin C28, ndryshimet në paragrafët UZ64, të UZ80, UZ81 dhe UZ96 të SNK 39 janë ndryshuar si më poshtë:

UZ64Vlera e drejtë e një pasivi financiar në njohjen fillestare, zakonisht, është çmimi i transaksionit (dmth. vlera e drejtë e shumës së marrë, shih gjithashtu paragrafin UZ76 dhe SNRF 13). Megjithatë, nëse një pjesë e shumës së dhënë ose të marrë është për diçka tjetër përveç pasivit financiar, një njësi ekonomike do të matë vlerën e drejtë të pasivit financiar

~~vlërësohet, duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët UZ74-UZ79).~~

UZ80 Vlera e drejtë e derivativëve që janë të lidhur dhe duhet të shlyhen me dhënien e instrumenteve të kapitalit neto të ~~pakuotuar, që nuk kanë një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument të njëjtë (dmth input i Nivelit 1)~~ (shih paragrafin 47 (a)), është e matshme me besueshmëri nëse (a) ndryshueshmëria në intervalin e ~~vlërësimeve matjeve~~ të arsyeshme të vlerës së drejtë nuk është e rëndësishme për këtë instrument ose (b) probabilitetet e vlerësimeve të ndryshme brenda intervalit mund të vlerësohen në mënyrë të arsyeshme dhe të përdoren në ~~vlërësimin gjatë matjes~~ me vlerën e drejtë.

UZ81 Ka shumë situata, në të cilat ndryshueshmëria në intervalin e matjeve të arsyeshme të vlerës të drejtë ~~vlërëson~~ të derivativëve, që janë të lidhur dhe duhet të shlyhen me dhënien e instrumenteve të kapitalit neto të ~~pakuotuar, që nuk kanë një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument të njëjtë (pra një input të Nivelit 1)~~ (shih paragrafin 47 (a)), ka të ngjarë të mos jetë e rëndësishme. Normalisht është e mundur të ~~vlërësohet matet~~ vlera e drejtë e derivativëve të tillë që një njësi ekonomike ka blerë nga një palë e jashtme. Megjithatë, nëse intervali i ~~vlërësimeve matjeve~~ të arsyeshme të vlerës së drejtë është i rëndësishëm dhe probabilitetet e vlerësimeve të ndryshme nuk mund të vlerësohen në mënyrë të arsyeshme, një njësi ekonomike përjashtohet nga matja e instrumentit me vlerën e drejtë.

UZ96 Një derivativ që është i lidhur me instrumentet e kapitalit neto dhe duhet të shlyhet me dhënien e instrumenteve të kapitalit neto të ~~pakuotuar, që nuk kanë një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument të njëjtë (p.sh. një input i Nivelit 1)~~, dhe nuk është mbajtur me vlerën e drejtë, sepse nga ana tjetër vlera e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri (shih paragrafin 47 (a)), nuk mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës.

## **SNRF 9 Instrumentet financiare (publikuar në tetor 2010)**

D29 [Nuk zbatohet për kërkesat]

D30 Paragrafët 3.2.14, e 4.3.7 dhe 5.1.1 janë ndryshuar si më poshtë:

3.2.14 Kur një njësi ekonomike shpërndan shumë të mëparshme kontabël të një aktivi financiar më të madh midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që çregjistrohet, është e nevojshme të ~~matet~~ vlera e drejtë e pjesës që vazhdon të njihet ~~përcaktohet~~. Kur njësi ekonomike ka një histori të shitjes së pjesëve të ngjashme me pjesën që vazhdon të njihet apo ekzistojnë transaksione tregu të tjera për pjesë të tilla, çmimet e fundit të transaksioneve aktuale japin vlerësimin më të mirë të vlerës së drejtë të saj. ...

4.3.7 Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të ~~përcaktojë matë~~ në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë të një derivativi të përfshirë, në

bazë të afateve dhe kushteve të tij, vlera e drejtë e derivativit të përfshirë është diferenca midis vlerës së drejtë të kontratës hibride dhe vlerës së drejtë të instrumentit bazë, në qoftë se këto mund të përcaktohen në bazë të këtij SNRF-je. Nëse njëسيا ekonomike nuk është në gjendje të përcaktojë matë vlerën e drejtë të derivativit të përfshirë duke përdorur këtë metodë, zbatohet paragrafi 4.3.6 dhe kontrata hibride (e kombinuar) konceptohet si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

**5.1.1 Në njohjen fillestare, një njësi ekonomike do të matë një aktiv financiar ose pasiv financiar me vlerën e drejtë të tij (shih paragrafët ~~5.4.1–5.4.3 dhe B5.4.1–B5.4.17~~) plus ose minus, në rastin e një aktivi financiar ose pasivi financiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, *kostot e transaksionit që i ngarkohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të aktivit financiar ose pasivit financiar.***

D31 Paragrafi 5.1.1A është shtuar si vijon:

**5.1.1A Megjithatë, nëse vlera e drejtë e aktivit financiar ose pasivit financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafin B5.1A.**

D32 Paragrafi 5.2.1 është ndryshuar si vijon:

**5.2.1 Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike do të matë një aktiv financiar, në përputhje me paragrafët 4.1-4.5, me vlerën e drejtë (shih paragrafët ~~5.4.1, 5.4.2 dhe B5.4.1–B5.4.17~~) ose me koston e amortizuar (shih paragrafët 9 dhe UZ5–UZ8 të SNK 39)**

D33 Titulli sipër paragrafit 5.4.1 dhe paragrafët 5.4.1-5.4.3 janë fshirë.

D34 Paragrafët 5.6.2, 7.2.5, 7.2.11 dhe 7.2.12 janë ndryshuar si vijon:

**5.6.2 Në qoftë se, në përputhje me paragrafin 4.4.1, një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar në mënyrë që të matet me vlerën e drejtë, vlera e drejtë e tij përcaktohet matet në datën e riklasifikimit. Çdo fitim ose humbje neto që rrjedh nga një diferencë midis vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës së drejtë njihet në fitim ose humbje.**

7.2.5 Nëse një njësi ekonomike mat një kontratë hibride me vlerën e drejtë, në përputhje me paragrafin 4.1.4 ose paragrafin 4.1.5, por vlera e drejtë e kontratës hibride nuk është përcaktuar matet në periudhat krahasuese të raportimit, vlera e drejtë e kontratës hibride në periudhat krahasuese të raportimit do të jetë shumica e vlerave të drejta të përbërësve (dmth derivativët e përfshirë dhe instrumentet bazë jo-derivativë) në fund të çdo periudhe raportimi krahasuese.

7.2.11 Nëse një njësi ekonomike ka kontabilizuar më parë me kosto, në përputhje me SNK 39, një investim në një instrument kapitali neto të

pakuotuar, që nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument të njëjtë (dmth. një input të Nivelit 1) (ose një aktiv derivativ që është i lidhur dhe duhet të shlyhet duke dhënë një instrument të tillë kapitali neto të ~~pakuotuar~~), ajo do ta matë këtë instrument me vlerën e drejtë në datën e zbatimit fillestar. ...

7.2.12 Nëse një njësi ekonomike ka kontabilizuar më parë me kosto, në përputhje me SNK 39, një pasiv derivativ, që është i lidhur dhe duhet të shlyhet duke dhënë një instrument kapitali neto të ~~pakuotuar~~, që nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një instrument të njëjtë (dmth. një input të Nivelit 1), ajo do ta matë këtë pasiv derivativ me vlerën e drejtë në datën e zbatimit fillestar. ...

D35 Paragrafi 7.1.3 është shtuar si vijon:

7.1.3 Si rezultat i SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, publikuar në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 3.2.14, 4.3.7, 5.1.1, 5.2.1, 5.4.1, 5.6.2, 7.2.5, 7.2.11, 7.2. 12, është ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në Shtojcën A, janë ndryshuar paragrafët B3.2.11 B3.2.17, B5.1.1, B5.2.2, B5.4.8, B5.4.14, B5.4.16, B5.7.20, C3, C11, C26, C28, C30, C49 C53 dhe janë fshirë paragrafët 5.4.2, B5.4.1-B5.4.13 dhe janë shtuar paragrafët 5.1.1A, B5.1.2A dhe B5.2.2A. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

D36 Në shtojcën B, paragrafët B3.2.11, B3.2.17, B5.1.1 dhe B5.2.2 janë ndryshuar si vijon:

B3.2.11 ~~Në vlerësimin Gjatë matjes së vlerave të drejta të pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që çregjistrohet, për qëllime të zbatimit të paragrafit 3.2.13, një njësi ekonomike zbaton kërkesat për matjen me vlerën e drejtë në paragrafët 5.4.1-5.4. 3 dhe B5.4.1-B5.4.13~~ SNRF 13 përveç paragrafit 3.2.14.

B3.2.17 Ky paragraf ilustron zbatimin e metodës së përfshirjes së vazhdueshme, kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë ekonomike është në një pjesë të një aktivi financiar.



Supozojmë se një njësi ekonomike ka një portofol huash të parapagueshme ... Vlera e drejtë e huave në datën e transaksionit është 10, 100 NJM dhe vlera e drejtë e vlerësuar e marzhit shtesë prej 0.5 për qind është 40NJM.

...

Njësia ekonomike llogarit fitimin ose humbjen nga shitja e pjesës prej 90 për qind e flukseve të mjeteve monetare. Duke supozuar se vlerat e drejta të veçanta të pjesës së transferuar 90 për qind dhe pjesës së mbetur 10 për qind nuk janë të disponueshme në datën e transferimit, njësia ekonomike shpërndan vlerën kontabël neto të aktivit në përputhje me paragrafin 3.2.14 si vijon:

	Vlera e drejtë e vlerësuar	Përqindja	Vlera kontabël neto e shpërndarë
Pjesa e transferuar	9,090	90%	9,000
Pjesa e mbetur	1,010	10%	1,000
<b>Gjithsej</b>	<b>10,100</b>		<b>10,000</b>

...

- B5.1.1 Vlera e drejtë e një aktivi financiar në njohjen fillestare është, zakonisht, çmimi i transaksionit (dmth. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë, shih gjithashtu paragrafin B5.4.8 B5.1.2A dhe SNRF 13. Megjithatë, nëse një pjesë e shumës së dhënë ose të marrë është për diçka tjetër, përveç instrumentit financiar, një njësi ekonomike do të matë vlerën e drejtë të instrumentit financiar është vlerësuar duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët B5.4.6–B5.4.12). Për shembull, vlera e drejtë e një huaje ose llogari të arkëtueshme afatgjatë, që nuk mbart interes mund të vlerësohet matet si vlera aktuale e të gjitha arkëtimeve të flukseve monetare të ardhshme të skontuara duke përdorur normën(at) mbizotëruese të interesit të tregut (tregjeve), për një instrument të ngjashëm (i ngjashëm si për nga monedha, afati, lloji i normës së interesit dhe faktorë të tjerë) me një përcaktim të ngjashëm të kredisë. Çdo shumë shtesë e huazuar është një shpenzim ose një reduktim i të ardhurave, vetëm nëse nuk kualifikohet për njohje si një lloj tjetër aktivi.

D37 Paragrafët B5.1.2A dhe B5.2.2A janë shtuar si më poshtë:

B5.1.2A Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare zakonisht është çmimi i transaksionit (dmth. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë, shih gjithashtu SNRF 13). Nëse një njësi ekonomike përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, siç përmendet në paragrafin 5.1.1A, njësia ekonomike do ta trajtojë këtë instrument në këtë datë si vijon:

- (a) me matjen e kërkuar nga paragrafi 5.1.1, në qoftë se vlera e drejtë evidentohet me anë të një çmimi të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv të njëjtë (dmth input të Nivelit 1), ose bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna vetëm nga tregjet e mbikëqyrura. Një njësi ekonomike do të njohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit, si një fitim ose humbje.
- (b) në të gjitha rastet e tjera, me matjen e kërkuar nga paragrafi 5.1.1, të rregulluar me diferencën e shtyrë midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Pas njohjes fillestare, njësia ekonomike do ta njohë këtë diferencë të shtyrë si një fitim ose humbje vetëm në atë masë që ajo vjen nga një ndryshim në një faktor (përfshirë kohën), që pjesëmarrësit e tregut do të kishin parasysh gjatë caktimit të çmimit të aktivit ose pasivit.

B5.2.2A Matja e mëpasshme e një aktivi financiar ose pasivi financiar dhe njohja e mëpasshme e fitimeve dhe humbjeve neto, të përshkruara në paragrafin B5.1.2A, do të jetë në përputhje me kërkesat e këtij SNRF-je.

D38 Paragrafët B5.4.1-B5.4.13 dhe titujt e tyre përkatëse janë fshirë.

D39 Titulli mbi paragrafi B5.4.14 dhe paragrafët B5.4.14, B5.4.16 dhe B5.7.20 janë ndryshuar si më poshtë:

**Investimet në instrumente të kapitalit neto të pakuotuar (dhe kontratat për këto investime që duhet të shlyhen me dhënien e instrumenteve të kapitalit neto të pakuotuar)**

B5.4.14... Ky mund të jetë rasti kur disponohet informacioni i pamjaftueshëm i kohëve të fundit për të përcaktuar mat vlerën e drejtë, apo në qoftë se ka një interval të gjerë të matjeve të mundshme të vlerës së drejtë dhe kostoja përfaqëson vlerësimin më të mirë të vlerës së drejtë brenda këtij intervali.

B5.4.16... Për sa kohë që secili prej këtyre faktorëve ekziston, ata mund të tregojnë se kostoja mund të mos jetë përfaqësuese e vlerës së drejtë.

## SNRF13 MATJA ME VLEREN E DREJTE

Në këto raste, njësia ekonomike duhet të vlerësojë matë vlerën e drejtë.

B5.7.20 Si me të gjitha vlerësimet matjet me vlerën e drejtë, metoda e matjes e një njësie ekonomike, për përcaktimin e pjesës së ndryshimit në vlerën e drejtë të pasivit, që i takon ndryshimeve në rrezikun e kreditë, duhet të shfrytëzojë maksimumin e inputeve përkatëse të verifikueshme të tregut dhe përdorimin minimal të inputeve të paverifikueshme.

D40 Në Shtojcën C, në paragrafin C3 ndryshimet në paragrafët D15 dhe D20 të SNRF 1 *Adaptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar* janë ndryshuar si më poshtë:

D15 Në qoftë se një zbatues për herë të parë mat një investim të tillë me kosto, në përputhje me SNK 27, ai do ta matë këtë investim me një nga shumtë e mëposhtme në pasqyrën individuale të tij të çeljes sipas SNRF-ve të pozicionit financiar:

...

(b) kostoja e supozuar. Kostoja e supozuar e një investimi të tillë do të jetë:

(i) vlera e drejtë e tij (e përcaktuar në përputhje me SNRF 9) në pasqyrat financiare individuale të njësies ekonomike, në datën e tranzicionit në SNRF-të; ose

...

D20 Pavarësisht nga kërkesat e paragrafëve 7 dhe 9, një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat në fjalinë e fundit të paragrafin B5.4.8 dhe në paragrafin B5.4.9 B5.1.2A (b) të SNRF 9, në një nga mënyrat e mëposhtme:

...

D41 Në paragrafin C11 ndryshimet në paragrafin 28 të SNRF 7 *Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese* janë ndryshuar si më poshtë:

28 Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, një njësi ekonomike përcakton vlerën e tij të drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët B5.4.6 B5.4.12 të SNRF9). Megjithatë, evidenca më e mirë e vlerës së drejtë në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit (dmth. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë), vetëm nëse kushtet e përshkuara në paragrafin B5.4.8 të SNRF 9 janë plotësuar. Kjo do të thotë se nuk mund të ketë një diferencë midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe shumës që do të përcaktohet në këtë datë duke përdorur teknikën e vlerësimit. Në qoftë se ekziston një diferencë e tillë, njësia ekonomike jep informacione shpjeguese, sipas klasës së instrumentit financiar: Në disa raste, njësia ekonomike nuk njeht një fitim ose humbje neto në njohjen fillestare të një aktivi financiar ose pasivi financiar, sepse

vlera e drejtë nuk është evidentuar as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv të njëjtë (dmth. një input i Nivelit 1), as bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e mbikëqyrura (shih paragrafin B5.4.8 të SNRF 9). Në këto raste, njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese sipas klasës së aktivitetit financiar ose pasivitetit financiar:

(a) politikën e saj kontabël për njohjen në fitim ose humbje këtë-të diferencës midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit në fitimin ose humbjen, për të pasqyruar një ndryshim në faktorët (përfshirë kohën) që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në vendosjen e një çmimi do të merrnin parasysh gjatë caktimit të çmimit të aktivitetit ose pasivitetit (shih paragrafin B5.4.9 B5.1.2A(b) të SNRF9).. ; dhe

...

(c) pse njësia ekonomike ka arritur në përfundimin se çmimi i transaksionit nuk ishte evidenca më e mirë e vlerës së drejtë, duke përfshirë një përshkrim të evidencës që është në mbështetje të vlerës së drejtë.

D42 Në paragrafin C26 ndryshimet në paragrafin 1 të SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje* janë ndryshuar si më poshtë:

1 **Ky Standard do të zbatohet në kontabilitetin për investimet në pjesëmarrje. Megjithatë, nuk do të zbatohet për investimet në pjesëmarrje të zotëruara nga:**

- (a) **organizatat e sipërmarrjes së kapitaleve, ose**
- (b) **fondet e përbashkëta, njësitë e besuara dhe njësitë ekonomike të ngjashme, duke përfshirë edhe investimet e lidhura me fondet e sigurimeve**

**që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet financiare*. Një njësi ekonomike do të matë këto investime me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9. Një njësi ekonomike që zotëron këtë investim do të japë informacione shpjeguese siç kërkohet nga paragrafi 37(f).**

D43 Në paragrafin C28, ndryshimet në paragrafin 1 të SNK 31 *Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta* janë ndryshuar si më poshtë:

1 **Ky Standard do të zbatohet në kontabilitetin për interesat në sipërmarrjet e përbashkëta dhe në raportimin e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve të sipërmarrjes së përbashkët në pasqyrat financiare të sipërmarrësit dhe investitorëve, pavarësisht nga strukturat ose format në të cilat ndodhin aktivitetet e sipërmarrjes së përbashkët. Megjithatë, ky standard nuk zbatohet**

**për interesat e sipërmarrësit në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht të zotëruara nga:**

- (a) **organizatat e sipërmarrjes së kapitaleve, ose**
- (b) **fondet e përbashkëta, njësitë e besuara dhe njësitë ekonomike të ngjashme, duke përfshirë edhe investimet e lidhura me fondet e sigurimeve**

**që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet financiare*. Një njësi ekonomike do të matë këto investime me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9. Një sipërmarrës që zotëron këtë investim do të japë informacione shpjeguese siç kërkohet nga paragrafët 55 dhe 56.**

D44 Në paragrafin C30 ndryshimet në paragrafin 23 të SNK 32 *Instrumentet financiare: Paraqitja* janë ndryshuar si më poshtë:

23 ... Një shembull është një detyrim i njësisë ekonomike sipas një kontrate të ardhshme për t'i blerë instrumentet e kapitalit neto me mjete monetare. Kur Pasivi financiar njihet fillimisht me sipas SNRF 9, vlera e drejtë e tij (vlerën aktuale të shumës së riblerjes), dhe riklasifikohet nga kapitali neto. ...

D45 Në paragrafin C49, ndryshimet në paragrafin A8 të aksioneve KIRFN 2 *Aksionet e anëtarëve të njësisve ekonomike të tipit kooperative dhe instrumente të ngjashme* janë ndryshuar si më poshtë:

A8 Aksionet shtesë të anëtarëve, në lidhje me moslejimin e riblerjes kundrejt riblerjes, janë pasive financiare. Njësia ekonomike kooperative e mat këtë pasiv financiar me vlerën e drejtë në njohjen fillestare. Meqë këto aksione riblihen sipas kërkesës, njësia ekonomike e tipit kooperativë përcakton mat vlerën e drejtë të këtij pasivi financiar në përputhje me paragrafin 47 të SNRF 13, siç kërkohet nga paragrafi 5.4.3 i SNRF 9, i cili thotë: "Vlera e drejtë e një pasivi financiar me një tipar kërkueshmërie pa afat (p.sh. një depozitë pa afat) nuk është më e vogël se shumta e pagueshme sipas kërkesës ... "Prandaj, njësia ekonomike e tipit kooperativë klasifikon si pasive financiare shumën maksimale të pagueshme sipas kërkesës në bazë të kushteve të riblerjes.

D46 Në paragrafin C53 ndryshimet në paragrafin 7 të KIRFN19 *Shlyerja e pasiveve financiare me instrumente të kapitalit neto* janë ndryshuar si më poshtë:

7 Në qoftë se vlera e drejtë e instrumenteve të kapitalit neto të emetuara nuk mund të matet me besueshmëri, atëherë instrumentet e kapitalit neto do të maten për të pasqyruar vlerën e drejtë të pasivit financiar të shlyer. Në matjen e vlerës së drejtë të një pasivi financiar të shlyer që përfshin një tipar kërkueshmërie pa afat (p.sh. një depozitë pa afat), paragrafi 5.4.3 47 i SNRF 9 SNRF13 nuk zbatohet.

## **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare**

---

D47 Paragrafët 128 dhe 133 janë ndryshuar si më poshtë:

- 128 Dhënia e informacioneve shpjeguese në paragrafin 125 nuk kërkohet për aktivet dhe pasivet me një rrezik të konsiderueshëm që shumat e tyre kontabël mund të ndryshojnë materialisht brenda vitit të ardhshëm financiar, në qoftë se në fund të periudhës raportuese, ato maten me vlerën e drejtë të bazuar në ~~çmimet e mbikëqyrura kohët e fundit në treg një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv të njëjtë~~. Të tilla vlera të drejta mund të ndryshojnë materialisht brenda vitit të ardhshëm financiar, por këto ndryshime nuk do të rezultonin nga supozimet apo burimet e tjera të vlerësimit të pasigurisë në fund të periudhës raportuese.
- 133 SNRF- të e tjera kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese për disa nga supozimet që ndryshe do të ishin të nevojshme në përputhje me paragrafin 125. Për shembull, SNK 37 kërkon të jepen informacione shpjeguese, në rrethana të caktuara, mbi supozimet kryesore lidhur me ngjarjet e ardhshme që ndikojnë në klasat e provizioneve. ~~SNRF-7 SNRF13 Matja me vlerën e drejtë kërkon të jepen informacione shpjeguese mbi supozimet e rëndësishme (duke përfshirë teknikën (teknikat) e vlerësimit dhe inputet), që njësia ekonomike përdor gjatë matjes në vlerësimin së vlerave të drejta të aktiveve financiare dhe pasiveve, financiare që janë të mbartura me vlerën e drejtë. SNK 16 kërkon të jepen informacione shpjeguese për supozimeve e rëndësishme që njësia ekonomike përdor në vlerësimin e vlerave të drejta të zërave të rivlerësuar të ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve.~~

D48 Paragrafi 139I është shtuar si vijon:

- 139I SNRF 13, publikuar në maj të vitit 2011, ka ndryshuar paragrafët 128 dhe 133. Një njësi ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## **SNK 2 Inventarët**

---

D49 Paragrafi 7 është shtuar si vijon:

- 7 Vlera neto e realizueshme i referohet shumës neto që një njësi ekonomike pret për të realizuar nga shitja e inventarit në rrjedhën normale të biznesit. ~~Vlera e drejtë pasqyron shumën për të cilën i njëjti inventar mund të shkëmbejoj ndërmjet blerësve të mirëinformuar dhe të vullnetshëm dhe shitësve në treg. Vlera e drejtë pasqyron çmimin me të cilin një transaksion i rregullt për të shitur të njëjtin inventar, në tregun kryesor (apo më të favorshëm) për këtë inventar, do të ndodhte midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Vlera e parë është një vlerë specifike e njësishë ekonomike, ndërsa vlera e fundit nuk është. Vlera~~

neto e realizueshme për inventarët nuk mund të barazohet me vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

D50 Paragrafi 40C është shtuar si vijon:

40C Si rezultat i SNRF13, publikuar në maj të vitit 2011, ka ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në paragrafin 6 dhe është ndryshuar paragrafi 7. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## ***SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet***

---

D51 Paragrafi 52 është ndryshuar si vijon:

52 Prandaj, zbatimi në mënyrë retrospektive i një politike të re kontabël ose korigjimi i një gabimi të periudhës së mëparshme kërkon të jepet informacion i veçantë, që

(a) siguron evidencë të rrethanave që kanë ekzistuar në datën (datat), kur ka ndodhur transaksioni, ngjarja tjetër ose kushti, dhe

(b) do të kishte qenë në dispozicion kur pasqyrat financiare, për këtë periudhë të mëparshme, janë autorizuar për publikim

nga informacionet e tjera. Për disa lloje vlerësimesh (p.sh. një vlerësim i një matje e vlerës së drejtë që përdor inpute të rëndësishme të paverifikueshme jo të bazuara në një çmim të mbikëqyrur ose inpute të mbikëqyrura), është praktikisht e pamundur të veçohet nga këto lloj informacionesh. Kur zbatimi retrospektiv ose riparaqitja retrospektive do të kërkonte të bëhej një vlerësim i rëndësishëm, për të cilin është i pamundur të bëhet veçimi i këtyre dy lloj informacioneve, është praktikisht e pamundur të zbatohet politika e re kontabël ose të korigjohet gabimi i periudhës së mëparshme në mënyrë retrospektive.

D52 Paragrafi 54C është shtuar si vijon:

54C Si rezultat i SNRF13, publikuar në maj të vitit 2011, ka ndryshuar paragrafi 52. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## ***SNK 10 Ngjarjet pas datës së bilancit***

---

D53 Paragrafi 11 është shtuar si vijon:

11 Një shembull i një ngjarjeje të pakorigjueshme pas datës së bilancit është një rënie në vlerën e drejtë të tregut të investimeve midis datës së bilancit dhe datës kur pasqyrat financiare janë autorizuar për publikim.

Rënia në vlerën ~~e drejtë të tregut~~, normalisht, nuk ka të bëjë me kushtet e investimeve në fund të periudhës raportuese, por pasqyron rrethanat që kanë lindur më pas. ...

D54 Paragrafi 23A është shtuar si vijon:

23A SNRF 13, publikuar në maj të vitit 2011, ka ndryshuar paragrafin 11. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## **SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale (Toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje)**

D55 Paragrafi 26 është ndryshuar si vijon:

26 Vlera e drejtë e një aktivi për të cilën transaksionet e krahasueshme të tregut ~~nuk ekzistojnë~~ është e matshme me besueshmëri nëse (a) ndryshueshmëria në intervalin e matjeve vlerësimeve të arsyeshme të vlerës së drejtë nuk është e rëndësishme për atë aktiv ose (b) probabilitetet e vlerësimeve të ndryshme brenda intervalit mund të vlerësohen në mënyrë të arsyeshme dhe të përdoren në vlerësimin gjatë matjes së vlerës së drejtë. Nëse një njësi ekonomike është në gjendje të përcaktojë masë në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë qoftë të aktivit të marrë, qoftë të aktivit të dhënë, atëherë vlera e drejtë e aktivit të dhënë përdoret për të matur koston e aktivit të marrë, përveç kur vlera e drejtë e aktivit të marrë është qartësisht e evidentueshme.

D56 Paragrafët 32 dhe 33 janë fshirë.

D57 Paragrafët 35 dhe 77 janë ndryshuar si vijon:

35 Kur një element i aktiveve afatgjata materiale rivlerësohet, çdo amortizim i akumuluar në datën e rivlerësimit trajtohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

(a) riparaqitet proporcionalisht me ndryshimin në vlerën kontabël bruto të aktivit, në mënyrë që vlera kontabël neto e aktivit pas rivlerësimit të jetë e barabartë me shumën e tij të rivlerësuar.

Kjo metodë përdoret shpesh kur një aktiv rivlerësohet, nëpërmjet zbatimit të një indeksi për të përcaktuar koston e amortizuar e tij të zëvendësimit (shih SNRF 13).

...

77 **Në qoftë se zërat e aktiveve afatgjata materiale janë deklaruar me shumat e rivlerësuara, do të jepet informacion shpjegues për sa më poshtë, përveç informacioneve shpjeguese të kërkuara nga SNRF 13:**

...



- (c) ~~[fshirë] metodat dhe supozimet e rëndësishme të zbatuara në vlerësimin e vlerave të drejta të zërave;~~
- (d) ~~[fshirë] shkallën në të cilën vlerat e drejta të zërave janë përcaktuar drejtpërdrejtë duke iu referuar çmimeve të mbikëqyrura në një treg aktiv ose transaksione më të fundit të tregut në kushtet e e transaksionit të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën duke përdorur teknika të tjera të vlerësimit;~~

...

D58 Paragrafi 81F është shtuar si vijon:

81F Si rezultat i SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, publikuar në maj të vitit 2011, ka ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në paragrafin 6, janë ndryshuar paragrafët 26,35 dhe 77 dhe janë fshirë paragrafët 32 dhe 33. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## **SNK 17 Qiratë**

---

D59 Paragrafi 6A është shtuar si vijon:

6A SNK 17 përdor termin 'vlera e drejtë' në një mënyrë që ndryshon në disa aspekte nga përkufizimi i vlerës së drejtë në SNRF13 *Matja me vlerën e drejtë*. Prandaj, gjatë zbatimit të SNK 17, një njësi ekonomike e mat vlerën e drejtë në përputhje me SNK 17, dhe jo sipas SNRF13.

## **SNK 18 Të ardhurat**

---

D60 Paragrafi 42 është shtuar si vijon:

42 Si rezultat i SNRF13, publikuar në maj të vitit 2011, ka ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në paragrafin 7. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim, kur ajo të zbatojë SNRF13.

## **SNK 19 Përfitimet e punonjësve**

---

D61 [Nuk zbatohet për kërkesat]

D62 Paragrafët 50 dhe 102 janë ndryshuar si vijon:

50 Kontabiliteti i një njësie ekonomike për skemat e përfitimeve të përcaktuara, përfshin hapat e mëposhtëm:

...

- (c) ~~përcaktimin matjen e vlerës së drejtë të çdo aktivi të skemës (shih paragrafët 102–104);~~

...

- 102 ~~Vlera e drejtë e çdo aktivi të skemës zbritet në përcaktimin e shumës të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me sipas paragrafin 54. Kur çmimi i tregut nuk është i disponueshëm, vlera e drejtë e aktiveve të skemës vlerësohet; për shembull, duke skontuar flukset monetare të ardhshme të pritshme, duke përdorur një normë skontimi që pasqyron si rrezikun e lidhur me aktivet e skemës dhe datën e maturimit ose të nxjerrjes së pritshme jashtë përdorimit të këtyre aktiveve (ose, nëse ato nuk kanë maturim, periudhë e pritshme deri në shlyerjen e detyrimit përkatës).~~

D63 Paragrafi 162 është shtuar si vijon:

- 162 Si rezultat i SNRF 13, publikuar në maj të vitit 2011, ka ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në paragrafin 7 dhe janë ndryshuar paragrafët 50 dhe 102. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## ***SNK 20 Kontabiliteti për Grantet qeveritare dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për ndihmën qeveritare***

---

D64 Paragrafi 45 është shtuar si vijon:

- 45 Si rezultat i SNRF 13, të nxjerrë në maj të vitit 2011, ka ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në paragrafin 3. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## ***SNK 21 Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit të monedhave të huaja***

---

D65 Paragrafi 23 është shtuar si vijon:

- 23 **Në fund të çdo periudhe raportimi:**

...

- (c) zërat jo-monetare, që janë të matur me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj, do të përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është ~~përcaktuar~~ matur.

D66 Paragrafi 60G është shtuar si vijon:

- 60G Si rezultat i SNRF 13, të nxjerrë në maj të vitit 2011, ka ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në paragrafin 8 dhe ka ndryshuar paragrafi

23. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## **SNK 28 Investime në pjesëmarrje (i ndryshuar në tetor të vitit 2009)**

---

D67 Paragrafët 1 dhe 37 janë ndryshuar si vijon:

1 **Ky Standard do të zbatohet në kontabilitetin për investimet në pjesëmarrje. Megjithatë, nuk do të zbatohet për investimet në pjesëmarrje të zotëruara nga:**

- (a) **organizatat e sipërmarrjes së kapitaleve, ose**
- (b) **fondet e përbashkëta, njësitë e besuara dhe njësitë ekonomike të ngjashme, duke përfshirë edhe investimet e lidhura me fondet e sigurimeve**

**që në njohjen fillestare janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose janë klasifikuar në përputhje me SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe matja*. Për këto Të tilla investime do të maten me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 39, një njësi ekonomike do të njohë me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim ose humbje në periudhën e ndryshimit. Një njësi ekonomike që zotëron një investim të tillë do të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 37(f).**

37 **Do të jepen informacionet e mëposhtme shpjeguese për:**

- (a) **vlera e drejtë e investimeve në pjesëmarrjet për të cilat ka çmime tregu të kuotuar kuotime të publikuara të çmimit;**

...

D68 Paragrafi 41G është shtuar si vijon:

41G **Si rezultat i SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, i nxjerrë në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 1 dhe 37. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.**

## **SNK 31 Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta (i ndryshuar në tetor të vitit 2009)**

---

D69 Paragrafi 1 është ndryshuar si vijon:

1 **Ky Standard do të zbatohet në kontabilitetin për interesat në sipërmarrjet e përbashkëta dhe në raportimin e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve të sipërmarrjes së përbashkët në pasqyrat financiare të sipërmarrësit dhe investitorëve, pavarësisht**

nga strukturat ose format në të cilat ndodhin aktivitetet e sipërmarrjes së përbashkët. Megjithatë, ky standard nuk zbatohet për interesat e sipërmarrësit në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht të zotëruara nga:

- (a) organizatat e sipërmarrjes së kapitaleve, ose
- (b) fondet e përbashkëta, njësitë e besuara dhe njësitë ekonomike të ngjashme, duke përfshirë edhe investimet e lidhura me fondet e sigurimeve

që në njohjen fillestare janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose janë klasifikuar si të mbajtura për tregtim në përputhje me SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe matja*. ~~Për këto Të tilla investime do të maten me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 39, një njësi ekonomike do të njohë~~ me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim ose humbje në periudhën e ndryshimit. Një sipërmarrës që zotëron një interes të tillë do të japë informacione shpjeguese siç kërkohet nga paragrafët 55 dhe 56.

D70 Paragrafi 58F është shtuar si vijon:

58F Si rezultat i SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, i nxjerrë në maj të vitit 2011, ka ndryshuar paragrafi 1. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## **SNK 32 *Instrumentet financiare: Paraqitja (i ndryshuar në shtator të vitit 2010)***

---

D71 Paragrafi 23 është ndryshuar si vijon:

23 ... Kur Pasivi financiar njihet fillimisht sipas SNK 39, vlera e drejtë e tij (me vlerën aktuale të shumës së riblerjes), dhe rriklassifikohet nga kapitali neto. ...

D72 Paragrafi 97J është shtuar si vijon:

97J Si rezultat i SNRF 13, të nxjerrë në maj të vitit 2011, ka ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në paragrafin 11 dhe janë ndryshuar paragrafët 23 dhe UZ31. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF13.

D73 Në Udhëzuesin për zbatim paragrafi UZ31 është ndryshuar si më poshtë:

UZ31Një formë e zakonshme e instrumentit financiar të përbërë është një instrument borxhi me një opion konvertimi të përfshirë, siç është një obligacion i konvertueshëm në aksione të zakonshme të emetuesit, dhe pa ndonjë karakteristikë tjetër të derivativit të

përfshirë. Paragrafi 28 kërkon që emetuesi i një instrumenti të tillë financiar të paraqesë përbërësin e pasivit dhe të përbërësit të kapitalit veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar, si vijon:

...

- (b) Instrumenti i kapitalit neto është një opsjon i përfshirë për të konvertuar pasivin në kapitalin e emetuesit. ~~Vlera e drejtë e opsjonit përbën vlerën e tij në kohë dhe vlerën e tij të përcaktuar, nëse ka.~~ Ky opsjon ka vlerë në njohjen fillestare edhe kur ai është pa mjete monetare.

### **SNK 33 Fitimet për aksion**

D74 Paragrafët 8 dhe 47A janë ndryshuar si vijon:

- 8 Termat e përkufizuara në SNK 32 *Instrumentet financiarë: Paraqitja* përdoren në këtë standard sipas kuptimeve të specifikuara në paragrafin 11 të SNK 32, përveç rasteve kur vihet në dukje e kundërta. SNK 32 jep përkufizimet e instrumentit financiar, aktivitetit financiar, pasivit financiar, dhe instrumentit të kapitalit neto dhe vlerës së drejtë, dhe jep udhëzime për zbatimin e këtyre përkufizimeve. SNK 13 Matja me vlerën e drejtë përkufizon vlerën e drejtë dhe përcakton kërkesat për zbatimin e këtij përkufizimi.

- 47A Për opsionet e aksionit dhe marrëveshjet e tjera për pagesa të bazuara në aksione, për të cilat zbatohet SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione*, çmimi i emetimit, referuar paragrafit 46, dhe çmimi i ushtrimit, referuar paragrafit 47, do të përfshijnë vlerën e drejtë (e matur në përputhje me SNRF 2 ) të mallrave apo shërbimeve për t'ia dhënë njësisë ekonomike në të ardhmen sipas opsjonit të aksionit ose marrëveshjeve të tjera për pagesa të bazuara në aksione.

D75 Paragrafi 74C është shtuar si vijon:

- 74C Si rezultat i SNRF 13, i nxjerrë në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 8, 47A dhe A2. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

D76 Në shtojcën A, paragrafi A2 është ndryshuar si vijon:

- A2 Emetimi i aksioneve të zakonshme në kohën e ushtrimit ose konvertimit të aksioneve potenciale të zakonshme zakonisht nuk krijon një element bonusi. Kjo ndodh për shkak se aksionet e zakonshme potenciale emetohen zakonisht për vlerën ~~e plotë të drejtë~~, duke rezultuar në një ndryshim proporcional të burimeve që ka në dispozicion njësia ekonomike. Megjithatë, në një emetim të drejtash, çmimi i ushtrimit është shpesh më i vogël se vlera e drejtë të aksioneve. ... Teorikisht, vlera e drejtë për aksion e ish-të drejtave llogaritet duke mbledhur vlerën ~~e tregut e drejtë~~ totale të aksioneve menjëherë përpara ushtrimit

të të drejtave me të ardhurat nga ushtrimi i të drejtave, dhe pjesëtohet me numrin e aksioneve që janë në qarkullim pas ushtrimit të të drejtave. Kur të drejtat tregtohen publikisht, veçmas nga aksionet, para datës së ushtrimit, vlera e drejtë për qëllimet e kësaj llogaritjeje matet në mbylljen e ditës së fundit në të cilën janë tregtuar aksionet së bashku me të drejtat.

## **SNK 34 Raportimi financiar i ndërmjetëm (i ndryshuar në maj 2010)**

---

D77 [Nuk zbatohet për kërkesat]

D78 Paragrafi 16A(j) është shtuar si vijon:

16A **Përveç dhënies së informacioneve të rëndësishme për ngjarjet e rëndësishme dhe transaksionet në përputhje me paragrafin 15-15C, një njësi ekonomike do të përfshijë informacionin e mëposhtëm në shënimet e pasqyrave të saj financiare të ndërmjetme, nëse nuk është dhënë ky informacion diku tjetër në raportin financiar të ndërmjetëm. Normalisht, informacioni do të raportohet në bazë të vitit financiar deri më sot.**

...

(j) **për instrumentet financiare, dhënia e informacioneve shpjeguese rreth vlerës së drejtë, të kërkuar nga paragrafët 91-93 (h), 94-96, 98 dhe 99 të SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë dhe paragrafët 25, 26 dhe 28-30 të SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese.**

D79 Paragrafi 50 është shtuar si vijon:

50 Si rezultat i SNRF 13, i nxjerrë në maj të vitit 2011, është shtuar paragrafi 16A(j). Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim, kur ajo të zbatojë SNRF 13.

## **SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve**

---

D80 Paragrafi 5 është shtuar si vijon:

5 Ky Standard nuk zbatohet për aktivet financiare sipas objektit të SNK 39, për aktivet afatgjata materiale për investim me vlerën e drejtë në përputhje me sipas objektit të SNK 40, për aktivet biologjike që lidhen me aktivitetin bujqësor të matura me vlerën e drejtë minus kostot për shitje në përputhje me sipas objektit të SNK 41. Megjithatë, ky Standard zbatohet për aktivet që janë mbartur me shumën e rivlerësuar (dmth. vlera e drejtë në datën e rivlerësimit minus çdo amortizim të akumuluar të mëpasshëm dhe çdo humbje nga zhvlerësimi të akumuluar të

mëpasshme) në përputhje me SNRF-të tjera, siç është modeli i rivlerësimit në SNK 16 Aktive afatgjata materiale dhe SNK 38 Aktivet afatgjata jo-materiale. I vetmi ndryshim midis vlerës së drejtë të një aktivi dhe vlerës së drejtë të tij minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit është kostoja direkte rritëse që i ngarkohet drejtpërdrejt aktivitet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit. Identifikimi nëse një aktiv i rivlerësuar mund të jetë i zhvlerësuar varet nga baza që përdoret për të përcaktuar vlerën e drejtë:

- (a) nëse vlera e drejtë e aktivitet është vlera e tij e tregut, i vetmi ndryshim midis vlerës së drejtë të aktivitet dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot për shitje është kostoja direkte rritëse e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktivitet:
  - (i) nëse Nëse kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit janë të papërfillshme, shumata e rikuperueshme e aktivitet të rivlerësuar është domosdoshmërisht afër, ose më e madhe se shumata e rivlerësuar (dmth vlera e drejtë). Në këtë rast, pasi janë zbatuar kërkesat e rivlerësimit, nuk ka gjasa që aktivitet i rivlerësuar të jetë i zhvlerësuar dhe shumata e rikuperueshme nuk është e nevojshme të vlerësohet.
  - (ii) nëse ~~kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit nuk janë të papërfillshme, vlera e drejtë minus kostot për shitje të aktivitet të rivlerësuar është domosdoshmërisht më e vogël se vlera e tij e drejtë. Prandaj, aktivitet i rivlerësuar do të zhvlerësohet nëse vlera e tij në përdorim është më e vogël se shumata e tij e rivlerësuar (dmth vlera e drejtë). Në këtë rast, pasi janë zbatuar kërkesat e rivlerësimit, një njësi ekonomike zbaton këtë standard për të përcaktuar nëse aktivitet mund të jetë i zhvlerësuar.~~
- (b) [fshirë] nëse vlera e drejtë e aktivitet përcaktohet mbi një bazë tjetër nga ajo e vlerës së tij në treg, shumata e tij e rivlerësuar (dmth. vlera e drejtë) mund të jetë më e madhe ose më e ulët se shumata e rikuperueshme të tij. Prandaj, pasi janë zbatuar kërkesat e rivlerësimit, një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për të përcaktuar nëse aktivitet mund të jetë i zhvlerësuar.
- (c) Nëse kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit nuk janë të papërfillshme, vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktivitet të rivlerësuar është domosdoshmërisht më e vogël se vlera e tij e drejtë. Prandaj, aktivitet i rivlerësuar do të jetë i zhvlerësuar nëse vlera e tij në përdorim është më pak se shumata e rivlerësuar. Në këtë rast, pasi janë zbatuar kërkesat e rivlerësimit, një njësi ekonomike zbaton këtë Standard për të përcaktuar nëse aktivitet mund të jetë i zhvlerësuar.

D81 Paragrafi 6 është ndryshuar si më poshtë (si pasojë e ndryshimit në përkufizimin e vlerës së drejtë minus kostot për shitje, të gjitha referencat në "vlerën e drejtë minus kostot për shitje" në SNK 36 janë zëvendësuar me 'vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit'):

**6 Përkufizimet e termave të mëposhtme janë dhënë në këtë standard sipas këtyre kuptimeve specifike:**

~~Një treg aktiv është një treg ku ekzistojnë të gjitha kushtet e mëposhtme :-~~

- (a) ~~zërat e tregtuar në treg janë homogjenë;~~
- (b) ~~blerësit dhe shitësit e vullnetshëm mund të gjenden normalisht në çdo kohë; dhe~~
- (c) ~~çmimet janë në dispozicion të publikut.~~

Vlera e drejtë minus kostot për shitje është shuma që arrihet nga shitja e një aktivi ose njësie gjeneruese e mjeteve monetare në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të mirëinformuara, të palidhura me njëra-tjetrën, minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit është çmimi që do të pranohet për të shitur një aktiv ose paguhet për të transferuar një pasiv në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. (Shih SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë.)

D82 Paragrafët 12, 20 dhe 22 janë ndryshuar si vijon:

**12 Në vlerësimin nëse ka ndonjë tregues se aktivi mund të jetë i zhvlerësuar, një njësi ekonomike duhet të marrë parasysh, minimumi, treguesit në vijim:**

Burimet e jashtme të informacionit

